



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 DHJETOR 2012**

**PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE,  
ODRŽANE 13. DECEMBRA 2012. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR  
2012**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimeve të anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pyjet,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësi,
17. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit të procedurës penale,
18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

## Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma za osnivanje Evropske banke za obnovu i razvoj,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o budžetu Republike Kosova za 2013,
6. Razmatranje Predlog-odluke Komisije za budžet i financije određivanju plata i naknada za članove nezavisnih institucija i agencija,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o šumama,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-163 o rudnicima i mineralima,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Nacionalnom parku "Prokletije",
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Nacionalnom parku "Šar",
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o popisu poljoprivrede,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti biljaka,
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona o radovima od plemenitih materijala,
14. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o osnivanju sistema osiguranja depozita za finansijske institucije Kosova,
15. Drugo razmatranje Nacrta zakona za obrazovanje i osposobljavanje odraslih u Republici Kosovo,
16. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zdavstvo,
17. Drugo razmatranje Nacrta zakona o krivičnom postupku,
18. Razmatranje Izveštaja Komisije za spoljne poslove o nadgledanju sprovođenja Zakona o spoljnoj službi Republike Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar zëvendëskryeministër,  
Ministra të Kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta, replikë, siç e dini, nuk ka.

Vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,  
I nderuar zëvendëskryeministër,  
Ministra,  
Të nderuar deputetë,  
Tema të cilën unë dua ta ngre sot lidhet me rastin e ndarjes së dekoratave të pavarësisë nga institucioni i Presidencës së Republikës së Kosovës, e ku mendoj se me gjithë instruksionet dhe zgjedhjet që i ka marrë për t'i dekoruar disa institucione dhe personalitete, qoftë post mortum, ose të institucioneve faktike tani të Republikës së Kosovës, Presidentja e ka lënë anash një komunitet të rëndësishëm të vlerës kombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës - komunitetin katolik, për të cilin nuk ka parë as të veçuar individë, të cilët me vite të tëra kanë sakrifikuar, duke kontribuar në afirmimin e vlerave kombëtare dhe duke kontribuar jashtëzakonisht lart në ngritjen e çështjes shqiptare në qarqet amerikane, dhe të jep përshtypje se nganjëherë dekorohen individë, të cilët vlerësohen më shumë për nga vlera e pasurisë, sesa nga aspekti i ndarjes së vlerave kombëtare.

Prandaj, e sugjeroj Presidenten që të shohë edhe një herë, e t'i përmirësojë këto gabime, të cilat janë jashtëzakonisht të rënda dhe të cilat lënë vend për t'u indinjuar thellë, qoftë ne këtu në Kosovë, që kemi kontribuar së bashku në çlirimin e vendit, dhe komunitetit katolik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami, në emër të grupit.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Muajt e fundit, Qeverinë e Kosovës e kanë mbushur dhe karakterizuar skandale të shumta. Por, gjithë kësaj pune të mbrapshtë iu vu kurora me raportin e “Transparency Internacional”, raport ky që e mat nivelin e korrupsionit në Kosovë dhe në vendet tjera.

Kosova u rangua e 105-ta, nga 176 vende, sa janë subjekt i këtij raporti.

Rangimi nëpër vite i Kosovës në këtë raport ka qenë kështu: Në vitin 2010, Kosova e ka pasur vendin e 110-të; në vitin 2011 Kosova e ka pasur vendin e 112-të; në vitin 2012 Kosova rangohet në vendin e 105-të.

Çka do të thotë kjo? Për tre vjet, Kosova e ka përmirësuar pozitën e vet vetëm për 3 vende, e krejt kjo falë asaj që matjet janë bërë pas shpërthimit të skandaleve në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Të nderuar deputetë,

Kosova është më e korruptuar se gjysma e Afrikës. Me këtë ritëm të përmirësimit, Kosova arrin standardet evropiane vetëm pas 50 vjetësh. Ajo çka është për t’u çuditur, është mosreagimi i Qeverisë ndaj këtij raporti. Qeveritarët tanë e hanë turpin me bukë, duke pranuar gjithçka në heshtje. Gjendja e korruptuar në Kosovën tonë të dashur nuk ka si të jetë ndryshe. Ne e kemi një kryeministër që asnjëherë, ama asnjëherë, nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim në emër të luftës kundër korrupsionit, i cili pavarësisht aferave të rënda të vartësve të tij, ai nuk e shkarkoi asnjërin, e këtyre të fundit as nuk u shkoi në mendje që të japin dorëheqje, por në emër të luftës kundër korrupsionit, ata, vartësit e tyre, i dërgojnë në pushim me pagesë, shpërblim ky jo i keq.

Të nderuar qytetarë,

Korrupsion nuk është vetëm marrja e 10% nga secili tender publik. Korrupsion është vjedhja e votave. Korrupsion është çdo vendim i Qeverisë dhe i Parlamentit, i cili shkon në favor të grupeve të caktuara apo individëve dhe e dëmton shumicën. Korrupsion është kontrolli i Qeverisë që i bën Parlamentit. Korrupsion është kur deputeti nuk guxon të votojë atë çka mendon, por voton sipas instruksioneve. Korrupsion është rehatimi i familjarëve në institucionet e Qeverisë, duke i shndërruar ato në çerdhe partiake. Në Kosovë, korrupsion është shpërndarja e buxhetit dhe shpenzimi i tij.

Të nderuar deputetë,

Korrupsion është trajtimi i investitorëve të huaj nga institucionet tona. E keni dëgjuar më parë se kompanisë angleze “Marble Fox”, Komisioni për miniera dhe minerale i ka marrë 4 nga 5 licenca të lëshuara, e nuk është çudi që këto licenca nesër t’i jepen ndonjë partizani të PDK-së.

Një kompani suedeze, e quajtur “Hermet Kosova”, sot është në gjyq në emër të korrupsionit, në emër të shantazheve që një kompani kosovare po i bën asaj, dhe varësisht prej vendimit të gjyqit, kjo kompani do t’i mbledhë plaçkat dhe do të ikën nga Kosova. Cili është mesazhi që ky investitor suedez do t’ua dërgojë investitorëve të tjerë anembanë botës.

Korrupsion është kur zyrtarët e lartë në nivel të ministrave e shfrytëzojnë Buxhetin e Kosovës dhe televizionin publik për ta promovuar veten, gjoja për të na treguar për arritjet në dikasteret e tyre përkatëse.

Të nderuar deputetë,

Asnjëherë nuk kisha dashur të flas kështu për vendin tim. Por, të gjitha këto janë fakte dhe kisha pasur shumë dëshirë që dikush të më bindë për të kundërtën. Po krejt argumenti, krejt ajo çfarë ju mund të thoni, është se ky na qenka perceptcion. E perceptcioni, unë ju them se është reflektim i realitetit dhe nuk ka si të jetë ndryshe.

Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës i kanë 48 zyrtarë të lartë në nivel të ministrave dhe kryetarëve të komunave nën hetime, pikërisht për korrupsion. Me këtë nivel të korrupsionit, ne nuk mund të shkojmë asgjëkund, e aq më pak në Bashkimin Evropian.

Andaj, unë ju bëj thirrje të gjithëve që me çdo mjet dhe çdo kapacitet që e kemi ta luftojmë këtë dukuri të dëmshme dhe të turpshme që po e han ardhmërinë e pasardhësve tanë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

**ALMA LAMA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Para pak ditësh e kam marrë një letër nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, i cili e ka bërë një analizë rreth pavarësisë financiare të Gjyqësorit.

Natyrisht, Gjyqësori nuk ka nevojë vetëm për pavarësi financiare, por edhe për pavarësi nga politika.

Megjithatë, unë kam marrë përsipër të lexoj pjesë nga kjo analizë dhe nga ky raport, sepse është kërkesa që kjo të vijë pikërisht këtu në Kuvendin e Kosovës.

Mungesa e efikasitetit të pushtetit gjyqësor të Kosovës ka bërë që pjesa dërmuese e kritikave të bien mbi këtë degë të qeverisjes dhe të kemi shkeljen e të drejtave të njeriut, shqetësime këto të ngritura edhe nga Komisioni Evropian në raportet e progresit dhe në studimin e fizibilitetit.

Edhe hapat pozitivë të bërë në vitin 2010, që e kishin shtyrë përpara pavarësinë e gjyqësorit, ishin përcjellë me mungesë të përkrahjes adekuate me resurse financiare, njerëzore e të tjera. Vetë procesi i riemërimit dhe i emërimit të gjithë gjykatësve kishte filluar pa pasur ofertë të qartë për kandidatët, pasi rritja e pagave, nga mesatarisht 500 në 1 000 euro në muaj, për gjykatësit ishte vendosur vetëm pas përfundimit të këtij procesi. Rrjedhimisht, mungesa e interesimit të kandidatëve të kualifikuar dhe me kualitet të lartë ka rezultuar në fund të procesit me 98 pozita të paplotësuara të gjykatësve.

Sot, Gjyqësori ende vazhdon të mos jetë ambient joshës i punës, duke pasur parasysh kushtet fizike të punës, sikur se janë hapësirat jo të mjaftueshme të zyrave, mungesa e sallave të gjykimit, e inventarit dhe pajisjet tjera. Gjykatat kanë numër të vogël dhe kualitet të dobët të stafit mbështetës.

Gjyqësori për vite të tëra nuk gëzon as fonde për të rekrutuar praktikantë, e lëre më të ketë qasje në mekanizmat që i ka Qeveria, sikur janë 1 milion euro në vit të skemës së fondit të trurit, që shërben për paga më të mira të njerëzve me shkathtësi në pozitat deficitare, apo rreth 250 bursistë janë “sales”, të cilët kanë studiuar në vendet e BE-së.

Buxheti i vogël i shtetit nuk paraqet problem për financimin e Gjyqësorit, por kjo më shumë ndërlihet me nënvlerësimin që pushteti ekzekutiv, e po ashtu edhe pushteti legjislativ, bëjnë karshi pushtetit gjyqësor.

Ndikimi më i madh i Ekzekutivit në Gjyqësor bëhet nëpërmjet përkrahjes së kufizuar financiare, gjë që mundësohet falë ligjit dhe praktikës që lejon ndërhyrjen e Qeverisë në propozimin e buxhetit për Gjyqësorin.

Ndarja e buxhetit për Gjyqësorin nuk bëhet në bazë të ndonjë modeli më të avancuar me indikatorë të qartë, por sipas një kalkulimi të thjeshtë të rritjes së buxhetit për një përqindje të caktuar.

Përkrahja buxhetore prej 16 deri në 18 milionë euro në vit, ku 89% janë shpenzime operative, nuk paraqet përkrahje për zhvillimin e Gjyqësorit, por vetëm e siguron mbijetesën e tij. Në asnjë moment nuk merren parasysh rreth 10 milionë euro në vit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ju lutem, tregoni me kohë! Mund të flisni edhe 2 minuta.

**ALMA LAMA:** ...të hyra vetjake të Gjyqësorit, prej të cilave gjysma e tyre janë taksa gjyqësore.

Instituti i Kosovës për Drejtësi sugjeron adresimin e menjëhershëm të tri aspekteve në vazhdim:

- Të sigurohet pavarësia financiare institucionale. Propozimi i buxhetit të bëhet nga Gjyqësori drejtpërdrejt në Kuvend dhe pa ndërhyrje të Qeverisë. Të sigurohet pavarësia financiare individuale. Ekzekutivi duhet të heqë dorë nga politikat, të cilat e kërcënojnë sigurinë financiare të gjykatësve. Rrjedhimisht, duhet të garantohen pagat e gjykatësve, të cilët janë adekuate për profesionin e tyre dhe të rregullohen me ligj, e të mos ketë ulje gjatë mandatit të gjykatësve. Dhe së treti, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të jetë më i zëshëm për shqetësimet e sistemit gjyqësor në raport me dy pushtetet e tjera.

Ndërhyrjet arbitrare të Ministrisë së Financave, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e efikasitetit dhe në pavarësinë e Gjyqësorit, duhet të përcillen me ngritje të shqetësimit në të gjitha nivelet, e të mos kalohen në heshtje. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar, do të flas në emër të grupit,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Tema, të cilën unë sot do ta trajtoj tregon se si nuk respektohen ligjet në institucionet tona nga zyrtarët qeveritarë, e në këtë rast nga vetë ministri.

Unë sot këtu e kam një shkresë të protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë, më 3.10.2012, me numër protokollit 05-5654. Kjo shkresë i është drejtuar Bordit Qendror për shkollim specialistik në Ministrinë e Shëndetësisë nëpërmjet sekretarit permanent, e si e tillë i ka shkuar edhe vetë ministrit Agani nga drejtori i Departamentit të Administratës së Ministrisë së Shëndetësisë. Tema: Kërkesë për interpretim.

Ju informoj se në Ministrinë e Shëndetësisë janë 4 nëpunës, të cilët marrëdhënien e punës e kanë të lidhur me kontratë të rregullt si shërbyes civilë, por të njëjtit janë duke e realizuar edhe të drejtën e shkollimit specialistik.

Nga ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm, e kemi pranuar shkresën zyrtare, e cila i referohet shkresës së ministrit Agani me numër të protokollit 051338 përkitazi me këtë çështje.

Në shkresën e lartcekur kërkohet që të ndërpriten të gjitha kontratat që kanë të bëjnë me shkollimin specialistik të shërbyesve civilë, të cilët njëkohësisht janë të punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ministri ishte dashur të na tregojë se çka është bërë me shkresën e tij, por edhe me kërkesën për interpretim ligjor. Mos ndoshta kjo është bërë vetëm sa të thuhet se kemi bërë diçka, e më tutje po i mbyllim sytë para kësaj shkeljeje ligjore.

Shpesh po dëgjohet në këtë Kuvend, nga zyrtarët e lartë qeveritarë se askush nuk është mbi ligjin. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë pse ka interpretim, por edhe veprim të ndryshëm për çështjen e njëjtë.

Para këtyre zyrtarëve, unë njoh edhe zyrtarë të tjerë, të cilët është dashur të zgjedhin ndërmjet specializimit dhe vendit të punës, dhe pa dëshirën e tyre janë sistemuar në vendin e punës në specializim, sepse puna e specialistit është punë e rregullt dhe orari i punës duhet të respektohet.

Femrave që e shfrytëzojnë pushimin e lehonisë u zgjatet specializimi për aq kohë sa janë në pushim. E pse pra këtyre, të privilegjuarve të ministrit, po u mundësohet që në orarin e njëjtë të punojnë dhe të specializohen.



Kosova ka numër më të madh të papunësisë. Të papunë ka edhe shumë mjekë specialistë, bile-bile edhe nga lëmit deficitarë, siç është onkologjia, të cilët nuk po mund të punësohen për shkak se nuk po u ofrohet mundësia e punësimit.

Të nderuar qytetarë dhe të nderuar deputetë,  
Ku është drejtësia, që dikujt i mundësohet t'i mbajë dy vende të punës, dhe atë duke i shkelur ligjet në fuqi, e të tjerët duhet të presin për një vend pune me vite. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

**AURORA BAKALLI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,  
Një ndër hallkat e rëndësishme për avancimin e gruas në shoqëri sigurisht që është edhe pavarësia ekonomike e saj.

Punësimi i gruas ndikon pozitivisht në përmirësimin e pozitës së saj, si në familje, ashtu edhe në shoqëri. Mirëpo, gruaja e rëndomtë ka obligime shtesë ndaj fëmijëve dhe familjes, prandaj nëse ne si shoqëri jemi të interesuar që ta përmirësojmë pozitën e saj, atëherë duhet krijuar rrethana lehtësuese për të.

Një ndër lehtësimet që si shoqëri mund t'ua ofrojmë grave të punësuar, janë institucionet për kujdes ditor të fëmijëve, apo çerdhet e fëmijëve. Është shumë me rëndësishme që këto institucione, pos plotësimit të kushteve për kujdesin e fëmijëve, të kenë edhe çmim të volitshëm dhe të jenë afër vendbanimit të gruas së punësuar.

Këtë çështje po e shtroj e motivuar nga takimi që kisha para një kohe me gratë e lagjeve “Çamëria”, “Gallapi” dhe “Vreshtat” të Prishtinës, të cilat e paraqitën nevojën e madhe për një çerdhe publike në këtë pjesë periferike të qytetit. Gratë theksuan se mungesa e çerdhes në afërsi të vendbanimeve të tyre paraqet pengesë për gratë e punësuar të asaj ane.

Para disa ditësh, në mediet elektronike më ra në sy se kërkesë të ngjashme kanë edhe banoret e lagjes “Kodra e Trimave” të Prishtinës.

Të dhënat e Entit të Statistikës së Kosovës për vitet 2011-2012 pasqyrojnë se Prishtina i ka 7 çerdhe publike fëmijësh dhe të gjitha në pjesët urbane, ndërkohë që në pjesët rurale nuk ka asnjë çerdhe publike. Por, rëndësia e çerdheve e ka edhe një dimension tjetër, dhe ai është ndikimi i drejtpërdrejtë te fëmijët në kuptimin e zhvillimit të tyre social dhe emocional.

Sjelljet shoqërore dhe emocionale të një individi formësohen vazhdimisht gjatë jetës, por rëniet formohen pikërisht në moshën e hershme të fëmijërisë.

Çerdhet e fëmijëve janë vend ku fëmijët tanë mësohen ta njohin dhe respektojnë autoritetin, mësohen të komunikojnë në mënyrë të drejtë dhe me gjuhën e duhur, mësohen të veprojnë si grup dhe të eksplorojnë gjëra të reja.

Për këto arsye, në emrin tim personal dhe në emër të shumë grave, kërkoj nga organet kompetente që të ndërtohen më shumë çerdhe për fëmijë, sidomos në pjesët periferike, ku ato janë të mangëta. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të ngre sot këtu dy shqetësime të qytetarëve. Çështja e parë ka të bëjë me një kërkesë të nxënësve të shkollës fillore “Xhemajl Mustafa”, të cilët më 27 nëntor ishin në vizitë në Kuvendin e Kosovës dhe unë e kisha privilegjin t’i takoj, e një kërkesë e tyre ishte që të investohet në kryeqytetin e Prishtinës në rregullimin e shtigjeve për biçikleta dhe kënde për lojëra për fëmijë.

Duke qenë se jemi në përfundim të projektbuxhetit për vitin 2013, kërkoj nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe nga Komuna e Prishtinës që ta kenë parasysh këtë kërkesë të nxënësve të shkollës fillore “Xhemajl Mustafa”, e cila është kërkesë edhe e shumë fëmijëve tjerë të kryeqytetit, të cilët shkojnë edhe në shkollë me biçikleta, por shtigjet për biçikleta në kryeqytet mungojnë, ashtu siç mungojnë edhe këndet për lojëra.

Këta nxënës i kanë kuptuar nevojat që i ka kryeqyteti, por këto nevoja nuk i ka kuptuar ende udhëheqja e Komunës së Prishtinës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Shqetësimi i dytë ka të bëjë me mënyrën e transportit të pacientëve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nga njëra klinikë në tjetrën. Është e mjerueshme dhe shokuese mënyra e transportit të tyre. Pacientët barten nga familjarët dhe teknikët medicinalë, nga njëra klinikë në tjetrën, me anë të shtretërve nëpër rrugët e QKUK-së, por jo edhe me ambulanca dhe në mënyrë komfore.

Kjo mënyrë e transportit të pacientëve pothuajse është shndërruar në mënyrë normale, edhe pse nuk është e tillë. Andaj sot është e pamundur të shkosh në QKUK dhe mos të takosh rrugës duke bartur me shtretër ndonjë pacient nga Qendra Emergjente në Urologji, Ortopedi, apo anasjelltas.

Kjo formë e transportit të pacientëve me shtretër nëpër rrugët e QKUK-së, në këto kushte dimri, përveç se është një maltretim për pacientët dhe familjarët e tyre, është edhe rrezik për shëndetin e tyre dhe njëkohësisht është edhe rrezik që ata të aksidentohen nga automjetet.

Tani e 13 vjet pas luftës, asnjë menaxhment i QKUK-së nuk është i aftë të bëjë një zgjidhje për transportin normal dhe konform standardeve të pranueshme për pacientë dhe përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në Qendrën Klinike Universitare. Asnjë menaxhment i Qendrës Klinike Universitare deri më sot nuk është i aftë ta implementojë një projekt të mirëfilltë, nëpërmjet të cilit do të sigurohej lidhja fizike ndërmjet klinikave

me anë të korridoreve dhe të siguroheshin mjetet adekuate për transportin e pacientëve, kur ata do të duhej të lëvizin nga njëra klinikë në tjetrën. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

**HAKI DEMOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sipas nenit 24 të Kushtetutës së Kosovës, të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit. Ndërsa, sipas nenit 2 të Ligjit për policinë, veprimet e Policisë së Kosovës udhëhiqen, ndër të tjera, edhe nga parimi i trajtimit të barabartë dhe të drejtë të të gjithë personave.

Pra, Kushtetuta dhe Ligji për Policinë e Kosovës përcaktojnë që policia jonë të jetë e paanshme dhe t'i trajtojë të gjithë personat në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Por, praktikrat e veprimit të organit kryesor për mbrojtjen e jetës, pronës dhe ofrimit të sigurisë së qytetarit tregojnë krejtësisht diçka tjetër. Madje, veprimet e Policisë kosovare paraqesin shkelje direkte të dispozitave të lartcekura të Kushtetutës dhe Ligjit për Policinë e Kosovës.

Kur e them këtë, kam parasysh krahasimin e reagimit të Policisë kosovare në dy protestat e organizuara kohëve të fundit në Kosovë. Konkretisht, veprimin e Policisë me rastin e protestave të 22 tetorit të këtij viti, të organizuara nga Lëvizja “Vetëvendosje”, kur ajo i arrestoi 63 protestues, si dhe rrahu e lëndoi me dhjetëra sish, përfshirë këtu edhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe reagimin, apo më mirë thënë mosreagimin dhe indiferencën e pjesëtarëve të Policisë më 27 nëntor të këtij viti gjatë protestës, si pasojë e së cilës nuk u mbajt ceremonia e përrurimit të pjesës së autostradës “Ibrahim Rugova”, në Gjurgjicë, me ç’rast kryeministri i Kosovës dhe ai i Shqipërisë i ndryshuan agjendat e tyre, duke mos u paraqitur fare në përrurim, kurse ambasadorët e vendeve mike u larguan nën vëzhgimin rigoroz të personelit të sigurimit fizik, ndërsa pamjet e largimit nga ky tubim të ministrit të Punëve të Brendshme, që u transmetuan në media elektronike, i dhanë një imazh jo të mirë Kosovës, si një shtet i ri, i cili nuk po mund ta sforcojë sundimin e rendit dhe të ligjit.

Dua të jem i qartë, kërkesa e kësaj paraqitjeje time nuk është përdorimi i dhunës policore në rastin e Gjurgjicës, por është trajtimi parimor i drejtë i të gjithë qytetarëve, pavarësisht se a protestojnë në Prishtinë, në Gjurgjicë, në Mitrovicë, apo në Pejë a Prizren. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Tjetërsimi i pronës publike në komunën e Gjilanit është bërë biznes i kreut të saj.

Ky tjetërsim madje po bëhet edhe duke i shkelur rëndë ligjet dhe rregullat që i mbulojnë dhe rregullojnë këto çështje, si për shembull Ligji për partneritet publiko-privat dhe dhënies me koncesion të pronave publike.

Tjetërsimi po ndodh edhe pa procedura fare, si në rastin e ndërtimeve në lagjen “Dheu i Bardhë”.

Pra në këtë lagje, në Gjilan, kryetari i Komunës e ka lejuar një kompani private t’i ndërtojë disa shtëpi, të cilat, sipas tij, do të jenë për të pastrehët.

Kuvendi Komunal, në seancën e shtatorit, nuk e ka aprovuar kërkesën e kryetarit. Por, edhe pse kërkesa e kryetarit nuk është aprovuar nga Kuvendi Komunal, punimet kanë vazhduar.

Kryetari ka marrë pjesë në ceremoninë e fillimit të punimeve. Kjo është një marrëveshje private e kryetarit me një kompani private, së cilës kryetari ia ka dhënë tokën e Komunës. Ky akt paraqet shkelje të rëndë të ligjit.

Vendimi pastaj është proceduar përsëri në Kuvendin Komunal, në seancën e mbajtur më 26 nëntor.

Në këtë datë, vendimi është miratuar, me gjithë konstatimin e përgjithshëm, përfshirë atë të kryetarit të Komunës së Gjilanit, se ka pasur shkelje të rregullave dhe të procedurave.

Ky është një absurd i llojit të vet, kur e kemi tërë një strukturë të zgjedhur përfaqësuesish dhe udhëheqësish të një komune që pajtohen se është shkelur ligji dhe kolektivisht vendosin ta vazhdojnë shkeljen.

Vendimi ishte sjellë në Kuvendin Komunal post festum, pasi pjesa më e madhe e punimeve thuaja kishte përfunduar.

Edhe në shumë raste tjera, ligjet dhe procedurat që e rregullojnë këtë lëmi po shkelen.

Mjafton vetëm të shihet Ligji për partneritet publiko-privat dhe të trajtohet forma e tjetërsimit të pronave komunale afër Kombinatit të Duhanit, ish-Kadastra, trualli afër Stacionit të Autobusëve, pastaj si është dhënë me koncesion “Higjieno-Teknika” etj.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal obligohet të interesohet për këto shkelje dhe t’i ndërmarrë masat e duhura.

Po ashtu, Prokuroria duhet të përfshihet në këto raste, në mënyrë që të konstatohet nëse këto përbëjnë bazë të mjaftueshme për hetime penale kundër fajtorëve. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

**BERAT BUZHALA:** I nderuar kryetar,

Flas në emër të grupit!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Që prej shembjes së Jugosllavisë, si fillim, dhe më tutje prej fillimit të luftës, dhe edhe më tutje prej çlirimit të vendit tonë, dhe më tutje pas shpalljes së pavarësisë, dhe më tutje deri në ditët e sotme, si shoqëri e kemi pasur shumë lehtë t'i identifikojmë pikat se për çka ne pajtohemi me njëri-tjetrin dhe e kemi pasur shumë të vështirë t'i numërojmë pikat se për çka nuk pajtohemi me njëri-tjetrin. Dhe, kjo nuk ka ndodhur se ne jemi pajtuar në shumë gjëra. Përkundrazi! Kjo ka ndodhur se ne jemi pajtuar në shumë pak gjëra. Në fakt, ne jemi pajtuar në një gjë: orientimin euroatlantik, besimin e palëkundur në Uashingtonin dhe në Brukselin, dhe me këtë orientim ne asnjëherë nuk kemi luajtur bixhoz.

Ky orientim prej liderëve tanë, duke filluar prej presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, e duke vazhduar me ata që e bënë luftën, nuk ka qenë vetëm verbal, por ka qenë kulturor dhe politik.

Sado të ashpra të kenë qenë çarjet e brendshme ndërmjet të ashtuquajturit “krah i luftës” dhe “krahut të paqes”, megjithatë referenca e përbashkët perëndimore asnjëherë nuk është vënë në dyshim.

Pra, si Hashim Thaçi në luftë, si Ibrahim Rugova në paqe, kanë besuar pa dyshim se kërcënimi i Krishtlindjeve i Xhorxh Bushit plak drejtuar Serbisë për të mos e shkelur vijën e kuqe në Kosovë nuk ka qenë një bluf, por ka qenë shkëndija e parë e një miqësie ndërmjet një shteti titan, siç ishin dhe siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe një popull të vogël, por që ndodhi në pragun e një pogromi dhe të një fatkeqësie apokaliptike.

Nuk kanë qenë të rralla rastet e mërive të brendshme edhe kur Kosova po digjej flakë prej forcave serbe dhe kur Milosheviqi po e realizonte skenarin që Adolf Hitler do ta quante “zgjidhjen përfundimtare” për popullin e Kosovës, e megjithatë të gjithë ne kemi besuar që kërcënimi i presidentit Klinton drejtuar regjimit fashist të Beogradit nuk ka qenë një bluf.

Qytetarët e Kosovës kurrë nuk do të harrojnë kërcënimin që forcave serbe nga Londra ua kishte bërë sekretarja amerikane Medlin Ollbrajt, disa ditë pasi këto forca e kishin kryer masakrën makabër në Prekaz.

Këto ishin momentet kur ne po e përjetonim në një kohë moderne fazën e fundit të zhdukjes së një populli. Mirëpo, ne, gjithashtu, po e përjetonim mobilizimin historik, politik dhe kulturor të Aleancës Perëndimore kundër regjimit gjenocidial të Milosheviqit.

Ishte ky momenti kur popullit të Kosovës po i shpaguej pritja dhe besimi që e kishte investuar në Uashingtonin dhe Brukselin, që kulmoi me çlirimin e vendit dhe shpalljen e pavarësisë.

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne i kemi besuar shumë zonjës Ollbrajt, gjeneralit Klark, senatorit Dol, senatorit Mc Kein, senatorit Liberman, sekretares Klinton dhe një liste të pafund të emrave të heronjve tanë amerikanë.

Nuk kanë kaluar as 5 vjet prej shpalljes së pavarësisë, e nuk kanë kaluar as 15 vjet prej holokaustit tonë dhe ne, konkretisht forca e tretë më e madhe politike në vend, e ka prishur marrëveshjen tonë, pikën tonë të vetme për të cilën jemi pajtuar - paktin me Perëndimin, besimin në Uashingtonin. Lëvizja “Vetëvendosje”, kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme, Albin Kurti, i ka dërguar letër kërcënuese zonjës Ollbrajt, asaj që dikur, në emrin tonin, i dërgonte letër kërcënuese Slobodan Milosheviqit.

Kurti, të nderuar kolegë deputetë, nuk e ka kërcënuar zonjën Ollbrajt, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kurti, të nderuar kolegë deputetë, nuk është thjesht deputet, por është kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme, është Kuvendi i Kosovës. Ky është një ogur i zi për politikën kosovare.

Fatkeqësisht, në vend se për një gjest të tillë t’u kërkohej falje SHBA-ve, përfaqësuesit e “Vetëvendosjes” vetëm sa po e zhvillojnë cinizmin e tyre, duke deklaruar se ambasadorja amerikane e ka keqkuptuar krejt ngjarjen.

Është partia e vetme shqiptare, pas Partisë së Punës vetëgjënjociale të Enver Hoxhës, të mbrapshtë dhe tragjike, që është në marrëdhënie antagonistike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Badihava proklamojnë mareshalët e “Vetëvendosjes” se janë pro-amerikanë dhe se janë pro-perëndimorë. Për këtë më së miri na kanë treguar tre ambasadorët e fundit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë - Tina Kajdanov, Kristofer Dell dhe, tash së fundi, zonja Xhejkobson.

Atëherë, unë kërkoj, në emër të Grupit Parlamentar, që kjo lëvizje dhe kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme të distancohet prej qëndrimeve anti-amerikane. Faleminderit!

**KRYETARI:** Është kryer pika e rendit të ditës “Hajt pak!”. Vazhdojmë!

Tash jemi te pika - Koha për pyetje parlamentare.

Për këtë mbledhje, deputetët e Kuvendit kanë parashtruar 12 pyetje për përgjigje gojore nga Kabinetit qeveritar.

*(Ndërhyrje - polemikë)*

Unë ia jap fjalën kujt dua! Këtë e dini, më duket. Andaj, s’ka nevojë me për zhurmë.

*(Ndërhyrje)*

Mua s'po më intereson, a ke a s'ke votues. Ulu, sepse pika e rendit të ditës, është harxhuar. Bile, në daç ta dish, kjo s'është hiç për pozitën. Kjo pikë e rendit të ditës është më tepër opozitën sesa për pozitën. Por, unë po ua jap fjalën sipas grupeve parlamentare dhe askujt s'ia kam bërë me hile. Pra, me rend ua kam dhënë fjalën, secilit grup, prej grupit më të madh politik deri te deputeti i pavarur.

*(Ndërhyrje)*

Unë e di që keni ankesa, por ankesat, nëse e keni drejt, bëjini me shkrim dhe ka kush ato i shqyrton ato.

Vazhdojmë pra me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeminstirin Hajredin Kuçi. Deputete a e do fjalën?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Është hera e dytë që unë po i drejtohem me pyetje të njëjta zëvendëskryeminstirit Kuçi dhe është hera e dytë që nuk po marr përgjigje.

Pra, pyetja e parë ka të bëjë me atë se a janë të vërteta skandalet e përgjimeve, që i dëgjoi opinioni publik më 29 nëntor 2012, pasi Qeveria deklaroi se janë të fabrikuara, ndërsa më pas EULEX-i konfirmoi se janë të vërteta.

Dhe pyetja e dytë ka të bëjë me Ligjin për përgjimet, se cilët ekspertë apo përfaqësues të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në hartimin e këtij projektligji.

Mirëpo, me këtë veprim, zëvendëskryeminstiri po i ikën përgjegjësisë që e ka ndaj Kuvendit, e me këtë po e shkel edhe Rregulloren e Kuvendit, por edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, ai qëllimisht nuk po vjen në seancë dhe qëllimisht po ikën nga Kuvendi, por le ta dijë edhe ai, edhe e gjithë kjo Qeveri, se ndëshkimit që populli do t'ia bëjë asnjëherë nuk kanë për t'i ikur. Faleminderit!

KRYETARI: Albulenë, e ke edhe një pyetje tjetër.

*(Ndërhyrje)*

Të dy pyetjet i ke për zëvendëskryeminstirin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, jo për ministrin Rexhepi.

*(Ndërhyrje)*

Atëherë, vazhdojmë. Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Këto pyetje janë prej seancës së kaluar, kur nuk ka qenë ministri këtu dhe po i përsëris. Janë dy pyetje, po e lexoj të parën.

Më 6 shtator të vitit 2012 hyri në fuqi Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e kodeve telefonike aktuale në Kosovë.

Pika 2 e kësaj rezolute thotë që në funksion të realizimit të këtij qëllimi, brenda një kohe shumë të shkurtër, Qeveria obligohet t'i iniciojë negociatat me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Tash janë bërë gati më shumë se 3 muaj që prej se ka hyrë në fuqi kjo rezolutë dhe pyetja ime është: A kanë nisur negociatat dhe nëse po, në çfarë pike janë dhe ku jemi në këtë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Faleminderit deputet Ymeri për pyetjen.

Sigurisht se Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka marrë obligime nga rezoluta, e cila ka dalë nga Kuvendi. Ka veprime të theksuara në këtë drejtim.

Ne e kemi organizuar një vizitë zyrtare në Shqipëri për ta bërë një takim me ministrin Polo, i cili është përgjegjës për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë. Ishim bashkë me deputetin Kuleta. Pra, në një takim ku janë diskutuar të gjitha detajet e marrëveshjes, duke pasur prioritet bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve tona shtetërore që ta marrim fillimisht kodin shtetëror të Republikës së Kosovës, por njëkohësisht kemi diskutuar edhe për përdorimin e 355-shit si kod të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe IT, që Kosova mund ta përdorë.

Ne jemi dakorduar ashtu që të bëjmë një memorandum bashkëpunimi, por njëkohësisht jemi dakorduar edhe për ta krijuar një komision të përbashkët ndërshtetëror, ku do të pasqyroheshin Parlamenti, Qeveria dhe rregullatorët tanë. Unë e kam emëruar, në cilësinë e ministrit, grupin i cili do ta përfaqësojë Qeverinë, Parlamentin dhe Rregullatorin. Në atë grup do të jetë kryetari i Bordit të Rregullatorit, do të jetë nga Parlamenti, deputeti nismëtar i kësaj rezolute dhe drejtori për Telekomunikacion në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. I kam dërguar letër ministrit dhe e kam njoftuar se ne jemi të gatshëm për ta marrë kodin 355 dhe konform bisedave që kemi pasur me të, ata e kanë obligim të komunikojnë me IT. Unë në letrën time i kam kërkuar që sa më shpejt të komunikojnë me IT, sikur ka bërë Monako-Telekomi më herët, pra ta arsyetojnë para IT-së pse duhet të merret dhe cilat janë arsyet komerciale e ekonomike funksionale, në funksion të marrjes së këtij kodi, prandaj presim nga Shqipëria tash të na japë përgjigje...

*(Ndërprerje nga regjia)*



KRYETARI: Visar, pyetje shitesë?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Prapë po më intereson, nëse ka ndonjë program konkret, pra afate kohore se kur pritet, nëse jeni marrë vesh me ministrin e Shqipërisë, që këto të realizohen dhe kur pritet përfundimisht, sipas parashikimeve natyrisht tona, që të merret ky kod?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Pra, unë thashë se e kemi formuar komisionin. E kemi përgatitur memorandumun dhe jemi të gatshëm për ta nënshkruar një memorandum të tillë. Kam kërkuar që Qeveria e Shqipërisë të komunikojë me IT, e unë nuk mund të flas në emër të Qeverisë së Shqipërisë. Unë mund të flas vetëm në emër tonin. Ne i kemi kryer të gjitha aktivitetet tona. Pra, e kemi formuar komisionin, e kemi dërguar letrën. Bile, unë i kam dërguar edhe një letër shitesë IT personalisht, me të cilën kam kërkuar marrjen e kodit dhe e kam informuar IT-në për lëshimin e kodit shtetëror për radio-amatorizëm. Do të thotë, nuk e kam kërkuar fort lejen e tyre për një proces të tillë, por i kam informuar se ne e kemi lëshuar një kod të tillë dhe ai është në funksion, pra radio-amatorizmi funksionon dhe në të njëjtën letër kam kërkuar që Kosovës t'i lëshohet kodi për shtetin e Republikës së Kosovës.

Pra, unë mund të flas për aktivitetet tona, e jo për Qeverinë e Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë tani duhet të komunikojë me IT-në dhe ata na kanë thënë se këtë do ta bëjnë shumë shpejt, por sa do të jetë shpejt dhe cilët do të jenë hapat e tyre - ne duhet të komunikojmë me ta. Mund të komunikoni edhe ju, pse jo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, përsëri pyetje për ministrin Besim Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Pyetja e dytë ka të bëjë me procesin e privatizimit të rrjetit të Distribucionit. Pra, është deklaruar publikisht se borxhin e mëhershëm të qytetarëve ndaj KEK-ut do ta mbledhë konsorciumi "Limak-Çalik", që është shpallur fitues i tenderit.

Po më intereson në çfarë mënyre dhe sa do të jetë përqindja që do t'i takojë këtij dhe po ashtu cila është baza ligjore që i lejon t'i kalojë një përqindje këtij konsorciumi nga mbledhja e borxhit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Deputet Ymeri! Prapë duhet të them se transaksioni për privatizimin e Distribucionit është një transaksion i suksesshëm, i cili i ka respektuar standardet më të larta ndërkombëtare. Dokumentet të cilat janë bërë publike në ueb-faqen e Ministrisë, dokumente që ju i keni kërkuar të bëhen publike konform Ligjit për qasje në dokumente publike, dhe nëse më kujtohet mirë, e kemi trajtuar pak edhe nenin 4.4, që nëse dëshiron ndokush të marrë informata më të detajuara mund të shkojë t'i marrë ato.

Pra, dokumentet janë publike. Ju i keni kërkuar, ato janë publike dhe keni mundur t'i lexoni. Por, megjithatë, unë po ju informoj se është marrë vendim që borxhet e këqija të mos falen. Pra, është vendim i Qeverisë. Borxhet e këqija me një kontratë komerciale do të barten nga KEK-u në KEDS, pra në distribucionin për koston, të cilën ata do ta paguajnë për shërbimet të cilat do t'i kryhen, sepse është keqpërdorur aq shumë kjo që do t'u falen, do të fitojnë para edhe aty. Do të thotë, është shërbimi, të cilin ata do ta bëjnë në rast të mbledhjes së borxheve dhe ai shërbim është nga lehtësia e mbledhjes prej 15 deri 25%, është specifikuar në kontratë dhe është komplet në harmoni me rregullativën ligjore dhe standardet më të larta ndërkombëtare. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputet, ke pyetje shtesë? Jo. Vazhdojmë. Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministren Vlora Çitaku. Ministria nuk është këtu. Deputete, a do ta parashtrosh pyetjen?

**ALBANA GASHI:** Faleminderit, kryetar!

Këtë pyetje unë e kam nga java e kaluar, por meqë ministrja nuk është prapë sot e pranishme, unë do ta lexoj megjithatë pyetjen:

Në raportin e Auditorit të Përgjithshëm, nënkapitulli - kompensimet, thuhet: Ne e kemi testuar kryesisht procesin e rekrutimit, listat e pagave, vlerësimin vjetor të performansës, si dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Lidhur me këtë, ne kemi vërejtur parregullsi në procesin e rekrutimit. Kjo është shpalosur, si në vijim:

Parregullsitë janë vërejtur te procesi i rekrutimit. Përzgjedhja e kandidatëve, në mungesë të kriterëve të përcaktuara krijon mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve, që në mungesë të shkathtësive dhe përvojës së duhur profesionale mund të dështojnë në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive.

Në konkursin e shpallur për pozitën e zyrtarit të Prokurimit, ndër kriteret e kërkuara ishte edhe përvoja dyvjeçare në fushën e Prokurimit.

Ne e kemi analizuar këtë proces dhe kemi vërejtur se ky zyrtar nuk e ka përvojën e përcaktuar me afat.

Pyetja ime do të ishte: Cilat masa administrative ka ndërmarrë ministrja lidhur me këtë shkelje dhe me urdhër të kujt janë shkelur procedurat kësaj radhe? Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Vazhdojmë. Deputeti Fikrim Damka, pyetje për ministrin Radojica Tomiq. Ai ka marrë përgjigje me shkrim.

Vazhdojmë. Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja. Ministri është lajmëruar se është në udhëtim zyrtar. Deputet, doni ta bëni pyetjen?

*(Ndërhyrje)*

Atëherë, vazhdojmë. Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Regjia, fjalën deputetit Liburn Aliu.

**LIBURN ALIU:** Faleminderit!

Natën ndërmjet 12 dhe 13 majit të vitit 2010, në fshatin kufitar Radushë të Republikës së Maqedonisë, organet e rendit të Republikës së Maqedonisë i kanë vrarë katër të rinj shqiptarë, dy nga ta shtetas të Republikës së Kosovës dhe dy të tjerët shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Vrasja në mediet maqedonase u justifikua si përgjigje ndaj sulmit të armatosur të një grupi kontrabandistësh me armë. Nga pamjet, u kuptua se të vrarët ishin brenda një veture - kombi të mbyllur, pa dritare dhe pa mundësi komunikimi.

Pas kësaj vrasjeje, më 14 maj, ju ministër Rexhepi keni pasur takim me ministren Jankulovska të Republikës së Maqedonisë në Shkup, nga i cili takim keni dalë me deklaratë në një konferencë të përbashkët mbi bashkëpunimin e të dyja shteteve. Dhe, ministrja Jankulovska me këtë rast ka deklaruar se ju ka njoftuar lidhur me detajet e këtij aksioni të armatosur.

Pyetja është, meqë ka mbetur enigmë për qytetarët e të dy republikave: A mund të na i sqaroni detajet e atyre vrasjeve, që kanë mbetur enigmë për qytetarët shqiptarë të dyja republikave, si dhe arsyetimin e organeve të Maqedonisë në lidhje me këto vrasje?

**KRYETARI:** Ministër, e ke fjalën!

**MINISTRI BAJRAM REXHEPI:** I nderuari kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Natyrisht se në takimin që e kemi pasur, ajo më ka informuar në pika të shkurtra se si ka ndodhur ngjarja dhe, sipas versionit të ministres së Punëve të Brendshme të Maqedonisë, ata thonë se ai kombi nuk është ndalur në një ndalesë - check point, që e kanë pasur në atë pjesë, dhe ka filluar shkëmbimi i zjarrit, me ç'rast janë vra katër shtetas.

Këtë informatë ma ka dhënë dhe duhet ta dimë se unë nuk kam juridiksion për të kërkuar raport detal, por natyrisht se kjo ka qenë informata zyrtare e tyre.

Unë i kam sugjeruar ministres Jankulovaska që për hir të opinionit dhe meqenëse të vrarët kanë qenë nga komuniteti shqiptar, është mirë të bëhet një hetim i pavarur ndërkombëtar, dhe do të ishte i mirë për të gjithë që t'i dimë rrethanat dhe për çfarë rrethanash është bërë. Ky ka qenë sugjerimi im.

Ndërsa sa i përket bashkëpunimit, ai është obligim ndërshtetëror që, kushtimisht them, për çdo aktivitet kriminal që mund të ndodhë në të dyja shtetet, ne e kemi obligim të bashkëpunojmë dhe të bëjmë shkëmbim të informatave.

Me këtë, unë nuk dua t'i vlerësoj të vlarët, mirëpo ky ka qenë bashkëpunimi dhe këtë informatë e kanë dhënë zyrtarët.

Për çështje tjera dhe detaje se si ka ndodhur, nuk e kam informatën e plotë, dhe për këtë aq më ka informuar.

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë?

**LIBURN ALIU:** Ju thatë që në argumentimin e ministres Jankulovska është deklaruar që ka pasur shkëmbim zjarri, pra ka pasur zjarr të dyanshëm, ndërsa qartë shihet që kombi ka qenë i mbyllur, pa dritare pra, dhe personat që kanë qenë brenda nuk kanë pasur mundësi komunikimi që të ketë shkëmbim zjarri. Zjarri si duket ka qenë vetëm i njëanshëm. Prandaj, a është e qartë pyetja, a kanë thanë ata që zjarri ka qenë vetëm i njëanshëm, apo ka qenë i dyanshëm, se ju e përmendët fjalën shkëmbim, që nënkupton të dyanshëm?

**KRYETARI:** Ministër!

**MINISTRI BAJRAM REXHEPI:** Edhe një herë them se unë nuk kam qenë vendin e ngjarjes dhe nuk mund t'i shpjegoj rrethanat. Unë e them atë çka ka deklaruar ministrja. Në momentin kur nuk janë ndaluar, kanë gjuajtur forcat policore maqedonase dhe ka pasur shkëmbim zjarri. Këtë e kanë përmendur.

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër!

Deputeti Liburn Aliu, përsëri pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

**LIBURN ALIU:** Pyetja ka të bëjë me të njëjtën ngjarje. Pra, takimi ka ndodhur menjëherë pas atij aksioni dhe ka pasur të bëjë me atë aksion dhe deklaratat pas aksionit kanë qenë për bashkëpunimin, për këmbimin e informatave, ku në të ashtuquajturën ndjekje të kriminelëve, me ç'rast kur është përmendur këmbimi i informatave lihet të nënkuptohet që Republika e Kosovës mund të ketë qenë e involvuar nëpërmjet informacionit - dhënies së informacionit, në këtë ngjarje. A janë të involvuara në çfarëdo mënyre qoftë në këmbim të informatash, qoftë drejtpërdrejt, organet institucionale të Republikës së Kosovës në vrasjen e 4 të rinjve shqiptarë në fshatin Radushë?

**KRYETARI:** Urdhëro ministër, edhe pse u përgjigjët një herë.

**MINISTRI BAJRAM REXHEPI:** Jo, në atë kohë nuk ka pasur kurrfarë këmbimi të informatave. Mund të ketë ndoshta EULEX-i, po atë nuk mund ta konfirmoj nëpërmjet Interpolit, edhe mund të them se shkëmbimi i informatave bëhet nëpërmjet "Ileko", e cila është themeluar shumë më vonë, pra nga të gjitha të dhënat e Policisë që i kemi nuk ka pasur shkëmbim të informatave në lidhje me rastin. Dhe, po ashtu është precizuar që në territorin e Kosovës nuk janë dëgjuar të shtëna dhe nuk ka pasur të dhëna që kanë kaluar nga territori i Kosovës. Pra, në atë kohë s'ka pasur asnjë shkëmbim të informatave me autoritetet e Maqedonisë.

**KRYETARI:** Pyetje shtesë? Nuk ka. Mirë. Faleminderit!  
Pyetja e fundit, deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

**AFRIM KASOLLI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe kjo pyetje ndërlidhet me ngjarjen e lartcekur. Më 14 maj 2010, pas takimit tuaj në Shkup me ministren e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë, Gordana Jankulovska, në deklarimin e saj para medieve në lidhje me ngjarjen në fshatin kufitar Radushë dhe vrasjen e katër të rinjve shqiptarë, shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe të Kosovës, ministrja maqedonase, në kuadër të deklarimit për bashkëpunim ndërmjet të dyja shteteve në luftimin e të ashtuquajturave grupe kriminale, ka deklaruar se ju ka dhënë një listë e personave të kërkuar në Republikën e Maqedonisë, e të cilët dyshohet se fshihen në Kosovë dhe për të cilët ju do të duhej ta ndihmoni Republikën e Maqedonisë t'i kapni ato persona. Pyetja: Do të donim të dinim se çka ka ndodhur me ata persona, emra e të cilëve janë në atë listë, a i janë dorëzuar Republikës së Maqedonisë, e nëse jo deri tani, nëse gjenden, a do t'i dorëzojë shteti ynë ata persona në duar të shtetit maqedonas? Faleminderit!

**KRYETARI:** Ministër, e ke fjalën.

**MINISTRI BAJRAM REXHEPI:** Po, në atë takim është paralajmëruar dhënia e një liste prej më shumë se 50 persona, të cilët, sipas të tyre, kanë bërë aktivitete të ndryshme kriminale dhe më vonë ajo është dorëzuar në mënyrë zyrtare nëpërmjet Ministrisë, që është përcjellë në Polici që të verifikohen nëse janë shtetas të Maqedonisë, apo janë shtetas të Kosovës, ku janë bërë krimet, dhe kjo është në kuadër të një bashkëpunimi policor që bëhet jo vetëm në Maqedoni, por edhe me shtetet tjera të rajonit.

Mund të them se shumica prej tyre janë shtetas të Maqedonisë, që ata kanë pretenduar se mund të fshihen në Kosovë dhe ne, natyrisht, si një shtet që do t'i zbatojë të gjitha rregullat, edhe juridike, edhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, qoftë kundër krimit, terrorizmit, kemi obligim që t'i verifikojmë. Për situata të caktuara, për raste të caktuara, nëse verifikohet se kanë kryer krime, këto shkojnë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Policia është vetëm ekzekutuese. Eventualisht nëse pretendojnë se janë në territorin e Kosovës dhe do të ekstradohen, prapë kjo shkon nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe mund të them se ne jemi të përkushtuar që Kosova të mos jetë oazë e fshehjes së asnjë aktiviteti kriminal ose të krimit. Këtë nuk e them me paragjykim, por nëse ka të dhëna dhe duan të fshihen në Kosovë, në Kosovë nuk kanë vend të tillët.

Kjo është në kuadër të bashkëpunimit edhe një herë, që siguria në rajon të jetë e përbashkët dhe të kontribuojmë, edhe duke i shkëmbyer informatat, edhe me bashkëpunimin e ndërsjellë.

Edhe një herë them - ekstradimi dhe të gjitha këto shkojnë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, kurse Policia është ekzekutuese e këtyre vendimeve gjyqësore.

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë?

Pyetja ishte shumë konkrete, shtrohet pyetja se ata që u ekzekutuan atëherë, çfarë krimesh paskan bërë? Do të thotë, nëse ju i arrestoni dhe i dorëzoni te organet e Maqedonisë, a mbani përgjegjësi nëse maqedonasit i ekzekutojnë sikurse në rastin e mëhershëm?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Edhe si paragjykuese, edhe hipotetike. Në rastin kur është dorëzuar lista, kjo ka qenë pas asaj dhe ata nuk kanë figuruar në atë listë. Dhe, natyrisht edhe një herë them - nëse argumentojnë se kanë bërë krime dhe shkon nëpërmjet procedurave të rregullta të Ministrisë së Drejtësisë, ne e kemi obligim dhe sigurisht që i dorëzojmë, por këto janë rregulla të ekstradimit që rregullohen nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Se çfarë bëjnë autoritetet maqedonase, ajo është shtet sovran. Ne nuk mund të ndikojmë në veprimet e tyre, siç është edhe Kosova shtet sovran dhe Maqedonia nuk mund të ndikojë te ne...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Një sqarim për pikën e parë të rendit të ditës. Grupet parlamentare, nëse duan ta autorizojnë një deputet për të folur në emër të grupit, është mirë ta lajmërojnë këtë. Këtë e bën rregullisht Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Unë nuk e di çka kanë në ndërmend deputetët e secilit grup, nën një.

E dyta, deputeti Halit Krasniqi që u ankua, nuk ka të drejtë, për faktin se të gjithë deputetët kanë elektorat dhe asnjë deputet i grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nuk e ka marrë fjalën më shumë se ai dhe deputetët që e kanë marrë fjalën sot nuk e kanë marrë fjalën në seancat e mëparshme, e kanë pasur rendin. Prandaj, merreni e lexojeni Rregulloren dhe ajo thotë se kryetari e përcakton rendin e fjalës së deputetëve, duke pasur parasysh grupet, por edhe ata që janë pa grup dhe unë e kam respektuar në përpikëri Rregulloren e Punës së Kuvendit. Këtë po e them më tepër për hir të opinionit, se sa për hir të deputetëve, se deputetët duhet ta lexojnë Rregulloren e Punës së Kuvendit.

*(Reagime nga salla)*

Kjo nuk është në rendin e ditës. Unë e sqarova opinionin për shkak të reagimit të juaj. Vazhdojmë. Po t'i nuk di ta informosh opinionin, veç e dezinformon.

Pika e tretë e rendit të ditës:

### **3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 dhjetor 2012**

Pyes nëse ka vërejtje në procesverbal? Të pranishëm janë 70 deputetë. Nuk ka vërejtje. Konstatohet se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 dhjetor 2012.

Pikën e katërt të rendit të ditës, për shkak se nuk është numri i nevojshëm i deputetëve, e lëmë për më vonë dhe shkojmë te pika e radhës e rendit të ditës:

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013**

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Edhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe Kuvendit ia paraqesin raportet e tyre.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë raportin me rekomandime.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, menjëherë pas miratimit në lexim të parë të Projektligjit për buxhetin, sipas planit të veprimit për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për buxhetin i ka aktivizuar tri grupe punuese, të formuara sipas Rregullores së brendshme të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Grupet punuese kanë mbajtur 26 dëgjime buxhetore me institucionet e pavarura dhe me organizatat tjera buxhetore.

I kanë shqyrtuar 70 kërkesa buxhetore dhe amendamentet e deputetëve.

Rekomandimet e grupeve punuese janë shqyrtuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe janë përmbledhur në 49 amendamente, të cilat janë miratuar një nga një dhe në fund është miratuar raporti me rekomandime me një votë kundër dhe me një abstenim, kurse të tjerat kanë qenë për.

Gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit kemi pasur përkrahje teknike edhe me ekspertë gjermanë, nga bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe nga Instituti Nacional Demokratik jemi përkrahur me angazhimin e ekspertëve ,të cilët në emër të Komisionit i falënderoj.

Ndiej për obligim t'i falënderoj edhe anëtarët e Komisionit për angazhimin e përditshëm dhe për punën profesionale që kanë bërë gjatë këtyre ditëve.

Të nderuar deputetë,

Brenda kufijve buxhetorë, të përcaktuar dhe të harmonizuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, gjatë punës sonë në Komision jemi përpjekur që ta përmirësojmë

projektbuxhetin me një shpërndarje sa më të drejtë dhe sa më të mirë nëpër organizata buxhetore, qofshin ato të nivelit qendror, të nivelit lokal, apo institucionet e pavarura.

Gjatë punës sonë kemi pasur parasysh edhe çështjet e ngritura në Kuvend në seancën, kur është bërë shqyrtimi i parë i projektligjit për buxhetin.

Por, gjatë punës sonë kemi hasur në vështirësi të mëdha sa u përket pagave të funksionarëve të lartë publikë dhe të institucioneve të pavarura të zgjedhura nga Kuvendi, si dhe pagave të stafit të këtyre institucioneve, të cilat në shumicën e rasteve janë jashtë pagave të stafit civil.

Edhe një herë më duhet ta ritheksoj domosdoshmërinë e miratimit të këtij ligji, ku do të përcaktohen pagat e këtyre funksionarëve, si dhe të përcaktohet se deri në çfarë përqindje mund të marrin kompensime dhe mëditje për punën e bërë. Po ashtu, të saktësohet nëse stafi i këtyre institucioneve është staf civil dhe duhet t'u nënshtrohet rregullave të stafit civil.

Në mungesë të këtij ligji, për një zgjidhje të përkohshme deri në miratimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publikë, Komisioni ka kërkuar nga Kryesia që ta autorizojë për ta bërë një rekomandim për përcaktimin e pagave për disa institucione. Kryesia e ka autorizuar dhe Komisioni e ka rekomanduar një vendim për pagat e Avokatit të Popullit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Bordit Mbikëqyrës të Komisionit të Pavarur për Media, i cili kërkojmë të miratohet bashkë me rekomandimet për Projektligjin për buxhetin.

Të nderuar deputetë,  
Komisioni për Buxhet dhe Financa është përpjekur t'i marrë parasysh edhe çështjet e ngritura në raportin e studimit të fizibilitetit, sidomos sa i përket ruajtjes së pavarësisë buxhetore të institucioneve të pavarura.

E ka shqyrtuar kujdesshëm buxhetin e këtyre, përfshirë këtu edhe buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ka mbajtur 18 dëgjime buxhetore, ku kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e këtyre institucioneve të pavarura, si dhe ka rekomanduar 13 amendamente, të cilat e përmirësojnë buxhetin e institucioneve të pavarura.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës ka qenë i involvuar në tërë procesin e hartimit të kërkesës buxhetore të Kuvendit dhe në miratimin e buxhetit të Kuvendit.

Kërkesa e Kuvendit tërësisht ka qenë e përfshirë në projektbuxhetin që e ka sjellë Qeveria dhe për herë të parë Kuvendi nuk ka parashtruar kërkesë shtesë në Komisionin për Buxhet dhe Financa as për paga e mëditje, as për mallra dhe shërbime, e as për investime kapitale.



Pika dy e rekomandimit të Komisionit për Integritim Evropian, sipas Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk është serioze dhe as me vend.

Autonomia e Kuvendit është e rregulluar me ligj dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Buxheti i Kuvendit është hartuar dhe miratuar në pajtim me rregullativën në fuqi. Kurdo që të ndryshohet kjo rregullativë, ne do të veprojmë sipas rregullave të reja.

Më duhet të theksoj se angazhimi kryesor i Komisionit për Buxhet dhe Financa është të sigurojë rregull dhe disiplinë financiare dhe është mirë që të fillohet të kuptohet seriozisht se çka nënkuptohet me pavarësi financiare.

Të nderuar deputetë,

Krejt në fund, më duhet të them se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka bërë përpjekje që të bëjë përmirësimet e nevojshme, ashtu që ta kemi një ndarje sa më të drejtë dhe sa më të mirë nëpër organizatat buxhetore.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kërkoj nga të gjithë deputetët që t'i miratojnë amendamentet e propozuara dhe njëkohësisht ta miratojnë edhe buxhetin për vitin 2013. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryetarët e komisioneve, në emër të Komisionit për Integritim Evropian, fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

**LUTFI HAZIRI:** Faleminderit, kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E falënderoj kryetaren e Komisionit për Buxhet, zonjën Hadërgjonaj, për shpjegimet që i dha, sepse është kërkesë e Komisionit për Integritim Evropian që të sigurohet autonomia buxhetore e Kuvendit të Republikës.

Kjo është kërkesë e raportit të fundit apo rekomandimit të fundit që e ka bërë Raporti mbi studimin e fizibilitetit në Kosovë, kur është thanë që Kuvendi i Republikës, përveç nevojës për rritjen e kapaciteteve monitoruese, mbikëqyrjes së Ekzekutivit dhe mbikëqyrjes së organeve tjera kushtetuese, sipas mandatit, duhet të ketë autonomi buxhetore. Kërkesa ime ka shkuar edhe te Komisioni Evropian që ta zbërthejë se çka nënkuptojnë ata me autonomi buxhetore të Kuvendit të Republikës, sepse kërkesat tjera për ta ushtruar detyrën tonë kushtetuese natyrisht janë mirëpritur dhe ne do të punojmë që bashkërisht ta koordinojmë këtë angazhim.

I mbetet tash ministrit për Financa, zotit Hamza, që në bashkëpunim me Kryesinë e Kuvendit dhe me kryetarët e komisioneve, në këtë rast funksionale, që me digji-ekonomi, që është në Bruksel, zyra kryesore që merret me evoluimin, vlerësimin edhe rekomandimet sa i përket sferës së ekonomisë, buxhetit, financave, të shihet se çka nënkuptojnë. Por, nga ajo që më është thënë, në fakt është që Kosova ka problem me disiplinën buxhetore, me disiplinën fiskale dhe natyrisht rritja e rolit dhe autonomisë

buxhetore të Kuvendit krijon mundësi më të mëdha që Kuvendi të funksionalizohet në ushtrimin e detyrave të veta kushtetuese.

Deri në rishikim buxhetor, kurdo që ndodh brenda vitit kalendarik, do të duhej që kjo çështje të zërthehet dhe të zgjidhet, por i mbetet në përgjegjësinë primare ministrit për buxhet dhe kryetares së Komisionit për Buxhet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ndonjë kryetar i ndonjë komisionit tjetër? Jo. Atëherë është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

*(Ndërprerje nga regjia)*

Ta respektojmë Rregulloren, prandaj po jua lexoj nenin 58, paragrafin e parë: “Shqyrtimi i dytë i projektligjit fillon me paraqitjen e raportit të Komisionit FunkSIONAL, nga raportuesi. Pas paraqitjes së raportit, të drejtën e diskutimit e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, dhe njëri e shfrytëzoj këtë, pastaj përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët. Kështu shkruan në rregullën 58 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe unë po e respektoj këtë rregull.

Nëse nuk e duan fjalën kryetarët e grupeve parlamentare, në emër të grupeve, atëherë ia jap fjalën ministrit, natyrisht nëse ai do ta marrë fjalën. Nëse jo, shkojmë në procedurën e votimit.

I kemi të pranishëm 70 deputetë. Mund të marrim vendime edhe me 70 deputetë. Deputetët po lëvizin shumë! Unë e kam një informatë se brenda një ore kanë qenë diku rreth 100 hyrje-dalje, që vërtet janë të shumta, por ky është realiteti. Ka më shumë, diku rreth 84 deputetë i kanë kartelat, por të pranishëm janë 70.

Në Projektligjin për buxhet për vitin 2013 janë propozuar gjithsej 49 amendamente. Amendamenti numër 43 është propozuar nga deputetja Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamentet numër 44, 45 dhe amendamenti numër 47 janë propozuar nga deputeti Nijazi Idrizi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti numër 46 është propozuar gjithashtu nga deputeti Nijazi Idrizi, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti numër 48 është propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Por, unë mendoj që ky amendament është dashur ta ketë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Ne e kemi miratuar një ligj dhe jemi të obliguar ta respektojmë ligjin që e kemi miratuar. Amendamenti ka të bëjë me dëmshpërblimin e të burgosurve politikë. Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

**ALMA LAMA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me amendamentin që e kam propozuar unë, më duket që është bërë një gabim teknik, sepse amendamenti im gjendet i mbështetur nga Komisioni Funkcional, është marrë pra edhe është vendosur në amendamentin 29, pika 4. Pra, është ky amendament. Mirëpo Komisioni Funkcional e ka shtuar shumën e parave, nga 88 mijë euro, që është shuma që kam propozuar unë, në 120 mijë euro, mirëpo kjo nuk e ndryshon destinacionin. Unë e falënderoj Komisionin Funkcional që e ka bërë këtë. Kur e kam bërë amendamentin kam kërkuar që të përcaktohet edhe zëri buxhetor, duke besuar që Komisioni e ka edhe ekspertizën e nevojshme. Natyrisht unë mund ta kisha vendosur në ministrinë përkatëse, ose në Komunën e Prishtinës, por mendova që t'ia lëmë këtë atribut Komisionit, duke qenë që ka edhe ekspertë, si dhe komisione tjera. Pra, duhet ta sqarojmë që amendamenti im e ka përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe duhet të vendoset në ligj si i tillë. Tani interpretojeni ju rregulloren nëse duhet që të shtohet tek amendamenti 29, pra propozimi i deputetes Alma Lama, me përkrahje të Komisionit Funkcional, ose të ndryshojë amendamenti 43.

Tani tek amendamenti 29 është vendosur pra që kjo shumë t'i dedikohet Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, domethënë kërkoj nga ju që ta interpretoni rregulloren, por si amendament e ka përkrahjen e Komisionit Funkcional, me një plotësim të shumës, ose me një ndryshim të vogël. Faleminderit!

**KRYETARI:** Anëtari i Komisionit, deputeti Naser Osmani e ka kërkuar fjalën.

**NASER OSMANI:** Faleminderit, kryetar!

Me gjithë respektin, konsideroj që do të ishte më mirë që të mos ketë debat lidhur me amendamentet, të cilat i ka bërë Komisioni dhe të hyjmë në procesin e votimit.

Çdo gjë e ka arsyen e vet, dhe Komisioni me shumë përkushtim dhe vëmendje është përqendruar sidomos në disa çështje që janë të natyrës më të rëndë dhe më të ndjeshme, siç ka qenë ajo me amendamentin e zotëri Hydajet Hyseni, që ka të bëjë me të burgosurit, dhe ne e kemi diskutuar dhe kemi menduar që kjo duhet të hyjë në fuqi në vitin 2014, për shkak të ngarkesës të madhe të buxhetit dhe kërkesave buxhetore për këtë vit, e kjo është aprovuar edhe në koordinim edhe me propozuesin e buxhetit dhe konsideroj që, megjithatë, ka qenë një vendim i mirë, nuk është shmangur, por është paraparë të futet në fuqi në vitin 2014.

Sa i përket amendamentit të “Vetëvendosjes”, e kemi kundërshtuar në kuptimin e asaj që nuk kemi dashur ta bëjmë një Monument të gruas të luftës në Prishtinë, me iniciativë të një subjekti politik. Arsyeja ka qenë që kjo figurë apo ky monument do t'i shërbente vetëm një partie, që shkon e i përkulet.

Ideja ka qenë që të mos përkrahet, sepse edhe nuk kanë qenë mjetet të destinuara se cili dhe kush ta bëjë, kush ta ngre këtë monument. Vetëm ka qenë si shumë abstrakte. Ideja jonë, e imja dhe e kryetares, edhe e grupit, ka qenë që në emër të Komisionit, që është i përbërë prej të gjitha grupeve parlamentare, të ndahet një shumë e mjaftueshme prej 120 mijë eurove, t'i jepet Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, që me një tender ndërkombëtar ta bëjë një monument që ne kemi menduar se ndër figurat më të mira do të

ishte sigurisht, për mendimin tim, Nekibe Kelmendi si intelektuale, patriote e sakrificës dhe Xhevë Ladrovci, si një heroin e kësaj lufte.

Mirëpo, tenderi mund të japë ide të ndryshme dhe të mos ketë figurë, por të ketë një monument të përkushtuar femrës, prandaj kemi dashur që kjo të jetë e të gjitha subjekteve politike, por të mos jetë vetëm e “Vetëvendosjes”.

**KRYETARI:** Prej shiut në breshër, prej politikës në politikë. Megjithatë, urdhëro, kundër-replikë Alma Lama.

**ALMA LAMA:** Sinqerisht më vjen keq që deputeti Osmani nuk e kupton që unë jam deputete e Kuvendit të Kosovës. Unë e kam bërë një propozim, një amendament, duke iu përmbajtur Rregullores dhe ky amendament vetëm kur të marrë votat e Kuvendit të Kosovës ka vlerë. Por, ne po flasim këtu, unë mendova që është një gabim teknik. Nuk e dija që ju paskëshit menduar se kujt do t’ia kushtojmë monumentin.

Megjithatë, zoti kryetar, më lejo ta lexoj arsyetimin, idenë, se si unë kam shtjelluar dhe çfarë kam menduar në lidhje me këtë.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë janë ndërtuar me dhjetëra statuja dhe memorialë për ta nderuar veprën e luftëtarëve për liri. Vetëm në buxhetin e vitit 2013 është parashikuar ndërtimi i 34 përmendoreve nëpër komuna të ndryshme, por asnjëra nuk i përket figurës së një gruaje, edhe pse kanë kaluar 13 vjet, edhe pse vajzat dhe gratë u angazhuan për ta sjellë lirinë e Kosovës, me të njëjtin përkushtim e sakrificë, herë-herë në rrethana shumë më të vështira, asnjë status apo memorial nuk u është kushtuar atyre, duke e vulosur kështu një akt padrejtësie. Kjo mungesë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Shiko Alma, unë mendoj që kur të shkruhet ligji, amendamenti nuk dihet i kujt është. Është një nen. E rëndësishme është që ajo çështje ka hyrë në ligj dhe ju kisha lutur të mos e politizoni. Unë mendoj që propozimi, edhe i juaj, edhe ajo që e ka bërë si të veten Komisioni, kur të hyn në ligj është i Parlamentit, prandaj të mos e politizojmë këtë çështje.

*(Ndërhyrje)*

Po mirë, le të jetë amendamenti i Komisionit dhe i Almës, dhe shkon. Kryesorja, është ai amendament, ai arsyetim, ka hyrë dhe është pranuar si i tillë. Urdhëro! Safetja pastaj Visari.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

Unë fjalën time thashë se gjatë shqyrtimit të Projektligjit për buxhetin ne jemi përpjekur t’i marrim parasysht edhe çështjet, të cilat janë ngrehur në seancën plenare gjatë shqyrtimit të parë.

Çështja e ngritjes së një monumenti për femrat, të cilat kanë kontribuar në luftë është një çështje që është ngritur shumë më herët nga Grupi i Grave Deputete, dhe kjo çështje është ngritur njëkohësisht edhe nga deputetet në raste të ndryshme, por është ngritur në seancën plenare edhe nga deputetja Lama.

Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë punës së vet edhe në grupet punuese, edhe gjatë punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar me kujdes një propozim që ka ardhur, të cilin deputetja Lama ka thënë se do ta bëjë në emër të Grupit të Grave Deputete, por në fund ka ardhur në emër të deputetes Lama. Ne e kemi shqyrtuar dhe kemi ardhur në përfundim, në bazë të analizave që i ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa, që shuma prej 88 mijë eurove nuk është e mjaftueshme për ngritjen e një monumenti të tillë dhe në konsultim edhe me përfaqësuesit nga Ministria, kemi ardhur në përfundim që ia vlen të ndërtohet një memorial që do ta simbolizojë punën, angazhimin dhe sakrificën gjatë luftës, që gruaja e ka bërë në luftë gjatë viteve '98 dhe '99 dhe kemi menduar që të shtohet vlera e kësaj shume në 120 mijë euro, e kjo shumë të kalojë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke llogaritur që do të miratohet edhe ligji që do të merret direkt me të dhe do të përcaktohet forma se si do të jetë ky monument dhe çfarë do të jetë.

Pra, kjo është çështja - iniciativa ka ardhur nga Grupi i Grave Deputete, deputetja e ka paraqitur amendamentin, amendamenti nuk është përkrahur ashtu krejt siç ka kërkuar deputetja, por është përkrahur në një formë tjetër. Është në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kështu që unë mendoj që nuk ka gjë të keqe. Është përfshirë në amendamente dhe kisha kërkuar nga deputetët që ta votojnë, ngase është në amendamentin 29, pika 4, në atë amendament.

**KRYETARI:** Mirë, faleminderit! Mua më vjen mirë që megjithatë është arritur diçka që e kemi harruar dhe sigurisht ndoshta është mirë që edhe shuma të precizohet se nuk dihet si do të zhvillohet, por vërtet gruaja shqiptare e meriton një monument më dinjitoz, e ne deri më tani e kemi harruar. Sikur kemi harruar se gratë tona janë nëna.

*(Reagime)*

Unë për gruan thashë, nuk thashë si e kuptuat ju. Se gruaja është nëna e secilit nga ne, po e them pak më drejt tash.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Të pranishëm janë 86 deputetë. Kur shkojmë te amendamenti përkatës, mund të flasim.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani kem amendamente në pjesën tabelare të projektligjit.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Të pranishëm janë 86 deputetë.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21, fjalën e ka kërkuar kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Unë e kërkoja fjalën të amendamenti 21 për ta dhënë një sqarim. Është po ashtu në këtë amendament në nënparagrafin 101, anëtarët e Kuvendit, kategoria subvencione dhe transfereve, shuma prej 30 mijë eurove ndryshohet në shumën 60 mijë euro. Domethënë janë shtuar mjete prej 30 mijë eurove. Është një kërkesë e Grupit të Grave Deputete që të ndahen mjete për blerjen e Mamografit mobil, kështu që propozimi ka ardhur nga ato dhe është përkrahur nga i gjithë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Prandaj, unë desha vetëm ta sqaroj që është fjala për ndarjen e mjeteve për Mamografin mobil.

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Urdhëro, deputete Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë, amendamenti të cilin kam paraqitur unë ka ardhur dy herë në këtë dokument, që ne po e votojmë sot. Një herë tek amendamenti 29 dhe një herë tek amendamenti 43. Meqë ju po doni që të përfshihet tek amendamenti 29, ju lutem më lejoni ta lexoj arsyetimin e amendamentit.

*(Reagime)*

Sepse kështu i bie, po sikur të votohet amendamenti 43...

KRYETARI: Ju lutem!

ALMA LAMA: Unë e kam të drejtën e fjalës, në bazë të Rregullores.

KRYETARI: Po, po, e ke të drejtën e fjalës, por amendamenti 43 s'ka nevojë të jetë, ai ka ardhur në pikën 4 të amendamentit 29, dhe është rregulluar kjo.

ALMA LAMA: Në rregull, atëherë le të përcaktohet...

KRYETARI: Ju lutem!

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.



Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër, nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43, propozim i deputetes Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Ne e kaluam, mendoj që hyri, tani është pa objekt.

Amendamenti 44, propozimi i deputetit Nijazi Idrizi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Deputet, a tërhiqesh? Regjia, fjalën deputetit Nijazi Idrizit.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky amendament dhe amendamenti 47 kanë të bëjnë me dy shkolla, të cilat janë në prag të rrënimit, të cilat shtrihen në një grykë, ku ka erë gjatë dimrit dhe të cilat janë të ndërtuara në vitet e '50-ta. Këto realisht i përkasin një kohe kur janë ndërtuar kooperativat bujqësore dhe nxënësit i vijnë mësime në këto shkolla.

Kam informacion nga njerëzit atje se fëmijët gjatë stinës së dimrit pothuaj gjithnjë janë me rrafë, me grip, për shkak se këto shkolla e lëshojnë ujin, e lëshojnë erën edhe janë në një pozitë shumë të rëndë.

Vlera e këtyre shkollave nuk është e madhe, është një prej 300 mijë eurove, dhe unë pres që të mbështetet nga të gjithë ju, për shkak se kemi të bëjmë me dy shkolla në të cilat i vijnë mësime nxënësit e vendbanimeve të thella rurale, ku ka pak fëmijë dhe vlera e këtyre shkollave është vërtet shumë simbolike. Unë e pres mbështetjen tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Komisionit, çfarë thotë? Safete, është fjala për amendamentin 44.

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar, unë po e jap një sqarim për amendamentet 44, 45, 46, 47. Janë amendamente të cilat janë propozuar nga deputeti Nijazi Idrizi. Përpos amendamentit 46, që është përkrahur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, domethënë është përkrahur ndërtimi i një shkolle, që është objekt i shkollës fillore “Afërdita” në Kishnapolë, me vlerë prej 211 mijë eurove.

Amendamentet tjera nuk janë përkrahur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, kështu që unë rekomandoj ta miratojmë amendamentin që është përkrahur nga Komisioni, kurse tjerat të mos miratohen.

KRYETARI: Mirë. Faleminderit!

Atëherë shkojmë në votim me elektronikë për amendamentin 44, i propozuar nga deputeti Nijazi Idrizi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 30 vota për, 31 kundër dhe 4 abstenime, nuk kalon.

Amendamenti 45, i propozuar nga deputeti Nijazi Idrizi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 27 vota për, 36 kundër dhe 4 abstenime, nuk kalon.

Amendamenti 46, i propozuar nga deputeti Nijazi Idrizi, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 72 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 46, i propozuar nga deputeti Nijazi Idrizi, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 47, i propozuar nga deputeti Nijazi Idrizi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 27 vota për, 39 kundër dhe 5 abstenime, nuk miratohet amendamenti 47.

Amendamenti 48, i propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Fjalën e ka kërkuar deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Shoqata e të Burgosurve Politikë e ka dërguar një kërkesë për miratimin e Projektligjit dhe aktet nënligjore dhe buxheti për të burgosurit politikë.

Ne e kemi gjithë dokumentacionin që u është dërguar ministrive dhe e kemi sponsoruesin, që po ashtu u është dërguar, por ky projektligj që është miratuar më 10 dhjetor 2010 ende nuk po gjen zbatim dhe mendoj që është një ndjeshmëri shumë e rëndësishme që Qeveria ta ketë parasysh këtë. U desh ta ketë parasysh edhe në buxhet. Ka arsye të thuhet që nuk janë plotësuar ndoshta, por në bazë të ligjit thuhet që në afatin brenda 6 muajve duhet të nxirren aktet nënligjore dhe të procedohet për ligjin për miratim për dëmshpërblimin e të burgosurve politikë. E kjo nuk është bërë tashmë dy vjet.

Prandaj, kërkesa i është ministrit të Drejtësisë, ministrit të Mirëqenies Sociale, ministrit të Arsimit, ministrit të Financave, ministrit të Zhvillimit Ekonomik, ministrit të Mirëqenies Sociale, ministrit të Shëndetësisë, të gjithë resorëve të cilët kanë të bëjnë me këtë çështje. Prandaj, lënia anash e një kodi buxhetor për dëmshpërblimin e të burgosurve në këto rrethana tregon që ne ende nuk e kemi një kujdes të mjaftueshëm, ende nuk e kemi zgjedhur një çështje, e cila është shumë e ndjeshme, meqë ne të gjithë i shfrytëzojmë të mirët e atyre njerëzve, të cilët kanë sakrifikuar pikërisht për ditën për të cilën ne sot jemi në Kuvendin e Kosovës.

Edhe ne si deputetë, edhe si kryeministër, edhe si kryetar Kuvendi, edhe si ministra, të gjithë jemi përgjegjës ndaj atyre njerëzve, të cilët e kanë kaluar një kohë të gjatë nëpër burgje, të cilët sot janë pjesë e rasteve sociale dhe janë pjesë e dinjitetit e krenarisë tonë dhe të kombit tonë, prandaj është dashur dhe duhet t'u ndihmohet këtyre njerëzve, t'u jepet ai dëmshpërblim, t'ju kthehet ajo vlerë sadopak edhe një euro nëse është, por kur shteti i shpërblen, ajo është një dinjitet që u kthehet atyre njerëzve që kanë sakrifikuar që ne sot të jemi edhe në Kuvend të Kosovës edhe si shtet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën për një sqarim. Ta dëgjojmë fjalimin e ministrit Bedri Hamza.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar,

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Më 29.10.2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka aprovuar Ligjin për të burgosurit politikë. Janë krijuar të gjitha parakushtet për fillimin e implementimit, për fillimin e pagesave për dy ligje, për dy kategori shumë të rëndësishme që kanë kontribuar shumë për këtë vend, kategoria e veteranëve të luftës dhe kategoria e të burgosurve politikë.

Nuk është problem kostoja dhe mbulimi i koston për këto kategori. Situata është se më datën 18.10.2012 ka ardhur kërkesa për dhënien e vlerësimit të ndikimit buxhetor për Rregulloren e punës së Komisionit. Unë e falënderoj Shoqatën e të Burgosurve Politikë, që ka dhënë kontributin e vet, mirëpo për të qenë pjesë e buxhetit duhet që të aprovohen aktet nënligjore, që të dihet kostoja financiare, ka një vlerë parallogaritare, të kryhen këto dhe nuk ka asnjë pengesë nuk ka që në proceset e ardhshme buxhetore, qysh gjatë rishikimit të Buxhetit të merren në konsideratë dhe të bëhen pjesë e buxhetit.

Mirëpo, derisa komisionet nuk e kryejnë punën e vetë, derisa aktet nënligjore nuk aprovohen në Qeveri, derisa nuk e dimë koston ekzakte të këtyre ligjeve, nuk mund të përfshihen në Buxhetin e Kosovës.

Për ta ditur koston duhet ditur numri i këtyre kategorive, duhet të dihet lartësia e kompensimit, të vijmë te vlera financiare dhe ju siç e shihni, në projeksionet e ardhshme brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është kalkuluar kosto e përafërt, e cila do të prodhohet nga fillimi i implementimit të këtyre dy projektligjeve. Po flas për kategorinë e veteranëve të luftës dhe kategorinë e të burgosurve politikë. Kjo është një kujdes simbolike, sepse çfarëdo para të jepet për këto dy kategori, munda, sakrificat, vuajtjet e këtyre kategorive nuk mund të kompensohen.

Prandaj, unë ju kisha lutur për mirëkuptim, se komisionet janë duke punuar, është duke u verifikuar numri, janë duke u finalizuar aktet nënligjore, me finalizimin e akteve nënligjore do ta dimë koston financiare dhe në momentin kur do t'i kemi këto të dhëna krijohet mundësia dhe nuk ka asnjë pengesë, që këto të bëhen pjesë e Buxhetit dhe të fillojë kompensimi për këto kategori.

Prandaj, në mungesë të akteve nënligjore s'ka mundur të vijë deri te deklarata për ndikimin buxhetor, duhet të presim derisa të finalizohen dhe unë jam shumë i sigurt, që në procesin e ardhshëm buxhetor, qysh në rishikim do të fillojë startimi i implementimit të këtyre ligjeve. Faleminderit shumë!

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër! Unë kam mirëkuptim për veteranët e luftës, se nuk dihet numri i tyre, por është krejt e paarsyeshme që të mos dihet numri i të burgosurve politikë, kur ata janë me dokumente dhe nuk kanë ndenj 3-4 muaj, por kanë ndenj me vjet në burg.

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar!

Unë do t'i theksoj dy çështje, sa i përket këtij projektligji për të drejtat e ish- të dënuarve politikë.

E para, arsyeshmëria që e dha ministri, nuk duhet edhe të ceket në këtë formë, sepse Qeveria ka qenë e obliguar që gjashtë muaj pas miratimit të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore dhe ligji të zbatohet gradualisht në periudhën katërvjeçare, kompensim gradual jo dëmshpërblim, se dëmshpërblim është dashur shteti serb dhe jugosllav, që i ka burgosur, por kompensim gradual për këtë kategori.

E dyta, nuk duhet të barazohen këto dy projektligje, sepse nuk është treguar vullnet, siç shihet, për implementimin e tij dhe kjo duhet të theksohen arsyet e qarta.

Dhe e treta, çka është me rëndësi, ligjet që janë iniciativë e vetë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk po implementohen. Dhe, kjo duhet të theksohet. Kjo është edhe arsyeja tjetër. Edhe ky ligj është miratuar, si iniciativë e deputetëve të Kuvendit të

Republikës së Kosovës diku me 90 nënshkrime dhe ka hyrë në fuqi më 29 tetor 2010. Po ashtu, ka ndodhur edhe me ligjin tjetër për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Prandaj, këtu tregohet që nuk po respektohet Kushtetuta, balancimi i qartë në mes të pushteteve dhe kjo është arsyeshmëria e parë që duhet të theksohet. Pa marrë parasysh, të gjithë e dimë edhe koston financiare që mund të ketë edhe implikimet buxhetore, por të fillojë një kompensim gradual, është dashur të bëhet në përpikëri me ligjin, ashtu siç e thotë ligji dhe ashtu siç i ka nxjerrë edhe vetë komisioni dhe që edhe këtu nga shkresat e paraqitura thuhet se komisioni ka arritur vetë, ekziston pëlqimi i Ministrisë së Drejtësisë, i vet kryeministrit dhe i dikastereve tjera qeveritare.

Prandaj, nëse gjejmë arsyeshmëri që të rriten në buxhete në shumë dikastere qeveritare edhe pasi ka ardhur projektbuxheti në lexim të dytë me mallra e shërbime, rritja e numrit të punëtorëve, blerja e automjeteve, është dashur që edhe këtu të fillojë një kompensim gradual për këtë kategori të ish të dënuarve politikë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëro! Ministri Bedri Hamza e ka fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Deputet i nderuar,

E para, këto dy projektligje nuk lidhen njëri me tjetrin, po të dyja janë të rëndësishme, të dy kategoritë janë të rëndësishme dhe ne i kemi krijuar parakushtet për fillimin e implementimit të dy këtyre projektligjeve.

Ne kemi ndarë si Qeveri mjete edhe për komisionet, të cilat janë duke punuar dhe ne shpresojmë që shumë shpejt të kryhet puna e tyre. Është e vërtetë që ky projektligj është aprovuar me iniciativën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, mirëpo është edhe i vërtetë fakti, se këtij projektligji i ka munguar deklarata për ndikimin buxhetor. Prandaj, nuk ka mundësi, pa u finalizuar aktet nënligjore, të nxirret kosto ekzakte e këtij projektligji. Ne po presim që shumë shpejtë, domethënë në fillim të vitit të ardhshëm, të kryhen të gjitha aktet nënligjore, të dihet kostoja e këtij ligji. Jemi shumë të vetëdijshëm të gjithë ne dhe pajtohemi me atë që ka vonesa, por në procesin e parë buxhetor, që do të ndodhë kur të finalizohen këto, nuk ka kurrfarë pengese që të bëhet pjesë e buxhetit dhe të fillohet me implementimin e tyre. Mirëpo, pa u kryer këto, është e pamundur kur ka ardhur kërkesa për vlerësimin e koston së Rregullores së punës së komisionit e të bëhet pjesë e Buxhetit, po buxheti është finalizuar shumë më herët.

Prandaj, unë jam shumë i sigurt që të gjitha aktet nënligjore do të rregullohen, kostoja e përafërt dihet, do të aprovohen në Qeveri dhe do të bëhen pjesë e buxhetit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit!

Po dua t'i përgjigjem ministrit rreth numrit, se nuk dihet numri. Domethënë, ne i kemi tash dy vjet, kur është miratuar ligji që folëm edhe më herët, më 10 dhjetor 2010. Ligji ka qenë dashur të hyjë në fuqi gjashtë muaj më vonë, ndërsa juve u ka dërguar një letër nga

kryetari i komisionit Hydajet Hyseni, i cili ju jep specifikat e sakta të kostos, të numrit, të kohës së qëndrimit në burg, të gjitha shpjegimet.

Unë mendoj që është koha e fundit që të ju jepet një satisfaksion këtyre njerëzve, sepse mendoj që jo vetëm që e meritojnë, po të paktën edhe ne si njerëz të jemi ballëhapur para tyre, se e dimë shumë mirë ministër, se çfarë situatash kanë kaluar ata njerëz.

Nuk po mendoj që këta kanë nevojë për lëmoshë, po sido që të jetë nuk është një kosto e madhe financiare, e cila do ta dëmtonte Buxhetin e Kosovës në rast se ne e kalojmë amendamentin e propozuar nga Hydajet Hyseni. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

**HALIT KRASNIQI:** Unë jam anëtar i Komisionit qeveritar për njohjen e statutit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, i përfaqësuar nga Kuvendi dhe i zgjedhur këtu në këtë Kuvend. Dhe, unë do të them nja dy fjalë për këtë, po para se të shprehem për këtë preokupim dhe për këtë temë e lus kryetarin e Kuvendit, kushën tim të dashur, që të mos e keqpërdor mikrofonin dhe pozitën e kryetarit dhe të mos e merr rolin e institucionit të njohjeve, të dijeve dhe të verifikimit të përgatitjeve, sepse jemi familjarë, kemi rrethet tona, kemi një farefisni, që na përcjell dhe natyrisht se i përjeton ndryshe nga ne që jemi kolegë bashkëpunëtorë dhe shokë e miq këtu, në këto ambiente të përditshme dhe shkëmbejmë edhe batuta edhe pak a shumë, ndoshta edhe me një tolerancë e mirëkuptim të ndërsjellë, që familjarët tanë, miqtë tanë, farefisi ynë nuk mund të ketë mirëkuptimin që e kemi ne në mes vete.

Kështu që, ju kisha lutur, jo vetëm me mua, po edhe me të gjithë deputetët të jeni shumë korrekt dhe të mos e keqpërdorni foltoren dhe pozitën e kryetarit të Kuvendit.

*(Ndërhyrje)*

Jo, tani do të flas për një preokupim, që pjesë e kësaj është edhe zoti kryetar...

**KRYETARI:** Regjia, ia ndal fjalën, se ka qenë jashtë rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

**NASER OSMANI:** Kryetar, faleminderit!

Ndër të tjera, që e tha ministri edhe të tjerët, ka një çështje që duhet kuptuar, që është një teknikë në hartimin e Buxhetit, që duhet të ruhet balanca buxhetore.

Nëse aprovohet ky amendament, kryetar, nëse e aprovon këtë amendament, në mënyrë automatike duhesh ta aprovosh edhe një amendament tjetër për të treguar se ku do t'i marrësh paratë, se nuk mundesh vetëm të shtosh e të mos tregosh burimin se ku do t'i marrësh.

Prandaj, çdo gjë në këtë strukturë buxhetore priset. E vetmja mundësi, kryetar, është që në rishikim, domethënë, pas gjashtë muajsh, Qeveria, ministri i Financave, e përgatitë

dhe e tregon burimin se ku do t'i marrë për ta mbuluar atë shpenzim. Këto janë rregulla, nuk guxojmë t'i thyejmë këto rregulla. Prandaj, po insistoj që të mos ketë shumë debat rreth kësaj.

**KRYETARI:** Jo, debat realisht duhet të ketë. Dhe, unë po e mirëkuptoj këtë që po thua edhe ti edhe që po thotë edhe ministri, por keni pasur kohë këtë çështje me e zgjedhë shumë mirë deri më tani, pa pasur nevojë që të bëhet ky amendament nga një deputet i Kuvendit të Kosovës. Kryeministri e ka fjalën.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kabinet Qeveritar,

Unë dua të jem shumë i hapur sa i përket kësaj çështjeje që e kemi diskutuar shpeshherë si Qeveri e Kosovës me Shoqatën e të Burgosurve Politikë, por dëshiroj të ndërlihem pak në një rrafsh më të gjerë edhe sa i përket veteranëve të luftës edhe sa i përket familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës.

Plotësisht pajtohem me pozicionin e ministrit të Financave. Ne kemi diskutuar me Shoqatën e të Burgosurve Politikë dhe ka qenë një nga prioritetet tona kryesore si Qeveri, që të zgjidhim njëherë e përgjithmonë çështjen e të burgosurve politikë. Natyrisht se tash mund të lexojmë letra çfarë të duam neve, por duhet definitivisht të qartësohet numri dhe kategorizimi i të burgosurve politikë. Po flas, numri dhe kategorizimi, prej cilës periudhë deri në cilën periudhë, tash unë nuk dëshiroj sot t'ju lodhë këtu me këtë çështje që e kemi diskutuar në brenda në takime për periudha kohore dhe kategorizimet, sepse tek e fundit edhe ai që ka qëndruar edhe vetëm një moment, një orë, një ditë, 24 orë, është, ka qenë i burgosur nga Serbia dhe meriton trajtimin institucional dhe të përgjegjshëm dhe në anën tjetër, ne jemi zotuar dhe kemi punuar bashkërisht, që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejtë që është e mundur, ka qenë iniciativë e jonë, do ta realizojmë, por do ta realizojmë në gjashtëmujorin e ardhshëm. Kjo është edhe marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar, do të thotë në procesin e rishikimit. Dhe, kërkoj mirëkuptim nga deputetët për këtë punë, sinqerisht ju them, kolosale, që e kemi bërë, bashkërisht Qeveria me Shoqatën e të burgosurve politikë dhe kategoritë tjera të burgosurve, sepse duhet t'i kemi parasysh edhe periudhën '90 - '98, '99, duhet të kemi parasysh edhe të izoluarit e viteve '89-ta, '88 dhe kategoritë tjera.

Gjithashtu, sa i përket veteranëve, ju e dini se aplikacionet kanë filluar. Përsëri edhe sot e shfrytëzoj rastin nga foltorja e Parlamentit të Kosovës, t'i ftoj të gjithë veteranët, të gjithë kontribuuesit për çlirimin e vendit, të aplikojnë, që ky proces të përmbyllet sa më shpejtë dhe sa më mirë dhe t'i lehtësohet barra dhe puna e Qeverisë dhe në kuadër të kësaj edhe obligimet tona shtesë, që do t'i kemi për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës. Por, sa i përket të burgosurve politikë, e ritheksoj edhe njëherë, me respektin më të lartë dhe i falënderoj shumë për mirëkuptimin që kanë treguar, për bashkëpunimin e ngushtë, shteti i Kosovës do t'i kryejë me përgjegjësi të gjitha zotimet, që i kemi marrë bashkërisht, por duhet të kemi parasysh edhe që të jemi korrektë në punë, të qartësojmë numrin dhe kategorizimin dhe, kjo është e nevojshme për Buxhetin. Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj që u krye debati për amendamentin 48, pasi Qeveria po thotë që me rishikim do ta shikojmë. Edhe unë jam që të jemi të mirëkuptueshëm për këtë, por megjithatë po shkojmë me procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash amendamentin 48, të deputetit Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Debatin e dëgjuat.

Me 27 vota për, 36 kundër, një abstenim, nuk miratohet amendamenti 48.

Amendamenti 49.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Dhe, tani shkojmë Votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 64 vota për, 26 kundër, një abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2013.

Tani po i kthehemi pikës së katërt, pasi e kemi numrin e deputetëve:

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Nëse jeni dakord, votojmë tash.

Të pranishëm 94 deputetë.

Me 89 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miraton ose e ratifikon Marrëveshjen për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

#### **6. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimin e anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura**

Mendoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës shkon menjëherë në votim. Votojmë tash!



Me 73 vota për, 4 kundër, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi propozim-vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimin e anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri Zenun Pajazitin, që në cilësinë e hartuesit të projektligjit para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Siç e dini, ky është një projektligj, plotësim ndryshimi i të cilit vjen nga iniciativa e Kuvendit të Kosovës, nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Vitin e kaluar kemi pasur, kemi bërë si komision monitorimin e zbatimit të këtij ligji, rrjedhimisht me rekomandimet që janë aprovuar në këtë Parlament. Një prej rekomandimeve ka qenë që ky projektligj duhet të ndryshohet. Tanimë në procedurë është në një fazë e rëndësishme.

Siç e dini, ne e kemi kaluar nëpër një trajtim plotësim ndryshimin e këtij ligji. Po ashtu, e kemi kthyer në Qeveri. Kemi edhe komentet e Qeverisë të cilat janë bashkëngjitur të cilat deputetët i kanë me vete, nëse ka nevojë, besoj edhe ministri do t'i sqarojë.

Komisioni i sugjeron Kuvendit dhe grupeve parlamentare, që ta aprovojnë në lexim të parë dhe po ashtu i fton të gjithë deputetët që janë të interesuar, t'i trajtojnë të gjithë amendamentet që i kemi si komision, i kemi nxjerrë, janë propozime edhe të komisionit edhe të institucioneve të ndryshme pjesëmarrëse në draftimin e ndryshimeve dhe po ashtu, komentet e Qeverisë, në mënyrë që ky projektligj të dalë sa më i kompletuar në fazën finale. Ju falënderoj dhe ju ftoj ta mbështetni!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Pajaziti! Ju lus për pak qetësi! Tani është radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike... Regjia ka harruar ta vendosë zotin ministër.

Urdhëroni, e keni fjalën. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, zoti Beqaj.

**MINISTRI BESIM BEQAJ:** Faleminderit shumë, nënkryetar i Kuvendit!

Nënkryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03 L-163 për minierat dhe mineralet është iniciuar, siç u tha edhe nga kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri nga ky komision, në koordinim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe institucione tjera përkatëse.

Propozimet për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji janë si rezultat i nevojës për të lehtësuar zbatimin në praktikë të Ligjit për miniera dhe minerale, me qëllim të promovimit të aktiviteteve minerare, të hulumtimit, shfrytëzimit dhe pasurimit të mineraleve, inkurajimin dhe nxitjen e investimeve në sektorin minerar, zhvillimin dhe modernizimin e këtij sektori në kushtet e ekonomisë së tregut, bazuar në konkurrencën e ndershme, në iniciativë të lirë, si dhe sistemin informativ unik për resurset minerale, konform standardeve ndërkombëtare.

Arsyeja për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për minierat dhe mineralet është e një rëndësie të veçantë, ngase legjislacioni në fuqi nuk rregullon në tërësi këtë materie, andaj me propozimet e bëra, ligji do të jetë më i kompletuar gjatë zbatimit.

Plotësimet dhe ndryshimet e planifikuara të Ligjit për minierat dhe mineralet do të mundësojnë krijimin e një ambienti më të favorshëm për investime. Përmes këtij ligji plotësohet infrastruktura ligjore, promovimi i sektorit në përputhshmëri me standardet e pranuarra mjedisore të hulumtimit, të nxjerrjes, pasurimit, për rregullim të mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimin dhe mbështetjen e një pjesëmarrjeje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimizimin e hulumtimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, si dhe rregullimin e mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të dhënave gjeo-shkencore me interes të ekonomisë së Republikës së Kosovës.

Këto amendamente, të cilat janë propozuar, i përmendi edhe deputeti Pajaziti, janë koordinuar edhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ne kemi bërë edhe shpjegimet, amendamentet dhe vërejtjet tona dhe unë i sugjeroj deputetët që gjatë leximit, në mes të leximit të dytë, gjithsesi t'i marrin parasysh edhe amendamentet dhe komentet, të cilat janë bërë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe USAID-i, në mënyrë që ta kompletojmë ligjin dhe të kemi në tërësi ligj funksional.

Prandaj, më lejoni zoti nënkryetar, t'i ftoj deputetët që ta votojnë në parim, por njëkohësisht edhe t'i përfshijnë të gjitha sugjerimet dhe komentet të cilat kanë ardhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me USAID-in dhe me ekspertët tjerë të kësaj fushe. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përsëritje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar këtë ndryshim dhe plotësim të Projektligjit për miniera dhe minerale.

Fillimisht dua të shpreh se e mbështet në parim këtë ligj. Siç e përmendi edhe kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, e ka paraparë që të ndërhyjë, të plotësojë dhe ndryshojë Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe arsyeja për plotësim dhe ndryshim ka dalë edhe nga monitorimi i këtij ligji në vitin e kaluar, se sa po zbatohet, ku janë vështirësitë, ku janë zbrastitë dhe mangësitë, e që duhet të përplotësohet.

Ky ligj mbi të gjitha, risi nga ky ligj është se rregullohet përfshirja e hulumtimit të gazit dhe naftës. Mbi të gjitha është shumë e rëndësishme se Qeveria e Kosovës është në përpjekje e sipër që të krijojë një ambient të favorshëm të bërit biznes në Kosovë, kështu që ndryshimet në këtë ligj janë paraparë edhe me shkurtimin e afateve kohore për dhënien e licencave të hulumtimit dhe të shfrytëzimit. Ka edhe ndryshime tjera, mjaftë përmbajtësore, mandej, kapitulli ku ka të bëjë me procesin konkurrues të mineraleve energjetike në këtë ligj është paraparë që të harmonizohet procesi me Ligjin për partneritet publiko-privat.

Mandej, tek garancitë që i japin të licencuarit, për licenca të hulumtimit dhe shfrytëzimit është paraparë një lehtësi, sepse ka pasur vështirësi që iu është paraqitur bizneseve dhe kompanive në këtë drejtim. Mbi të gjitha, ne mendojmë se me plotësimin dhe ndryshimet e këtij ligji, ky ligj do t'i joshë më tepër investitorët potencialë, investitorë të jashtëm dhe të brendshëm, në mënyrë që të investojnë në këtë segment mjaftë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Çuditërisht, gjatë tërë kohës edhe më herët, kur është hartuar ky ligj, po edhe tani ndoshta mbas miratimit të buxhetit, po shihet një mosinteresim edhe i deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që unë mendoj që komplet ne duhet të kemi një vëmendje të posaçme, për pasuritë nëntokësore të cilat i ka Kosova. Dhe, mendoj se është një segment jashtëzakonisht i rëndësishëm, ndoshta më i rëndësishmi, që mund ta ngjallë dhe ta zhvillojë ekonominë e Kosovës.

Edhe një herë po e përsëris, e mbështesim si Grup Parlamentar dhe i ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta mbështesin. Shpresoj që do ta kemi mbështetjen e të gjitha grupeve parlamentare, sepse pjesë e Grupit Punues të këtij ligji kanë qenë përfaqësues të gjitha grupeve parlamentare që janë në Kuvendin e Kosovës dhe jemi pajtuar me shumicën e ndryshimeve të këtij ligji. Mbasandaj i ka sjellë edhe Qeveria disa plotësim-ndryshime, që i ka paraparë dhe ne gjatë fazës së amendamentimit, do të na jepet mundësia që edhe një herë të kontaktojmë me grupet e interesit dhe me faktorët relevantë të fushës së pasurive nëntokësore dhe do ta perfeksionojmë në fazën e amendamentimit ligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Ministra të nderuar,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka disa vërejtje serioze sa i përket propozimit të projektligjit.

Unë do të filloj nga shmangia e procesit tenderues në dhënien e pasurive minerale energjetike. Si parim, shmangia e procesit tenderues është në kundërshtim të plotë me parimin bazë të ekonomisë së tregut e që ka të bëjë me konkurrencën.

Në anën tjetër unë jam i bindur se as Qeveria nuk do të kërkonte që ajo ta ketë të drejtën e dhënies së resurseve energjetike me një proces jo tenderues, apo jo konkurrues e që të jetë thjesht një qëndrim, të mos themi subjektiv në momentin e caktuar, por që është edhe në raste të caktuara, themi mund të jetë jo vlerësim real apo jo vlerësim i drejtë e që shkon në dëm të shfrytëzimit efikas të pasurive natyrore.

Në anën tjetër, dhënia e të drejtës Kuvendit që të vendosë për një vendim të Qeverisë lidhur me dhënien pa proces tenderues të një pasurie natyrore, mendoj që është e dëmshme, se e kthen një çështje që është tipike ekonomike apo për fillimin e vendit në një proces, thjesht në një votim politik në Kuvend apo të mos themi në një votim partiak.

Çështja tjetër ka të bëjë me licencimin e bazave të asfaltit dhe të betonit. Ne nuk besojmë që ka ndonjë arsye të logjikshme apo arsye ekonomike për futjen në licencim të bazave të betonit dhe të asfaltit. Ato janë, praktikisht ndërtimtaria është një ndër sektorët më pompoz dhe një ndër sektorët, i cili më së shumti po kontribuon në zhvillimin ekonomik të Kosovës, kështu që nuk besoj se me masë administrative arrihet zhvillimi më i mirë, apo arrihet një punësim më i madh.

Në anën tjetër, është si parim po flasim, është në kundërshtim me proklamimet e Qeverisë dhe të Parlamentit, për lirimin e ekonomisë dhe bizneseve nga licencat e ndryshme, kurse, nëse bash është e nevojshme të bëhet një licencim i tillë, ne besojmë se nuk ka nevojë kjo të bëhet nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, po të bëhet nga Ministria kompetente, që është për industrinë, në këtë rast Ministria për Tregti dhe Industri.

Megjithatë, ne jemi shumë fuqishëm kundër asaj që të licencohen bazat e betonit dhe bazat e asfaltit, se nuk ekziston kurrfarë arsyeshmërie ekonomike.

Si çështje tjetër unë do ta përmend të drejtën e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për përcaktimin e shkallëve të kamatës, në rastet kur ka të bëjë me ndonjë gjobë apo ndëshkim. Ne nuk besojmë se Komisioni i Pavarur i Konkurrencës e ka ekspertizën e vet që t'i përcaktojë shkallë të kamatave ndëshkuese, është çështje që caktohet me ligje tjera, ndër ato ligje është edhe Ligji mbi procedurat dhe Administratën Tatimore të Kosovës.

Në anën tjetër, kemi një nen që ka të bëjë me klasifikimin si veprë penale nëse ushtrohet një ndikim i posaçëm në anëtarët e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ne besojmë se kjo çështje nuk duhet të jetë në këtë ligj, për shkak se është Kodi Penal që vërteton apo i klasifikon lëndët se a kanë të bëjnë me çështje penale apo klasifikohet në mënyrë tjetër.

Zgjedhja e kryeinspektorit nga ana e Komisionit të Pavarur dhe Miniera, e që ndryshon nga ajo aktuale, që është zgjedhja e kryeinspektorit nga ana e Qeveria, nuk besoj se është zgjidhja më e mirë në këtë rast, përkundër asaj që në këtë aspekt kemi pro dhe kundër, si dhe në çdo rast tjetër, se cila është ana më e mirë. Megjithatë, nuk besojmë se zgjidhja më e mirë është që Komisioni i Pavarur ta emërojë kryeinspektorin dhe të jetë, të mos themi, nën monitorimin e drejtpërdrejtë apo nën tutelën e drejtpërdrejtë të Bordit të Komisionit të Pavarur dhe Minierave.

Në ligj është e përfshirë edhe çështja e mbrojtjes në punë në miniera apo në sektorin minierar, që besojmë se nuk ka nevojë të jetë pjesë e këtij ligji, por që është e rregulluar me Ligjin e punës dhe Ligjin mbi sigurinë dhe shëndetin në punë dhe është pjesë e kompetencave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kjo çështje do të mund të rregullohej shumë mirë me udhëzime administrative nga ana e vetë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe ligji të lirohet, të themi nga këto dispozita të panevojshme për Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Kemi edhe çështjen e kthimit apo futjes së provimit profesional, për ata që duan të merren me çështjet apo me punët në sektorin e minierave dhe mineraleve dhe thjesht, besoj se nuk kemi nevojë të hyjmë në shpikjen e provimeve të ndryshme profesionale, në kategorizimin apo vlerësimin e diplomave që i lëshojnë universitetet tona apo në nivelin intelektual apo shkencor që e kanë ekspertët tanë, me një provim profesional, që thjesht e ka aspektin teknik. Ne e shohim totalisht të panevojshëm, bile edhe të dëmshëm, sa i përket rritjes, zhvillimit të këtij sektori.

Në fund, çështja e themelimit të Muzeut “Trepça”. Ne nuk besojmë se kjo çështje duhet të jetë pjesë e këtij ligji. Pra, duhet të jetë çështje e menaxhmentit apo Bordit të “Trepçës”, ata a donë ta themelojnë muzeun “Trepça” apo jo, por jo çështje e ligjit, që të ngarkohet me ndikime apo të ketë ndikime, ngarkesa financiare Buxheti i Kosovës, por të jetë çështje e vet menaxhmentit apo e tyre se si do të veprojnë në atë aspekt.

Në fund, ajo që e përmendi edhe ministri, unë besoj se nëse ligji kthehet edhe njëherë në ripunim, do të kemi një mundësi shumë më të madhe që të gjitha projektet e Qeverisë t’i marrim parasysh dhe ta punojmë në mënyrë detale. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së është që ky ligj të përpunohet edhe njëherë, t’i kthehet sponsoruesit, eventualisht që ta marrë përsipër Qeveria, që edhe njëherë ta përpunojë këtë ligj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Mirë, zoti Beqaj sqarojeni. Kërkoj falje për prishjen e renditjes, por e shoh të domosdoshme sqarimin.

**MINISTRI BESIM BEQAJ:** Faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm për sqarim. Unë nuk kërkoja kthimin e ligjit. Unë kërkoja që nga momenti kur Komisioni Parlamentar ia ka dërguar Qeverisë për komente, ne i kemi bërë komentet tona, i kemi dërguar me shkrim dhe kërkojmë që në mes të dy leximeve, komentet të inkorporohen, por jo në asnjë rrethanë që ligji të kthehet tek sponsoruesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Më duhet ta them në fillim se unë kam qenë pjesë e këtij grupi punues, që është marrë me Ligjin për miniera dhe minerale dhe me ndryshimet që janë bërë aty.

Një pjesë konsiderueshme e ndryshimeve që i keni përpara, pra janë ndryshime formale dhe teknike të cilat nuk e ndryshojnë ligjin ose ligjin e kaluar në mënyrë substanciale, po janë disa nene e veçanërisht një nen që e ka paraqitur Qeveria, që ka qenë propozim i Qeverisë, i cili pastaj në njëfarë mënyre u bë pjesë e këtij ndryshimi, në ligjin aktual është neni 14, pika 4, që ndryshon nenin 18, paragrafi 7 të ligjit bazik, ose që e riformulon atë dhe në të cilin, siç e përmendi edhe zoti Zharku, pra hiqet procesi tenderues nga vendimi apo vendosja për dhënien në koncesion të një minerali energjetik, që gjendet në Kosovë.

Natyrisht nuk duhet që t’i biem përreth kësaj pune, është fjala për minierat e thëngjillit që i ka Kosova dhe në këtë nen, në njëfarë mënyre i jepet e drejta Qeverisë që të mos shkojë në proces tenderues, por të vendosë edhe me një ofertues të vetëm për ta marrë një vendim të tillë për resurset energjetike të Kosovës, të cilat ne mendojmë, që është shumë e dëmshme që të jepen në këtë mënyrë.

Natyrisht, Lëvizja “Vetëvendosje” qëndron në atë se këto resurse do të duhej të organizoheshin në një korporatë publike, që do t’i menaxhonte këto e që do të ishte Korporata e thëngjillit të Kosovës dhe në këtë mënyrë nuk do të kishim nevojë për kurrfarë procesi tenderues, për sa i përket kësaj.

Mirëpo, mënyra se si tash po dëshiron ta ndryshojë Qeveria këtë nen, është jashtëzakonisht i dëmshëm, për shkak se madje e humb edhe vetë sensin apo logjikën e ekonomisë së tregut, sipas parimeve të së cilës do të duhej të kesh më shumë ofertues, në mënyrë që të paktën Qeveria ta ketë mundësinë që të zgjedhë ofertën më të mirë, për këtë çështje. Ndërkohë, që me këtë ndryshim, me këtë propozim që e ka sjell Qeveria nuk do ta kemi mundësinë, madje as të zgjedhim në mes të ofertuesve, për shkak se do të kemi vetëm një ofertues.

Pra, Lëvizja “Vetëvendosje” në përgjithësi konsideron se ndryshimet që i janë bërë këtij ligji, përveç këtij neni, janë ndryshime formale, jo që e përmirësojnë edhe aq ligjin si tërësi, për shkak se ligji bazik ka pasur shumë probleme, mirëpo në disa aspekte e lehtësojnë menaxhimin e ligjit, menaxhimin e licencave, dhënien e licencave e kështu me radhë. Një ndryshim i mirë që i është bërë ligjit, mendoj unë, është edhe ndryshimi i garancisë që e jep përdoruesi i resurseve minerale, garancisë për mbrojtjen e mjedisit. Pra, në ligjin e kaluar ka qenë që garancia duhet të jetë bankare, ndërkohë këtu është bërë

njëlloj pagese që duhet ta bëjë secili që i përdor pak edhe që i shfrytëzon mineralet e Kosovës, që duhet të bëjë një pagesë periodike në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që pastaj këto në rast të mospërmbushjes së kushteve për sanimin e gjendjes në aspektin e mjedisit, atëherë këto para do të përdoren për një gjë të tillë. Mendoj se ky është një prej ndryshimeve të mira të këtij ligji.

Për ta përfunduar, për shkak se shumë gjëra u përmendën këtu, ne do ta votojmë këtë ligj në parim, mirëpo kushti ynë dhe po e them këtë publikisht, është që ky nen ose këto nene, që i ka sjellë Qeveria të ndryshojnë rrënjësisht. Po që se këto nuk ndryshohen, atëherë në leximin e dytë do të jemi kundër ligjit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së nuk është paraqitur askush. Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e grupit zonja Selmani.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit.

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se ne kemi plotësim ndryshimin e ligjit bazik për mineralet dhe minierat, atëherë mund të themi se Komisioni Parlamentar vetë e ka bërë ndryshimin e këtij projektligji, a më mirë të themi shtojcën e ligjit paraprak, të cilin mendon se do t'i bëhet lehtësira zhvillimit ekonomik të vendit, mirëpo, unë edhe në komision parlamentar edhe këtu do t'i them të njëjtat fjalë.

Ne si komision, ia kemi dhënë miratimin, që këto plotësim- ndryshime të ligjit të shkojnë në Qeveri dhe Komisioni Parlamentar e ka dërguar projektligjin në Qeveri. Qeveria e ka kthyer me amendamentet të cilat mendon që duhet të amendamentohet ligji në lexim të dytë, për arsye se jep lehtësira tjera. Mirëpo, në efekt duhet të dimë se Ligji për miniera dhe minerale duhet të plotësohet dhe të ndryshohet me miratimin edhe të deputetëve të këtij Kuvendi, se ligji ka ardhur në plotësim- ndryshim nga vetë deputetët e Komisionit Parlamentar.

U tha se me plotësim-ndryshimin e projektligjit mund të arrihet një zhvillim më i lehtë ekonomik në sektorin minerar, mirëpo ndoshta jo qëllimisht është lëshuar një gabim aty te çështja e tenderimit, e tha edhe zoti Zharku, se Kosova edhe në bazë të Kushtetutës është vend për ekonomi të lirë të tregut dhe besoj që kjo ka ndodhur jo qëllimisht, po me një lëshim, që nuk e kanë lexuar ndoshta edhe deputetët tjerë brenda komisionit, mirëpo në efekt, kërkojmë nga ministri, që është prezent këtu dhe nga të gjithë deputetët e Komisionit Parlamentar që të nxirret në përfundim të amendamentimit të dytë një ligj shumë i mirë për sektorin minerar dhe të kemi zhvillim në këtë sektor, se kemi ngecje, të bëhemi më transparent, kemi ngecje dhe kjo i duhet Kosovës për momentin.

Koalicioni për Kosovë të Re përkrah projektligjin me plotësim ndryshimet dhe besoj që mbas amendamenteve do të jetë një ligj shumë i mirë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! SLS-ja, zoti Milosavljeviq.

**SAŠA MILOSAVLJEVIĆ:** Hvala, gospodine predsedavajući!

I poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke je razmatrala nacrt zakona o rudnicima i mineralima i mi ćemo ovaj nacrt zakona podržati u načelu.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Është ezauruar fjala e grupeve parlamentare. Tani vazhdojmë me deputetët. Zonja Shala Berisha e ka kërkuar fjalën, tani si deputete.

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, nënkryetar!

Tani po e marr fjalën si deputete edhe si udhëheqëse e Grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e këtij projektligji.

Për hir të informimit të drejtë të opinionit publik që na dëgjon, sepse ne këtu si deputetë e dimë realitetin, se si është, e din edhe zoti Zharku, se pjesë e Grupit punues për plotësim dhe ndryshim të këtij ligji ka qenë edhe LDK-ja me deputetin e vetë Hashim Dëshishku dhe është pajtuar në parim për këto ndryshime dhe plotësime që i kemi bërë. Madje, po dua ta përsëris edhe kolegen time nga AKR-ja, se edhe në Komision Parlamentar, në parim jemi pajtuar për këto ndryshime dhe plotësime, por vërejtjet të cilat i dha zoti Zharku e të cilat i ka paraqitur edhe në Komision Parlamentar për të cilat edhe ka marrë përgjigje pak a shumë, shkurtimisht, unë po e përsëris prapë për hir të opinionit publik, po dua të them se vërejtjen për kryeinspektorin e ka dhënë, kjo ka të bëjë me çështje të koncepteve, po se si zgjidhet kryeinspektori kemi pasur vërejtje në raportin e progresit të vitit 2011 dhe prandaj ne kemi menduar që nuk duhet të vazhdojmë t'i marrim prapë këto vërejtje, po ta përmirësojmë gjatë plotësimit dhe ndryshimit të këtij ligji.

Mandej, licencat për asfalte dhe betone, vetë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e ka dhënë propozimin që të hiqen nga ai institucion dhe të kalojë në ndonjë dikaster tjetër. Në këtë rast, këto licenca unë mendoj që Qeveria me një udhëzim administrativ, veçse ka filluar t'iu ikë në mënyrë që ta përmirësojë klimën e të bërit biznes dhe Departamenti i Ndërtimit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka kaluar në Ministrinë e Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe ka mbetur që kjo çështje të shqyrtohet përbrenda Qeverisë dhe të mos mbetet e rregulluar me ligj, në mënyrë që t'ju ikim licencave të shumta dhe në mënyrë që të mos ju humbim kohë investitorëve, të sorollaten poshtë e lart përmes institucioneve të ndryshme dhe të humbin kohë.

Sa i përket provimeve profesionale, është e vërtetë, dua ta përmend edhe njëherë se duke qenë si sponsorues i projektligjit Komisioni për Zhvillim Ekonomik, ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Shoqërinë civile, siç është INDEP-i, madje kemi pasur edhe ekspertë të jashtëm dhe institucione tjera përgjegjëse kompetente dhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që i kanë dhënë këta faktorë relevantë gjatë plotësim-ndryshimit të këtij ligji, ne i kemi marrë si amendamente dhe jemi pajtuar parimisht, në mënyrë që të mos humbim kohë dhe pastaj pas leximit të parë, të ulemi edhe njëherë dhe t'i analizojmë, t'i shqyrtojmë, t'i harmonizojmë dhe të nxjerrim një ligj sa më të mirë të mundshëm.

Sa i përket, po e përsëris edhe njëherë provimeve profesionale, edhe ne s'jemi pajtuar në përgjithësi si grup punues, mirëpo kjo ka ardhur si propozim i ekspertit dhe duhet t'i



ikim, edhe unë mendoj që duhet t'u ikim këtyre gjerave, se janë pjesë e së kaluarës dhe s'ka nevojë për provime profesionale.

Sa i përket Muzeut "Trepça", unë dua t'ia përkujtoj kolegut Zharku, se Muzeu "Trepça" është veçse pjesë e Ministrisë së Zhvillimit ekonomik me ligjin aktual dhe nuk është prekur asnjë ndryshim në këtë pjesë, me përjashtim, ndryshim i vogël është sepse Muzeu "Trepça" me ligjin bazik aktual ka qenë pjesë, ka qenë i lidhur drejtpërdrejtë me ministrin. Tani, ne kemi menduar gjatë kësaj faze që muzeu të jetë nën Institutin Gjeologjik të Kosovës, në mënyrë që aty ka më tepër profesionalizëm dhe i shërben më tepër atij, asaj pjese të dikasterit brenda Ministrisë.

Sa i përket pjesës së sigurisë në punë edhe kjo nuk është e paraparë me plotësim-ndryshim, sepse siguria në punë është e rregulluar me udhëzime administrative që i kanë nxjerrë Ministria e Zhvillimit Ekonomik. E ndërkohë qëndrimi i Grupit Parlamentar të LDK-së, të mos e mbështet këtë plotësim dhe ndryshim, për mua është shume e pakuptueshme, sepse gjatë tërë kohës kanë qenë pjesë e këtij ligji dhe mua më çon te ajo të mendoj se nuk është interesant kur vijnë direkt prej Qeverisë, në qoftë se nuk i përkrahë LDK-ja, përderisa nuk e përkrah edhe punën në të cilën ka marr pjesë dhe ka qenë edhe vetë pjesë e kësaj pune.

Edhe një herë unë i ftoj kolegë deputetë që ta mbështesin këtë ligj, sepse mendoj se është shumë i rëndësishëm, ka shumë lehtësira tjera, madje po e përsërisë edhe një herë kanë hyrë kapituj tjerë që nuk kanë qenë pjesë e ligjit e të cilët kapituj janë joshës për investitorë serioz për të cilët ka nevojë Kosova në këtë segment të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Deshishku, e ka fjalën!

**HASHIM DESHISHKU:** Faleminderit, nënkryetar, zoti Haliti!

I nderuari Kabianet qeveritar, megjithëse nuk paskan mbetur shumë përveç ministrit, dy-tre ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Sot për shqyrtim kemi një çështje tejet të rëndësishme e cila mund të ketë ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo duket e qartë meqenëse projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minerale dhe minerale sjell aq shumë ndryshime në ligjin bazë sa që më mirë do të kishte qenë të përgatitet një ligj krejtësisht i ri. Por, pa marrë parasysh këtu po paraqes disa vërejtje ndaj propozimeve të cilat në mënyrë të ashpër mund të kenë ndikim në relacionet e ardhshme në ekonominë kosovare.

Problemi më i madh që bartë ky propozim i ligjit, është centralizimi i kompetencave dhe krijimi i mundësisë për ndërhyrje nga Qeveria ose që ajo të marrë vendime pa përfillur rregullat e tregut të konkurrencës. Konkretisht e kam fjalën për riformulimin e paragrafit 7, neni 18 të Ligjit ekzistues. Sipas tij, Qeveria ka të drejtë që ta zgjedhë një investitor për eksplotimin e mineraleve energjetike, të cilin do ta pajisë me licencë pa e futur fare në konkurrencë. Kjo bëhet nën arsyetimin për ruajtjen e sigurisë për furnizim me energji ose për tërheqje të investimeve direkte.

Propozimi për dallim nga ligji bazik parasheh që Komisionit për partneritet publiko-privat, Qeverisë ia ofron propozimin, i cili duhet ta marrë vizën nga Kuvendi i Kosovës. Pas kësaj procedure, Qeveria hyn në negociatat e drejtpërdrejta me investitorin, i cili fare nuk është futur në proces konkurrues dhe është përzgjedhur sipas dëshirës të Komisionit për partneritet privato-publik, apo të Qeverisë. E them se kjo mund të bëhet sipas disponimit të ndonjë anëtari të Komisionit, apo të ndonjë ministri, meqenëse në ligj askund nuk sqarohet se në cilat situata mund të veprohet pa aplikuar procedura pa tender.

Në propozimin për ndryshim dhe plotësim, thuhet se kjo ndodh për ta garantuar sigurinë e furnizimit energjetik, mirëpo çka nënkupton kjo siguri, kush e vlerëson nivelin e rrezikshmërisë, cilat janë kriteret dhe a ka mundësi të tjera për arritjen e këtij synimi?

E dyta, lejohet që Qeveria ta angazhojë njërin vizitor me procedurat e shpejta, ndonëse nuk paraqet kurrfarë situatë emergjente.

E treta, pasi merret pëlqimi nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria fare nuk raporton për vazhdimin e procedurës, përkatësisht për përfundimin e negociatave me investitorin që e ka zgjedhur ajo. Zgjidhjet e ofruara krijojnë hapësirë të madhe, ku mund të vijë në shprehje interesi individual, apo të preferohet një investitor i caktuar. Ky rrezik është real, pa marrë parasysh zhvillimet e deritashme në procesin e privatizimit të aseteve publike për të cilat Kuvendi i Kosovës është i përfunduar. Njëkohësisht këto zgjedhje po ofrohen kur duhet të nisin investimet serioze në energjetikë, përkatësisht ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, për të cilat duhet qymyr. Duke pasur parasysh situatën aktuale energjetike dhe faktin se deri në vitin 2017 duhet të mbyllet termocentrali i “Kosova A”, atëherë siguria e energjetike veç se është e rrezikuar. Sipas kësaj, Qeveria menjëherë mund të kontaktojë me një investitor të preferuar dhe t’i fillojë procedurat për angazhimin e tyre.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me nenin 4 të propozimit, i cili ndërlidhet në nenin 7, paragrafi 3 i ligjit bazik. Aty thuhet, citoj: “Shuma e taksës do të jetë në pajtim me praktikën më të mirë ndërkombëtare”. Sipas këtij formulimi, praktikën e mirë ndërkombëtare mund të jenë të ndryshme, prandaj edhe mundësia e zgjedhjes së nivelit të taksave do të jetë e madhe. Për këtë arsye këtu ofrohet një zgjidhje më precize, përkatësisht që investitorit t’ia bëjnë të qartë shumën e taksave që ai është i detyruar t’i paguajë.

Meqenëse disa vërejtje, i shprehu edhe kolegu nga partia ime, zoti Zharku, unë pajtohem me vërejtjet e tij sa i përket asaj se unë kam marrë pjesë në grupin punues. Është e vërtetë, që e ceku edhe deputetja, zonja Berisha. Kemi pasur vërejtje edhe në grupet punuese, por në komision kemi vërejtjet më të detajuara, të cilat i kemi bërë në mbledhjen e kaluar dhe për këtë ne e kemi marrë atë vendim si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike që mos ta votojmë këtë ligj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Pajaziti, e keni kërkuar prapë fjalën?

**ZENUN PAJAZITI:** Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!  
Po e shfrytëzoj fjalën time si deputet.

Dëshiroj t'i theksoj vetëm dy momente. E para në Komision ju i shini disa amendamente ose shumë amendamente dhe dua ta keni informacionin që jemi pajtuar si brenda komisionit që të gjitha këto amendamente të kalojnë, të shkojnë në Qeveri, në mënyrë që të kenë i gjithë materiali të jetë po ashtu në dorën e Qeverisë. Ka shumë amendamente që ne nuk jemi pajtuar dhe disa prej tyre ju nuk do t'i shihni në fazën vijuese, por kjo ka qenë një marrëveshje, e para.

Dhe, dëshiroj të sqaroj po ashtu, që nëse ky dokument, ky projektligj nuk aprovet nuk domethënë që duhet t'i kthehet Qeverisë, kthehemi në pikën zero. Është projektligj që e kemi nisur ne ta ndryshojmë edhe jemi në një fazë që është goxha finale. Nëse duam ta punojmë, ta trajtojmë këtë material, këto propozime të Qeverisë e tjera, duhet vazhduar të punojmë bashkë në mënyrë që ta kemi një projektligj më të mirë. Qeveria e ka dhënë fjalën e vet që e ka pasur, ne e kemi çuar në këtë fazë në Qeveri, i ka dhënë komentet dhe është në dorën tonë për t'i trajtuar ato komente ato amendamente Pra, kërkoj që të mos kthehemi në fazën zero, por të punojmë në këtë projektligj. Dhe, një çështje tjetër, ta shfrytëzoj praninë e ministrit, meqenëse zoti ministër, Qeveria dhe konkretisht Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik e ka një iniciativë jashtëzakonisht të rëndësishme për heqjen dhe reduktimin e licencave, që është në të mirë të bizneseve dhe meqenëse ne po e trajtojmë këtë projektligj, i cili është ndër projektligjet që më së shumti trajton leje dhe licenca, kishte me qenë mirë që sa më shpejt Qeveria t'i nxjerrë, ta draftojë këtë dokument, në mënyrë që ky projektligj të jetë i adaptuar ose në frymën e këtij procesi që është jashtëzakonisht me rëndësi, e të cilin po e bën Qeveria. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në fund fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Beqaj.

**MINISTRI BESIM BEQAJ:** Faleminderit zoti nënkryetar!

Sigurisht që do të sqarohem edhe një herë që amendamentimi i ligjit është bërë me nismë të Kuvendit të Republikës së Kosovës si rezultat i monitorimit të takimeve që kemi pasur nga viti i kaluar ku janë bërë shumë vërejtje për Qeverinë dhe institucionet tjera për moszbatim dhe është ardhur në konkludim që ligji duhet të amendamentohet. Pra, kjo është nismë e Kuvendit dhe natyrisht ne si Qeveri, si ministri, e cila bëjmë politika në fushën e sektorit minerar dhe energjetik, kemi dhënë sugjerimet dhe vërejtjet tona në amendamentimin, të cilin mendojmë që do ta pasurojë ligjin. Unë nuk e kuptova mirë atë që u tha që Kuvendi pas nismave, të cilat duhet të vijnë, merr vendime politike. Secili ligj i cili rregullon qoftë aspektet ekonomike, juridike, të punës, të mirëqenies kalon në Kuvendin e Kosovës dhe merr votë politik, prandaj edhe ky është një ligj sikurse të gjitha ligjet tjera i cili duhet ta marrë votën e Kuvendit të Kosovës për të qenë i aplikueshëm në Kosovë. Prandaj, nuk do ta kisha lejuar veten ta kategorizoj se është ligj, i cili do të bëjë votim politik, në krahasim me ligjet tjera.

Në Kosovë ligji paraprak ka paraparë edhe atje procedurë jo tenderuese nëse e keni analizuar mirë edhe atje ka qenë për nevojën të interesit shtetëror, të cilat janë format e definimit të qartë të interesit shtetëror. Ajo çka ju ka shtuar atij ligji është se, thotë: “edhe në rast se Qeveria vendos për atë, duhet të merr aprovimin nga Kuvendi”. Pra, në ligjin paraprak e papasur të drejtën me e bë edhe pa aprovim të Kuvendit, tash kërkohet do të thotë që të merret aprovimi edhe nga ana e Kuvendit. Nuk ka as ndryshim drastik i cili po

konsiderohet që tash Qeveria po do ta bëjë njëfarë lloj centralizimi, përkundrazi Qeveria do të thotë po do të verifikohet dhe të kalojnë këta përmes partneritetit publiko-privat, sepse ka qenë e vetmja natyrë dhe e vetmja formë për të shkuar në këtë formë, ka qenë që KPMM-ja në bazë të kërkesës nga Qeveria, mund të japë një licencë të tillë. Domethënë ne nuk kemi dashur që ta lëmë vetëm në kompetencë të KPMM-së, por kemi dashur që kjo të verifikohet dhe riverifikohet edhe një herë nga Kuvendi.

Prandaj, në këtë kontest kisha dashur ta trajtojmë ligjin, trajton çështje jashtëzakonisht të rëndësishme. Shumë shpesh janë diskutuar në këtë parlament pse nuk ka veprime në sektorin minerar dhe energjetik. Ne kemi sjellë këtu strategjinë, e dini që është kthyer, rikthyer strategjia, e cila ka pasur një synim afatgjatë dhe të rregullimit të hapave në faza të gjata vjetore, afatgjata do të thotë në mënyrë që të rregullohen pastaj edhe mundësitë për ligj. Ajo është aprovuar nga Kuvendi, kemi një ligj i cili duhet të aprovohet nga Kuvendi, nëse dëshirojmë me e zhvilluar aktivitetet minerar të mirëfilltë duke iu përshtatur kushteve të ekonomisë të tregut dhe ligjeve tjera të cilat rregullojnë fusha të tilla në nivel botëror. Prandaj, nuk flitet për centralizim, nuk flitet vetëm për përdorimin e thjeshtë të thëngjillit. U tha nga deputetja që trajton edhe gazin dhe burime tjera, trajton industrinë kimike e cila nuk është trajtuar aspak në asnjë rrethanë nga ligji paraprak. Pra, Ligji paraprak ka dhënë të drejtën vetëm ta shfrytëzojë linjiten për ta djegë dhe shndërruar në energji elektrike, ndërsa nuk ka dhënë asnjë mundësi tjetër. Këto janë ato ndryshimet esenciale të cilat neve po kërkojmë, ndërsa për muzeun e “Trepçës” e tha edhe deputetja, muzeu ka qenë pjesë e ligjit, ka qenë edhe Instituti Gjeologjik që ka qenë pjesë e ligjit. Ne kemi dashur që ta përmirësojmë për shkak se në ligjin paraprak ka qenë gabim e trajtuar edhe si agjenci edhe si institut dhe ne kemi dashur ta precizojmë që nuk flasim për agjenci, po flasim për institut shkencor i cili duhet ta merr edhe muzeun dhe muzeu është muze shtetëror, nuk është muze i “Trepçës”, por është muze i cili është bërë me investime të Qeverisë dhe realisht si të tillë neve edhe e kemi filluar implementimin e tij.

Prandaj, është një natyrë, është një materie, e cila trajton çështje jashtëzakonisht të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe unë ju bëj ftesë të mos e zvarrisim. Nëse vendoset të kthehet, duhet të kthehet prapë, kështu që tha edhe kryetari i Komisionit që duhet të kthehet në pikën zero në parlament prapë, por besoj që do ta zvarrisim pa ndonjë arsye. Ligji mund të përmirësohet në mes të dy leximeve në mënyrë substanciale, prandaj unë ju ftoj të gjithëve që ta votoni në parim dhe në ndërkohë të gjithë të japim kontributin tonë për ta përmirësuar ligjin dhe për ta bërë një ligj sa më të mirë nga prizma e secilit prej deputetëve dhe nga të gjitha institucionet të cilat janë të involvuar në këtë proces. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në mbledhje janë 64 deputetë. Po futemi në procesin e votimit të Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!  
Faleminderit!

Me 39 vota për, 17 kundër, 4 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

A po shkojmë në pauzë a po vazhdojmë? Atëherë po e kryejmë edhe një ligj që është edhe shkojmë.

Pika e tetë e rendit të ditës është:

## **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pyjet**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky projektligj të mos miratohet në parim.

Ftoj ministrin e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, zotin Blerand Stavileci që ta arsyetojë projektligjin.

**BLERAND STAVILEVCI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pasi kjo pikë, pra shqyrtimi i parë i Projektligjit për pyjet ndërlidhet ngushtë edhe me e dy pikat e tjera që janë dy projektligje për shpalljen e parqeve nacionale, ne kemi pasur diskutime brenda Komisionit për Pylltari, Bujqësi, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe shoh se është krijuar një situatë pak sa konfuze. Ne e kemi edhe një rekomandim të Komisionit Parlamentar për ta tërhequr, mirëpo unë mendoj që problematika e sotme kjo që lidhet pra me pylltarinë, por edhe me shpalljen e këtyre dy ligjeve, do të duhej të shikohej më mirë dhe që të tria ose të shkojnë, po mendoj si një pako të avancohet, ose që të tria të tërhiqen jo diçka të shkojë e diçka të tërhiqet për arsye se nuk e zgjidhim problemin që ekziston sot në pylltari, problemi është sistematik edhe problemi është strukturor. Nëse miratohet diçka e diçka tjetër jo, bëjmë improvizime dhe do ta shihni menjëherë që, nëse kalojnë këto dy ligjet për parqet nacionale, do ta keni në kundërshtim menjëherë me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, neni 18, pika 7, do ta keni në kundërshtim me ligjin aktual të pyjeve. Ashtu- kështu sot ka shumë struktura që menaxhojnë me pyjet. Nga Departamenti i Pylltarisë brenda Ministrisë, Agjencia Pyjore, drejtoritë komunale të bujqësisë, Bordi këshillëdhënës. Nëse kësaj i shtohet edhe një strukturë, nuk zgjidhet problemi, mirëpo shtohen njerëzit dhe strukturat të cilat edhe më shumë mund ta rëndojnë problemin. Prandaj, unë mendoj që kjo çështje, duhet t'i bëhet kësaj çështje një analizë më e mirë, një studim më i mirë në mënyrë që problemin ta zgjidhim nga koka dhe jo me improvizime.

Po ashtu në vitin e kaluar kemi miratuar strategjinë për pylltarinë e cila mbështetet nga donatorët 2010-2020 dhe përsëri këto të dyja do të jenë në kundërshtim me atë strategji. Pastaj, edhe donatorët nuk e kanë dhënë aprovimin e tyre për to, për arsye se është krejt normale që të shihen këto si një pako dhe jo të ketë përzierje të përgjegjësive siç ka ndodhur deri me tash. Prandaj, unë mendoj që do të duhej bërë ndryshe dhe jo kështu si po mendojmë, sepse mund të kalohet diçka në parim, mund të tërhiqet mirëpo problemin në terren do ta kemi akoma. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e ka, në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zoti Nait Hasani, por paraprkisht dua t'ju lus për vëmendje, sepse zoti Hasani na ka lutur që t'i japim mundësinë që t'i shfaqë disa sekuenca nga

NAHIT HASANI: Ato i kemi për Ligjin për parqet.

KRYESUESI: A për parqet nacionale? Atëherë vazhdo pra.

NAHIT HASANI: Faleminderit!

Faleminderit ministër për prezantim! Ne si Komision e kemi shqyrtuar Projektligjin. Projektligji nuk ka ndryshuar nga projektligji i vjetër dhe, nëse keni ligj të vjetër cila është arsyeja të kemi ligj të ri nëse nuk e bënë ndryshimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Ndarja e niveleve është po ajo ndarje që na tregon gjendjen e pyjeve dhe kështu që ne mund të miratojmë strategji e strategji, po mos ta zgjidhim këtë çështje. Prandaj, në takimet që kemi pasur me dy ministritë, kemi kërkuar ta bëjmë ristrukturimin e pylltarisë dhe kjo do të ishte një nga elementet për mundësinë e mbrojtjes më të mirë po ne si komision kemi marr vendim që Kuvendit t'i kërkojmë ta kthej prapë që Ministria apo Qeveria ta shqyrtojë këtë mundësi e ristrukturimit dhe do të jetë më e mirë për të gjithë dhe mbrojtjen e pyjeve.

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e grupeve parlamentare, respektivisht përfaqësuesve. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Idrizi e ka fjalën!

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe unë mendoj sikur edhe ministri që këto tri projektligje duhet të trajtohen bashkërisht për shkak se kanë të bëjnë me një lëndë. Këto tri projektligje janë në kundërshtim me njërin- tjetrin. Ta marrim projektligjin për pyjet thotë që me parqet nacionale që menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, në ndërkohë që kjo nuk mund të jetë edhe kompetencë e Agjencisë Pyjore të Kosovës, por ka edhe shumë dilema që a duhet t'i nxjerrë ky projektligj.

Ne kemi hasur gjatë debatit publik edhe me qytetarët e ndryshëm të Kosovës, ku kemi shkuar nëpër zonat ku mendojë se do të shtrihen këto dy projektligjet për zonat e mbrojtura për parqet nacionale, kemi hasur në kundërshtim dhe ky kundërshtim ka hasur si pasojë e mos vullnetit të tyre që ta trajtojnë këtë problem. Problemi tjetër është se ne e kemi një sipërfaqe të madhe të pyjeve të cilat ne po i marrim realisht në mbrojtje e që duhet ta kenë, të marrin dorë te Projektligji për pyjet. Mendoj se këto të tri projektligje duhet të trajtohen bashkërisht si një lëndë ose duhet të tërhiqen nga ministri ose duhet t'i lihet Komisionit që ti trajtoj bashkë, ndryshe ky projektligj të tërhiqet dhe ato të shkojnë prapë. Ne nuk zgjidhim problem, por problemin e lëmë në pikën fillestare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Morina,

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Njëkohësisht sikurse edhe kryetari i Komisionit i cili i paraqiti vërejtjet lidhur me këtë projektligj, po ashtu edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar projektligjin dhe njëkohësisht projektligj është po ashtu, po ai ligj i cili ka qenë deri me tani dhe nuk është e definuar edhe nuk është e qartë bartja e kompetencave kur janë në pyetje Departamenti pyjor, Agjencia Pyjore dhe po ashtu komunat. Dhe, po ashtu një vërejtje në të cilën është dhënë nga deklarata financiare, nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, në analizë të buxhetit paraqitet që ky projektligj nuk është i paraparë në kornizën afatmesme 2013-2015. Dhe një çështje që e ngriti ministri në këtë rast që e përmendi se, ose duhet të tërhiqen të tri projektligjet, unë mendoj se ne e kemi pasur një konfuzion ndërmjet dy ministrive, në këtë rast e kemi ftuar si Komision të dy ministrat dhe kjo mosmarrëveshje do të thotë duhet të zgjidhet mes atyre se çka duhet të bëhet edhe me dy ligjet tjera edhe me dy ligjet që kanë të bëjnë me Parkun e Bjeshkëve të Nemuna dhe me Parkun e Sharit. Prandaj kjo i mbetet edhe ministrit të planifikimit në këtë rast që ta jap mendimin e vet dhe ndoshta si paket do të ishte mirë që këto të tri projektligje të tërhiqen dhe të vazhdohet më tutje do të thotë në vitin tjetër, nëse është, nëse vendos vet ministri përndryshe Grupi Parlamentar do të jap mendimin edhe për dy ligje tjera, do të thotë kur të vijë pika e renditjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë projektligj edhe po ashtu në Komision kemi pasur diskutime të shumta dhe kemi pasur edhe takime me dy ministrat dhe për një kohë të gjatë, pra qe dy vjet, një ndër temat më të shpeshta në diskutim, në Komision ka qenë çështja e pyjeve. Në lidhje me këtë çështje kemi pasur edhe dëgjim publik edhe në vitin a kaluar. Po ashtu kemi pasur takime të shumta me organizatat e ndryshme të pronarëve të pyjeve, kemi shkuar shpeshherë në vizita në terren dhe jemi si komision mjaft të njoftuar lidhur me çështjen e pyjeve.

Në të gjitha debatet dhe diskutimet që i kemi pasur deri tani në lidhje me pyjet, një çështje ka qenë kryesorja ajo është që sistemi aktual, pra me ligjin aktual të pyjeve nuk është funksional dhe ndryshimet janë të domosdoshme dhe kanë qenë të pritshme. Pra çështja ka qenë vetëm se kur do të vjen ky ligj i pyjeve i cili do t'i sjellë këto ndryshime të cilat ndryshime do të jenë ndryshime sistemime, meqenëse aktualisht kemi një nivele jashtëzakonisht të ngarkuara në funksionimin e sistemit në lidhje me pyjet dhe çka është më e keqja, kemi një agjenci e pyjeve i cili ka nivel rajonal, pra e ndërton sistemin e pyjeve në nivel, me tri nivele gjë që është në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila i njeh vetëm dy nivele, pra nivelin komunal dhe atë qendror, ndërsa ne këtu kemi edhe nivelet rajonale të cilat nivele bashkëpunojnë në njëfarë mënyre drejtpërdrejt edhe me komunën dhe janë të kontrolluara edhe nga niveli qendror. E krejt kjo ndaras nga Ministria dhe në të gjitha vizitat dhe inspektimet që i kemi bërë në terren, ne kemi hasur një problem tejet serioz, pra marrëdhënien, Agjenci e Pyjeve, komunë. Në këtë marrëdhënie ku kompetencat janë të paqartësuar ndodhin

defekte dhe pasojat e mëdha në çështjen e prerjes së pyjeve, lidhen pikërisht me nivelin Komunë - Agjenci, gjegjësisht Departament i Bujqësisë dhe Pylltarisë, në nivel komunal që lidhet me nivelin rajonal të Agjencisë.

Kjo marrëdhënie ka shkaktuar edhe problemet dhe në të dyja nivelet, kur ti shkon ato fajësojnë njëra-tjetrën. Mendoj që problemi është pikërisht në këtë çështje, pra duhet të definohen qartë kompetencat e komunave dhe duhet të definohet qartë Inspektorati pra edhe autoriteti qendror.

Ministria me inspektoratin duhet të ketë autoritet të fuqishëm mbi komunat në mënyrë që t'i inspektoj ato, por njëkohësisht edhe komuna duhet t'i kenë kompetencat e definuara pra në nivelin e parë. Për sa i përket ndërlidhjes, zgjidhjes nga koka që e përmendi ministri edhe unë jam shumë dakord që zgjidhjet duhet të vijnë nga lart, pra duhet të ndryshojë komplet sistemi, mirëpo ne kemi pritur që projektligj tani që na ka ardhur, do t'i sjellë këto ndryshime, po ky projektligj te të njëjtat probleme vazhdon t'i bartë edhe tani. Pra, mund të ketë ndryshime kozmetike që janë të një natyre krejtësisht tjetër, mirëpo kur bëhet fjalë për kompetencat, kur bëhet fjalë për nivelet, ato mbeten po t njëjtat. Kemi prapë nivelin rajonal, kemi prapë Agjencinë, kemi prapë Inspektoratin në Agjenci, prapë nuk definohen qartë kompetencat ndërmjet komunës dhe ato janë të përziera ndërmjet komunës dhe Agjencionit, prandaj ky ligj do të duhej që t'i sillte këto ndryshime dhe kjo nuk lidhet me parqet. Nëse e shohim ndërlidhjen me parqet, tash po flasim për parqe që shumë shpejt do ta kemi në pikat e ardhshme, bëhet fjalë vetëm për Agjencinë. Nëse parqet do të duhej ne t'i ruanim në njëfarë mënyre nga Agjencia, sepse nën kontrollin e Agjencisë, ato janë shkatërruar jashtëzakonisht shumë dhe ne duhet t'i heqim kompetencat drejtpërdrejt menaxhuese të Agjencisë mbi parkun, pra Agjencia natyrisht që duhet të ekzistojë dhe të bëjë politika në nivel qendror, por jo të përzihet drejtpërdrejt në çështjet se, pikërisht nën nivelin rajonal dhe komunal që ndërlidhem mbi territorin e Agjencisë, kur të shkëputej kjo mundësi që Agjencia të mos ketë kompetencë drejtpërdrejt mbi parkun, atëherë në njëfarë mënyre në territorin e parqeve do të kemi një lloj të themi shpëtim të pyjeve atje.

Prandaj, ka ligj aktualisht nuk mund të thuhet që ose duhet të tërhiqen të tri ligjet, ose të kalojnë të tria ligjet, sepse ne kemi kundërshti në mes të këtij Projektligji dhe Ligjit për parqet sepse te Ligji për parqet thuhet që Agjencioni nuk do të ketë kompetenca në parqe, ndërsa te ky Projektligj i jepet kompetenca Agjencisë edhe mbi parqe, pra këto dy ligje kanë kundërshti njëra me tjetrën. Po të ishin këto dy ligje, këto tri ligje të themi komplementare me njëra tjetrën, ne do të mund të themi që ose duhet të kalojnë të tria ose duhet të tërhiqen të tria sepse nuk mund njëra pa tjetrën po këtu pikërisht këtu kanë njëra me tjetrën kanë kundërshtim, njëra i jap kompetencë Agjencisë mbi parqet e tjetra ia heq atë kompetencë. Pra këtu nuk mund të jenë këto të ndërlidhura, njëra duhet të ecë, tjetra nuk mund sepse, po qe se i miratojmë të dyja, ne në fakt që në ditën e sotme do të miratojmë diçka që do të jetë në kundërshtim me njëra tjetrën. Pra unë jam, ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" jemi që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë, të bëhen ndryshimet siç janë diskutuar vazhdimisht, jo vetëm kemi qenë mjaft të hapur nëpër të gjitha, çdo mundësi, çdo forum e kemi shfrytëzuar që të shkojmë, të diskutojmë dhe debatojmë, pra të rregullohet çështja e sistemit të pyjeve dhe shumë në rregull do



duhej pastaj ta votonim, ta kalojmë dhe ta ndryshonim. Mirëpo, kështu kjo nuk sjell ndonjë ndryshim. Pra, tërë kohën flitej për një reformë dhe në fund na erdhi një projektligj që asgjë tjetër përpos që e vazhdon gjendjen, avazin e vjetër siç ka qenë deri me tani.

Pra ne jemi kundër këtij projektligji, jemi që t'i kthehet Qeverisë dhe të vijë një projektligj tjetër i ndryshuar, siç kemi diskutuar edhe më herët.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Haradinaj.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, kryesues!

Unë fillimisht e mbështes kryetarin e Komisionit që tha se duhet të kthehet ligji dhe unë mendoj se ky mund të hidhet në votim si propozim i kryetarit të Komisionit për shkak se sot do t'i kemi tri ligje të cilat parimisht bien ndesh njëra me tjetrën, e kemi Ligjin e Bjeshtëve të Nemuna dhe e kemi Ligjin e Maleve të Sharit.

Kur flasim për Ligjin e pyjeve, nuk mundem t' i anashkaloj shturjen e kompetencave sidomos në mes të Ministrisë, drejtorive rajonale dhe nivelit lokal, po në të njëjtën kohë edhe inspektorëve, domethënë është kah ndodh një shkatërrim i pyjeve e ky ligj nuk do ta zgjidhë problemin e pyjeve, ky ligj veç sa do ta komplikon edhe më shumë. Tha edhe Liburni, i ceku ato dukuri, kemi qenë edhe nëpër shtetet tjera të cilat janë shumë të avancuara në mbrojtjen e pyjeve dhe kemi parë një gjendje se si funksionon. T' ju them sinqerisht që nuk është e shpjeguar saktësisht çfarë kompetencash do të kenë njësitë rajonale në rast se do të kenë kompetenca, në rast të kundërtën për shembull, Ligji i Bjeshtëve të Nemuna thotë që 6 muaj pas implementimit ose pas hyrjes në fuqi, do të krijohet një drejtori regjionale, e cila do ta mbikëqyrë dhe do ta mirëmbajnë, do ta implementojë, ndërsa në anën tjetër e kemi Ligjin e pyjeve i cili jep përgjegjësi një nivel krejt tjetër do me thënë është një shturje . Edhe unë mendoj se ky ligj duhet të kthehet mbrapa. Nuk jemi kundër ligjit që është di domosdoshëm, por është një vazhdim i praktikës së vjetër thjesht vetëm që i ndërrohen datat. Kështu mendoj që ta hedhim në propozimin e kryetarit të Komisionit në votim dhe të votojmë se çka do të mendojnë deputetët. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Lama.

**SEVDIE LAMA:** Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah propozimin e ministrit që këto tri ligje të trajtohen të tria bashkë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupeve nuk ka tjerë të paraqitur. Deputeti Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuari nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti, Besoj se do të jem shumë i shkurtër, mirëpo dua vetëm të rikujtoj që ne kohë më parë kemi aprovuar këtu në Parlament Ligjin e sponsorizuar nga Ministria e Ambientit , Ligjin për ujëra dhe mendoj se tani kemi ardhur në një situatë të aprovuara edhe Ligjin për pyjet dhe duke pasur parasysh prerjet dhe dëmtimin e vazhdueshëm i cili është duke

ndodhur në pyjet e Kosovës, në veçanti pas luftës, konsideroj se çështja e pyjeve është çështja ambientale dhe do të duhej të trajtohej nga Ministria e Ambientit dhe definitivisht ne të vendosim në këtë çështje në menaxhim të mirëfilltë.

Ne kemi një Ligj për ujërat dhe Ligjin tani i cili është Ligji për pyjet, duke pasur parasysh organizimin deri tani në kuadër të Agjencisë të Pyjeve të Kosovës dhe Ministria e Ambientit nuk e ka një departament apo drejtori e ujërave, ndërsa ministria tjetër apo agjencia tjetër për ... është një përzjerje e kompetencave. Mendoj se me anë të këtij ligji ne do të duhej të rregullojmë çështjen e menaxhimit dhe mendoj se do të ishte shumë e udhës dhe korrekte që të krijohet një drejtori e cila do të ishte drejtori e përbashkët apo Agjenci e përbashkët i ujërave dhe i pyjeve, duke konsideruar se këto janë çështje ambientale dhe më pak çështje bujqësore.

Mendoj se në të ardhmen gjatë hartimit të këtij ligji, të bëhet një rregullim dhe një bashkëdyzim, një harmonizim mes këtyre dy ligjeve dhe çështjes së menaxhimit edhe të ujërave edhe të pyjeve. Do të ishte shumë më korrekte që Ligji i ujërave duhet ishte në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë ndërsa Ligji për pyjet do të ishte në kuadër të Ministrisë së Ambientit. Ndoshta ne e kemi një ndryshim në këtë rast, ujërat trajtohen, janë trajtua me Ligjin në kuadër të Ministrisë së Ambientit, ndërsa pyjet me këtë ligjin tjetër. Mendoj se do të ishte mirë që gjatë shqyrtimit të këtij ligji, t'i ketë në konsideratë këto çështje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Fjalën e ka kërkuar ministri

**MINISTRI DARDAN GASHI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Vetëm një sqarim të shkurtër se kompetencat kanë qenë gjithmonë të ndara në mes menaxhimit të parkut nacional, do të thotë parku nacional ekzistues i Sharit, menaxhohet nga Drejtoria e parkut nacional jo nga Agjencia e Pyjeve. Pra ligji i pyjeve nuk ka relacion drejtpërdrejt me dy ligjet që do t'i diskutojmë sot. Parku nacional Shari ekziston, është pyetje e zgjerimit territorit të këtij parku dhe vendosja e një parku të ri, pra menaxhimi i pyjeve në aspekt ekonomik bëhet nga Agjencioni i pyjeve, mbrojtja si park nacional bëhet nga drejtoritë përkatëse dhe këto të dyja nuk kanë relacion me njëra tjetrën. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Zoti ministër, a dëshironi fjalën? Ministri Stavilevci e ka fjalën.

**MINISTRI BLERAND STAVILEVCI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Për hir të disa sqarimeve, prapë mbetem te ai mendimi që e thashë në fillim që kjo donë një zgjidhje apo më mirë të themi një rizgjidhje strukturore, jo duke e bërë me improvizime, por edhe nëse ndalemi te Ligji për pyjet, megjithatë besoj që për shkak të informimit të drejtë nuk është e drejtë të thuhet që nuk ka ndryshime. Mund ta shihni kreun e 6-të, strukturën organizative e cila i ka përfshirë në vete ndryshimet. Cilat janë këto ndryshime? Ato që kanë derivuar prej ligjeve, prej cilave ligje apo plotësim

ndryshim të ligjeve,ato që i kanë miratuar deputetët e këtij Kuvendi dhe këtu janë të përfshira edhe drejtoritë komunale?

Nuk mund të thuhet dhe nuk besoj që është e drejtë që një deputet thotë që Agjencia bën politika. Dhe këtu e shohim pra që ka një mjegull edhe në kuptimin e asaj se si i trajtojmë gjërat. Sot për sot Departamenti i Pylltarisë bënë politika, Agjencia e pyjeve menaxhon ekonomikisht, Inspektorati e kryen punët e inspektimit, ndërsa drejtoritë komunale i kanë dy kompetenca, të cilat ne ua kemi deleguar si rezultat asaj që është dashur në bazë të Ligjit ajo që lidhet me mbrojtjen dhe sot mbrojtja është te komunat, është prej vitit 2010, prej qershorit të vitit 2010 dhe çka do që sot flasim për degjenerimin e gjendjes, ka 30 e më shumë adresa ku mund t'ju drejtohem dhe tjetra që lidhet me leje për prerjet drunore. Prandaj po e them nëse diçka miratohet sikurse ato dy projektligjet e tjera, po ju them që problemi përsëri mbetet, nuk do të ketë ndryshim të gjendjes në terren.

Besoj që edhe ju i dini rekomandimet e Komisionit Evropian, USAID-it, nuk jam pajtuar, keni qenë pjesë e delegacionit në Austri, një pjesë tjetër ka qenë edhe në Finlandë. Kur jeni kthyer në fillim, keni pasur tjera mendime, pastaj keni ndryshuar, nuk e di pse. Unë mendoj problemi zgjidhet siç e thashë edhe herën e parë nëse e nisim nga koka dhe fillojmë ta ristrukturojmë ashtu si duhet. Edhe unë jam për ta ndryshuar dhe për ta ristrukturuar dhe për ta reformuar, mirëpo jo në këtë mënyrën si sot se ju vet po thoni që këto bien ndeshë njëra me tjetrën, atëherë pse duhet të ketë përparësi diçka ndaj diçkahit tjetër nëse ato bien ndeshë, nëse bien ndesh pra të tria duhet të kthehen mbrapa ose të aprovohen e pastaj të bëhen ndryshimet finale po e them përsëri duke e pasur gjithmonë në mendje atë që duhet ndryshuar nga koka dhe jo improvizime.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Për çka e ki fjalën Liburn? Replikë apo çka? Replikë zoti Aliu.

**LIBURN ALIU:** Edhe një herë dua ta qartësoj çështjen e Agjencisë dhe komunave. Politikat i bën Ministria, Agjencia menaxhon. Njëkohësisht Agjencia edhe inspekton. Këtu kemi në start në start e ka inspektorati në kuadër të agjencia dhe e ke njëkohësisht e bënë edhe menaxhimin. Në anën tjetër, në shumë çështje niveli rajonal i agjenci është ai i cili bashkë me komunën e bëjnë së pari edhe planet menaxhuese, i propozojmë pra planet menaxhuese, ato plane menaxhuese i miraton komuna në të gjitha tenderët janë te të dyja palët të përfshira në të gjitha edhe planet menaxhuese edhe planet e prerjeve bëhen ndaras, mirëpo në bashkëpunim të njëra- tjetrës dhe në fakt kemi asgjë tjetër përpos bashkëpunim dhe lidhje të nivelit rajonal të Agjencisë dhe përgjegjësinë po e merr agjencisë, pra niveli regjional i Agjencisë me departamentin e komunës të ndërlidhen bashkë dhe pyetjet t'i prejnë atje dhe detyrohet në fund niveli qendror i Agjencisë t'i prej, t'i ndërprejë për shembull në nivelin e Deçanit atje t'i ndalë të gjitha të gjitha prerjet sepse nuk mund t'i kontrollojë vet ato çka ndodhin dhe pa u eliminuar niveli rajonal që në fund të fundit është edhe antikushtetues, nuk mund të ketë përparim në nivel dhe ky është ndryshimi sistemik.

Ju thatë që duhet të kemi ndryshim sistemik, nuk keni prua ndryshim sistemik në këtë projektligj edhe unë jam për ndryshim sistemik. Gjithmonë kemi fol që duhet të ndryshoj

sistemi dhe në këtë projektligj që keni sjell nuk ka ndryshime, pra të njëjtat nivele mbesin po edhe sot, duhet të hiqen këto, të ndryshohen dhe atëherë ne do të mund të flasim. Po ju keni prua të njëjtën gjendje doni ta vazhdoni të njëjtën gjendje si përpara dhe përpiqeni të thoni që duhet të ketë ndryshim sistemik. Po ky projektligj që e keni sjell nuk e bënë këtë.

Dhe dakord jam që duhet ta bëjmë atë. Prandaj...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë nuk kisha preferua, janë paraqitur tash për të fol prapë edhe disa deputetë dhe debati është krye e vendosim me vota, po dihet që janë dy mendime. Unë ja kisha dhënë fjalën vetëm e kryetarit të Komisionit që ta thotë fjalën e tij dhe të futemi në votim. Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

**NAIT HASANI:** Përshëndetje edhe një herë kryesues, Falënderoj ministrin për këto. Ne si Komision e kemi shqyrtuar projektligjin dhe i kemi parë që nuk ka ndryshime nga ligji i kaluar, na vjen me të gjitha ato nivele dhe nuk është në lidhje drejtpërdrejt me ligjin e parqeve dhe kështu që ne duhet të shkojmë veç e veç me ligje dhe kërkoj që deputetët ta miratojnë vendimin e Komisionit që t'i kthehet ministrit për ripunim dhe të na vijë dhe ne do ta miratojmë përsëri.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë keni dëgjuar debatin, konsideroj që s'ka tjerë të paraqitur. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim. Në sall janë 72 deputet.

Kemi rekomandimin e Komisionit për pyjet lidhur me projektligjin. Debati thash u dëgjua. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Çka?

*(Ndërhyrje: Rekomandimin e Komisionit)*

A rekomandimin e Komisionit? Atëherë e nxjerrim rekomandimin e Komisionit në votim pra.

Besoj se e keni lexuar, apo të jua lexoj. Në rregull. E hedh në votim propozimin e Komisionit, i cili në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional para shqyrtimit të parë projektligjin në mbledhjen plenare shqyrtoi Projektligjin në parim dhe Kuvendit ia paraqet raportet me rekomandime.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për pyjet vlerëson se projektligji nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për mosmiratimin në parim.

E nxjerrim në votim rekomandimin e Komisionit një herë. Votojmë tash!

Konstatohet miratohet rekomandimi i Komisionit me 46 vota për, 17 kundër dhe 5 abstenime. Kuvendi nuk e miratoi në parim Projektligjin për pyjet.

Ngarkohet Komisioni Funkcional që t'i kryejë veprimet e mëtutjeshme. Faleminderit! Atëherë bëjmë pauzë deri në orën 14:30. Faleminderit!

*(Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës)*

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

## **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputet, e ke fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Para se të filloj me diskutimin, kisha kërkuar nga ju dhe regjia që të na paraqesë një pamje vizuale për pyjet dhe parqet që i kemi.

KRYETARI: Në rregull, edhe unë kërkoj këtë.

NAIT HASANI: I ka regjia.

Komisioni për Bujqësi i ka shqyrtuar dy projektligjet, nga të cilat mund t’i shihni malet, pyjet edhe parqet tona që i kemi në Kosovë.

Në Komision është shqyrtuar edhe kjo çështje dhe është zhvilluar një debat mjaft i gjerë për këto dy projektligje. Debate kemi zhvilluar në Junik, në Gjakovë, në Pejë, në Deçan, në Rugovë, në Istog, në Dragash, në Prizren, në Reçan. Në të gjitha debatet e bëra kemi pasur kemi pasur mbështetjen e kryetarëve të komunave, kemi pasur mbështetje e njerëzve, të cilët i kanë dashur dhe donë t’i mbrojnë pyjet dhe t’i krijojnë parqet, kemi pasur kundërshtimin e vazhdueshëm të Agjencisë së Pyjeve, për shkak të çështjeve të cilat ata i dinë.

Ne si Komision i kemi pranuar vërejtjet e gjithë qytetarëve që kanë adresuar kërkesa dhe ankesa te ne. Ne e kemi marrë një kërkesë nga banorët e Rugovës, të cilët kanë kërkuar dhe e kanë pasur një shqetësim shumë të madh për çështjen e demarkacionit, për çështjen e zonës së parë, të zonës së dytë dhe zonës së tretë, që do t’i prekë parku. Po, me anë të këtij ligji, me anë të amendamentimit që ne si Komision e kemi bërë, kemi shqyrtuar dhe kemi mundësuar të zgjidhen këto çështje, për të cilat Komisioni i ka pasur parasysh vërejtjet e banorëve.

Banorët kanë kërkuar që në Pejë ose në parkun “Bjeshkët e Nemuna” të mos ketë një zyre nga Prizreni, për të cilën Ministria edhe Komisioni e kanë zgjidhur këtë çështje dhe ajo do të jetë pjesë e Pejës.

Ata kanë kërkuar që të rregullohet kufiri me Malin e Zi. Ky ligj nuk është pjesë që do ta zgjidhë këtë çështje, prandaj edhe nuk kemi mundësi ta zgjidhim me këtë.

Ata kanë kërkuar ta sqarojnë çështjen e pronave dhe Komisioni e ka pasur parasysh këtë çështje dhe ka sqaruar me një amendament të veçantë për çështjen e pronës, sepse ky ligj nuk është objekt i çështjes së pronave.

Kanë kërkuar që të identifikohet zona e parë, zona e dytë dhe zona e tretë, ku në bazë të Ligjit të natyrës për parqet, parku kombëtar dhe zona e parë janë zona të mbrojtur strikte, të cilët janë pjesë e disa peizazheve, ose pjesë e lartësive ku nuk jeton njeriu, por janë pjesë e bukurisë natyrore, siç për shembull e kemi Gjeravicën, e kemi Liqenatin, e kemi Grykën e Rugovës, e kërkohet të jenë pjesë e zonës së parë dhe pjesë e mbrojtur, e cila na duhet si pasqyrë.

Rëndësia e këtij ligji është po ashtu se ne me këtë ligj bëhemi pjesë e zhvillimit ekonomik, e zhvillimit të turizmit, e zhvillimit dhe mbrojtjes së natyrës. Në këto vende që neve na përfaqësojnë është Shqipëria, që është e ka shpallur pjesë parku, e ka shpallur pjesë parku Mali i Zi, vetëm ne kemi mbetur prapa dhe është një mungesë e zhvillimit të turizmit në ato pjesë, por është edhe një pjesë e shkatërrimit, siç duket edhe nga këto pamje që ju po i shihni drejtpërdrejt.

Prandaj, amendamentet që janë bërë, nga amendamenti i parë deri te amendamenti i gjashtë, tregojnë që Komisioni ka punuar në këtë drejtim, e ka ndryshuar dhe e ka përmirësuar projektligjin dhe kërkon që deputetët drejtpërdrejt ta shohin këtë gjendje dhe ta miratojnë, sepse romakët e vjetër kanë thënë: “Një popull i kulturuar mund ta shohësh sa është nëse ia shikon çfarë pyje ka” Nëse ne i shohim çfarë pyje kemi dhe çfarë prerje, shkatërrime po bëhet, po tregon se jemi shumë mbrapa në këtë zhvillim. Prandaj, me këtë ligj ne mund t’i mbrojmë, mund t’i zhvillojmë dhe mund t’i seleksionojmë.

Prandaj, ky ligj nuk është kundër pronës private, nuk është kundër pyjeve po është ligj që bënë një kontroll më të mirë një zhvillim më të mirë dhe krijon një strukturë shtesë që do t’i mbrojë këto pyje dhe do të jenë pjesë e parkut dhe ky park do të jetë pjesë e zhvillimit të kulturës e të traditës botërore. Faleminderit!

**KRYETARI:** Janë disa të lajmëruar, a keni shikuar mundësinë t’ia ndryshoni emrin? Zakonisht, ato njihen më tepër si Alpet Shqiptare se sa si Bjeshkët e Nemuna. Fjalën e ka deputeti sipas radhës Daut Haradinaj.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që shpallja e Bjeshkëve të Nemuna, parimisht domethënë qysh në emër unë jam kundër, sepse ato bjeshkë janë të nemuna për tjetërkënd, jo për shqiptarë. Po sido që të jetë ligji është i domosdoshëm për t’u shpallur Bjeshkët e Nemuna, park nacional, por i kemi 2-3 vërejtje brenda për brenda ligjit, sidomos në amendamentin 5.

*(Ndërprerje e incizimit)*

KRYETARI: Daut Haradinajt, edhe një herë fjalën regjia.

DAUT HARADINAJ: A jemi ok-ej? Faleminderit!

Kryetar, desha të them që ky ligj përpos që nuk shpjegohet saktë se çka do të ndodhë me pronarët e pronave publike e pronarët e pronave private ku përfshihen shumë fshatra, sidomos në pjesën e Rugovës.

Po flasim për një ligj që përfshinë 6 komuna duke filluar nga Qafë- Morina në Gjakovë e deri në pjesën ku përmbillet Istogu me Mitrovicë. Aty janë një pjesë shumë e madhe e fshatrave të cilat e rrethojnë gjirin e bjeshkëve, ku një pjesë shumë e madhe e atyre fshatrave janë prona private dhe këtu thuhet që ky problem do të zgjidhet me një ligj të veçantë i cili do të bëjë denacionalizimin e pronave. Pse ne nuk e bëjmë një ligj paraprakisht, verifikimin, evidentimin, denacionalizimin e pronave e mandej të vijmë deri te një ligj i cili do t'i mbronte Bjeshkët e Nemuna.

Sa për atë që i shpjegoj kryetari pamjet në televizion, unë mund t' i them që pikërisht ajo që e thamë edhe më herët për Ligjin e pyjeve, ato janë arsytet pse ka ardhur deri te një shkatërrim kaq i madh i pyjeve nëpër Kosovë, për shkak se i kemi tri instanca përgjegjëse të cilat asnjëra nuk e kryen punën e vet, por japin hapësirë elementeve keqdashës të cilët i bëjnë dëme në pyje.

Sinqerisht ju them që ky ligj nuk e zgjidh problemin dhe nuk do t'i mbrojë Bjeshkët e Nemuna, por përkundrazi u jap hapësirë prapë keqbërësve që të vazhdojnë me trendet e vjetra. Ky ligj është i dëmshëm për atë pjesë, ua cenon të drejtën qytetarëve të Rugovës me theks të veçantë edhe është ndesh me çdo vullnet qytetar në atë pjesë të Kosovës. Edhe i ftoj deputetët që ta votojnë kundër për shkak se është i qëllimshëm. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Vazhdojmë sipas radhës. Deputeti Njazi Idrizi, e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: I nderuar kryetar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Ministra,

Para kësaj pike sa po e hodhëm poshtë Ligjin bazik mbi pyjet. Ligjet kanë vlera tridimensionale, vlerat ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Ligji bazik është ai që i rregullon këto vlera dhe i shpërndanë nëpër dikastere, nëpër ministritë atje ku ato menaxhohen në mënyrën e duhur, në mënyrën që është paraparë.

Trajtimi i mëtejshëm i këtij ligji më duke që është i paligjshëm për faktin se neni 7 i Ligjit mbi pyjet thotë që me pyjet dhe tokat pyjore menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës.

Ne jemi marrë vesh që si Komision që këto tri ligje t'i trajtojmë bashkërisht për shkak si Kosovë ne kemi nevoja e nevoja të mëdha, janë nevojat e ngrohjes së popullsisë me dru zjarri.

Janë rreth një milion e 100 mijë metra kub që pyjet tona kanë potencial vjetor për t'i ofruar në tregun e konsumit.

Ndërsa, në këtë ligj nuk është e trajtuar kjo çështje si duhet.

KRYETARI: Ju kisha lutë juve anëtarëve të Komisionit të mos na merrni shumë kohë tash.

NIJAZI IDRIZI: Jo shkurt, desha ta them...

KRYETARI: Pra, është dashur ju ta bëni punën në komisione jo tash. Keni ardhur në procedurën e votimit dhe i kemi 5-6 amendamente.

NIJAZI IDRIZI: Atëherë, shkurt, nëse Ligji për pyjet është kthyer edhe këto dy ligje duhet të kthehen që të trajtohen bashkërisht.

KRYETARI: Mos i lidhni krejt ligjet bashkë se çdo ligj është ligj në veti.

NIJAZI IDRIZI: Jo ka ligje bazike dhe ligje që mbështeten mbi bazë.

KRYETARI: Ligjet janë veç secili e ka emrin e vet.

NIJAZI IDRIZI: Ligji mbi pyjet është ligj bazik i cili i reflekton nevojat tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Realisht, unë s'e kisha zgjatur kishim hyrë në procedurë të votimit. Kryetari i Komisionit e tha atë që duhet, amendamentet janë, vendosni me votim. Urdhëro, Nait, vetëm ti si kryetar i Komisionit edhe shkurt.

NAIT HASANI: Ju falënderoj edhe një herë kryetar!

Them që në këtë projektligj kanë marrë pjesë gjithë deputetët edhe këto që i tha Nijaziu nuk qëndrojnë, sepse tanë kohën i ka mbështetur, i kemi procesverbalet ku janë mbështetur. Secili deputet i ka mbështetur, me përjashtim të Dautit që nuk ka marrë pjesë edhe është në rregull që e thotë fjalën e vet, po përndryshe të gjithë të tjerët kanë marrë pjesë edhe e kanë dhënë pëlqimin edhe në mënyrë unanime janë votuar amendamentet për këtë projektligj. Prandaj kërkoj që deputetët t'i votojnë, t'i miratojnë dhe të jemi pjesë e proceseve. Ministria e ka marrë përgjegjësinë për implikimet buxhetore që ka implikime të brendshme, prandaj, kërkoj që të votohen.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe unë po them ashtu.

*(Reagime)*

Jo, jo ju lutem. Faleminderit, shumë! Ne në aspektin zyrtar nuk kemi dhe unë asnjë kryetari të Komisionit nuk ja japë fjalën, administrata është, rruga si bëhen kundërshtimet dhe amendamentet janë, ndiqni rrugën, jo sot.



Amendamenti 1

A ka kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër një.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Të pranishëm 66 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 34 vota për, 25 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Pika e dhjetë

## **10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Në Projektligjin për Bjeshkët e Sharrit, Komisioni ka shqyrtuar dhe ka amendamentuar, ka pasur parasysh edhe vërejtjet e banorëve të anës së Prizrenit që përfshin projektligji, po në të gjitha ato debate që kemi pasur edhe atje nga kryetarët e komunave dhe nga trupat përcjellëse është mbështetur projektligji, përveç që Agjencia e Pyjeve e ka kundërshtuar në vazhdimësi që na kanë përcjell mbrapa.

Prandaj, në Bjeshkët e Nemuna ka pasur vërejtje po vërejtjet kanë qenë shumë simbolike, ndërsa vërejtja kryesore ka qenë e Agjencisë së Pyjeve në raport me Koretnikun 2, ku është një dru i veçantë i pyjeve, quhet “rrobull” i mbrojtur me ligj dhe ndërsa ata kanë

kërkuar që mbas një parallogaritje që kanë pasur ata që i kanë ndihmuar USAID-i në certifikim kanë kërkua që të hiqet kjo. Ky është një dru i veçantë dhe ne kemi kërkuar të mbrohet se është një sipërfaqe prej 5000 hektarëve ku këtë vit atje janë djegur nga mos menaxhimi i mirë rreth 1000 hektarë, ku do të thotë që është një dëm i madh që iu ka shkaktua pyjeve të Kosovës edhe Koretnikut edhe këtij druri të veçantë. Prandaj, kërkohet që me këtë ligj të paktën do të ketë mundësi të mbrohet dhe të menaxhohet më mirë.

Ne kemi edhe raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Agjencisë të Emergjencës, ku tregon se djegiet edhe dëmet që janë shkaktua nëpër atë pjesë. Prandaj, me këto amendamente ne e kemi mundësua dhe mundësojmë që edhe ajo pjesë të hyjë pjesë e parkut kombëtar “Bjeshkët e Sharrit” dhe që do t’i mundësojë një zhvillim më të mirë dhe mbrojtje më të sigurt. Kërkoj deputetët ta votojnë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Unë ju njoftoj që rekomandimet nga Komisioni për dy ligjet janë do të thotë me konsensus, do të thotë njëzëri për t’u miratuar. Prandaj, edhe ky ligj i ka 6 amendamente. Po shkojmë në votimin e tyre.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Një kundër. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tash votojmë në tërësi. Votojmë tash! 67 deputetë të pranishëm.

Konstatohet se me 42 vota për, 15 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për parkun kombëtar “Sharri”.

Pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

## **11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ka pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka Ligji për regjistrimin e bujqësisë dhe në bashkëpunim me Ministrinë edhe me grupet që kanë marrë pjesë në amendamentim e kemi vlerësuar dhe vlerësojmë shumë të rëndësishëm këtë ligj, për shkak se në Kosovë nuk është bërë një regjistrim i bujqësisë që nga vitet e '60-ta dhe me këtë ligj mundësohet që të paktën ta kemi një statistikë të mirëfilltë për bujqësinë në Kosovë.

Amendamentet që i ka bërë janë pjesë me ekspertët që kemi punuar në këtë drejtim dhe me Agjencinë e Statistikave, prandaj kërkojmë që këto amendamente të miratohen edhe ky ligj të procedohet më tutje.

KRYETARI: Para se deputetët të fillojmë votimin e amendamenteve për ta amendamentuar ligjin janë procedurat se si bëhet kjo. Pra, në seancë kur miratohet ligji nuk ka amendamente.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër, nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash! Të pranishëm 69 deputetë.

Konstatohet se me 47 vota për, 14 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për regjistrimin e bujqësisë.

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës:

## **12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e bimëve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e bimëve dhe në këtë ka angazhuar ekspertë të fushës, ka shqyrtuar dhe ka nxjerr amendamentet. Si Komision mendojmë që i kemi plotësuar të gjitha ato që është dashur ekspertët që kanë kërkuar që kjo fushë i mungon dhe kemi kërkuar që edhe kërkojmë si Komision që ky projektligj dhe këto amendamente të miratohen dhe ligjit të procedohet më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara. Janë gjithsejtë 12 amendamente.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Të pranishëm 67 deputetë. Votojmë tash

Konstatohet se me 56 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen e bimëve.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës:

### **13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e ka trajtuar këtë projektligj. Falënderoj Grupin punues dhe gjithë deputetët që kanë marrë pjesë në punën e Komisionit, po ashtu edhe të gjitha palët e interesit edhe Shoqatën e Zejtarëve që kanë dhënë kontributin e tyre. Kanë qenë disa prej çështjeve që kanë qenë të diskutueshme pak më shumë se zakonisht në projektligje tjera. Konkretisht ka qenë shumë e diskutueshme çështja e vendosjes së vulës shtetërore si një prej vulave në këto punime të metaleve.

Besoj që Ministria përkatëse, Ministria për Tregti dhe Industri me Departamentin përkatës të nxjerrë sa më shpejtë që të jetë e mundur udhëzimet administrative dhe në përputhje me këtë ligj dhe ligjet tjera që mbulojnë këtë fushë, t'u mundësojë këtyre zejtarëve, këtyre njerëzve fabrikave që merren me punimin e metaleve të çmuara që të mos kenë vështirësi po ky ligj të jetë një begati në këtë fushë.

I falënderoj të gjithë dhe po ashtu kërkoj nga gjithë deputetët që ta mbështesin ta votojnë këtë. Komisioni po ashtu ka qenë unanimit në miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Shkojmë në votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet Amendamenti 19.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash.

Të pranishëm janë 68 deputetë.

Konstatohet se me 50 vota për, 4 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për punimet nga metalet e çmuara.

Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës:

#### **14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetoj raportin me rekomandime. Deputete e ke fjalën.

**SAFETE HADERGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, pas miratimit në parim të Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë, ka shqyrtuar projektligjin dhe Komisioni ka bërë plotësim- ndryshimet e nevojshme të cilat e kanë pasuruar Projektligjin për sigurimin e depozitave në Kosovë.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2012, ka miratuar amendamentet e propozuara nga grupi punues i cili është themeluar enkas për ta përmirësuar këtë projektligj. Me amendamentet e propozuara, përpos tjerash është rregulluar edhe çështja e shumës maksimale të limitit të sigurimit të depozitave. Po ashtu është përcaktuar qartë definimi i saktë i burimeve të financimit si dhe qëllimi i shfrytëzimit të Fondit për rimbursim të depozitave si dhe mbulimit të shpenzimeve operacionale.

Po ashtu është rregulluar edhe çështja e themelimit të bordit menaxhues të Fondit të sigurimit të depozitave. Kurse, disa ndryshime tjera më tepër janë ndryshime formale dhe juridike të cilat i janë bërë ligjit.

Raporti me amendamente është miratuar njëzëri nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, kështu që rekomandojmë deputetët që t'i miratojnë amendamentet dhe ligjin në tërësi.

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.



Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash!

Të pranishëm 67 deputetë.

Konstatohet se me 53 vota për, një kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës:

## **15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka për këtë deputetja Xhevahire Izmaçu.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, kryetar!

Edhe Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22.11.2012 e shqyrtoi Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, të propozuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë raport lidhur pra me Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës.

Projektligji ka gjithsej 22 nene dhe ka 15 amendamente. Do të theksoj vetëm amendamentin 1, tek neni 20, ku paragrafi 1, riformulohet si vijon, pra nenet 3, 4, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 16, 17, 19 dhe 20 fillojnë së zbatuari nga viti 2016, nëse krijohen kushtet financiare.

Ndërsa tek amendamentet tjera komplet është unanim votimi i gjithë anëtarëve të Komisionit. Unë ju ftoj deputetët që të votojnë pro. Faleminderit!

**KRYETARI:** Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet..

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet..

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet

Amendamenti 15

Propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Pra tani votojmë me elektronikë. Amendamentin e 15, propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Konstatohet se më 17 vota për, 37 kundër, 4 abstenime, nuk miratohet amendamenti 15 i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash. Të pranishëm janë 73 deputetë.

Konstatohet se me 63 vota për, 3 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për arsim dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës:

## **16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësi**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shëndetësinë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputetin Fikrim Damka, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Deputet, e ke fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të neneve 57, 58 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 13, 21 qershor, 9 korrik, 4 dhe 26 shtator, 28 tetor dhe 3 dhjetor 2012, shqyrtoi Projektligjin për shëndetësi, të propozuar nga Qeveria dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë raport.

Komisioni e ka shqyrtuar këtë ligj dhe ka rekomanduar gjithsej 60 amendamente. Mund të them se kemi bashkëpunuar shumë ngushtë për çdo amendament me ministrin e Shëndetësisë, ashtu që e kemi përkrahjen prej ministrit të Shëndetësisë.

Kemi edhe disa amendamente të propozuara nga deputeti Liburn Aliu. Unë besoj që ai do t'i paraqesë arsyetimet për këto amendamente.

Komisioni rekomandon që Kuvendi të miratojë këtë projektligj me amendamentet e propozuara.

*(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Zoti Shaip Muja e ka kërkuar fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Lidhur me Ligjin për shëndetësi, mendoj se është bërë një punë e mirë, me gjithë qasjen që i është bërë, ka shumë lëshime në këtë ligj dhe unë shpreh qëndrimin tim publik, që ky ligj nuk duhet të kalojë në disa pika dhe duhet t'i jepet një mundësi që të tërhiqet për një kohë, për t'u miratuar në tërësi.

Dhe, ky ligj aq më shumë bie në disa pika në disa pika ndesh me të drejtat e njeriut, me kufizimin e lirive dhe të drejtat e njeriut të punonjësve, bie ndesh me Ligjin e punës së Republikës së Kosovës dhe po ashtu, janë disa vërejtje teknike, të cilat edhe Komisioni Funkcional ka amendamentuar disa pika, të cilat mendojmë që të shkojnë.

Prandaj, nëse ligji shkon në tërësi në këtë mënyrë, unë mendoj që do të gjenerojë probleme serioze dhe kryesisht në nenin 41, ku parashihet një amendamentim edhe nga Komisioni Funkcional, që në kohë të fundit po mundohen ta rregullojnë me disa forma të organizimit institucional të punës private në institucionet publike, që unë e kundërshtoj.

Dhe, Ligji për angazhimin publiko-privat të institucioneve biznesore, qoftë edhe në institucionin shëndetësor, ai është ekzistues momentalisht dhe nuk ka nevojë të jetë në këtë ligj. Dhe po ashtu, nuk jam dakord që në kuadër të institucioneve të shëndetësisë të punohet në pjesën pas orarit të punës brenda institucionit me tarifa private, apo me forma të cilat i ka paraparë edhe komisioni.

Në nenin 41, po ashtu kemi shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, meqë nuk mund të kufizohet askush se çka do bëjë pas 8 orëve orar të punës.

Mendoj se Ministria e Shëndetësisë ka trashëguar një varg problemesh dhe nuk ka arritur kapacitete të monitorimit, për monitorimin kuantitativ dhe kualitativ të shëndetësisë dhe të shohë angazhimin sasior dhe cilësor të mjekëve dhe me këtë ligj, unë nuk besoj që arrihet çështja e rregullimit të menaxhimit brenda institucioneve shëndetësore.

Edhe një vërejtje, që jam dakord, krijimi i Bordit lidhur me Shërbimin shëndetësor të Kosovës. Unë jam dakord, që Bordi të kalohet në miratim në Kuvend. Çdo ministër mund ta ndryshojë bordin në rastet më të mira, kur nuk i intereson, ndërsa Kuvendi mund të jetë një nivel pak më i lartë, i cili mund ta ndryshojë Bordin. Ndoshta, është një propozim i cili ka nevojë, ka edhe probleme gjuhësore, ka edhe probleme shkencore ligji. Vetëm një shembull, që shihet këtu, për shembull Ministria e ka paraparë shumë mirë, ku thotë: preventiva për sëmundjet malinje. Ndërsa, komisioni shkarkohet në probleme të veçanta, të kufizuara, të cilat në mënyrë gjenerale e përfshinë Ministria, ndërsa komisioni thotë: - me theks të veçantë për këto, këto sëmundje malinje.

Prandaj, ky është qëndrimi im dhe ftoj deputetët, që këto vërejtje të mija t'i marrin seriozisht, nuk janë aspak në aspektin personal ose diçka tjetër, mirëpo janë kryesisht në interes të funksionimit sa më të mirë të ligjit. Janë shumë probleme, të cilat nuk varen nga ky ligj në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në shëndetësi në tërësi dhe të cilat janë më shumë të natyrës menaxheriale se sa të natyrës legjislative. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Hasani e ka fjalën.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryesues!

Unë, me këtë projektligj nuk jam marrë shumë, po jam marrë me nenin 41 të këtij projektligji, te konflikti i interesit. Dhe, më intereson nga amendamentuesit që e kanë bërë amendamentin 37, që të na tregojnë neve se a ka në institucionet publike, brenda tyre edhe institucione private? Në amendamentin që është bërë është pika 5, ku shkruan: - institucionet publike shëndetësore publike kanë të drejtë që t'ua mundësojnë profesionistëve shëndetësorë të punësuar në to, që të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore brenda vetë institucionit publik shëndetësor. Kjo është konflikt interesi dhe prandaj, ky amendament është në kundërshtim edhe me Ligjin për konflikt të interesit.

Mendoj që ky amendament duhet ose të hiqet, ose të rregullohet, ose të formulohet më ndryshe: gjatë orarit të punës. Përndryshe, ky amendament tregon që ka konflikt interesi, se brenda një institucioni publik të lejohet institucioni privat.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Projektligji që po fillojmë ta miratojmë ka 60 amendamente. Për amendamentin e 3-të, të 30-të dhe 50-të janë dhënë nga dy propozime, propozimi i Komisionit Funkcional dhe propozimi i deputetit Liburn Aliu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Amendamenti i 23-të është propozim i deputetit Liburn Aliu, pa përkrahjen e Komisionit funksional, që t'i keni parasysh në kohën kur të vijë në radhë. Edhe deputeti Aliu ka të drejtën e fjalës edhe deputetët, për çdo amendament mund ta merrni fjalën.

Në sallë janë 77 deputetë. Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3 - Për amendamentin e tretë e kemi propozimin e Komisionit Funksional dhe propozimin e deputetit Liburn Aliu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Aliu e ka kërkuar fjalën.

LIBURN ALIU: Unë këtë amendament do ta tërheq, meqenëse gjatë punës në komision e kemi ndryshuar projektligjin dhe amendamenti nga komisioni është në përputhje me qëndrimet, që i kemi pasur.

KRYESUESI: Në rregull, faleminderit. Kundër? S'ka. Domethënë, miratohet amendamenti i 3-të, me arsyetimin që e tha zoti Aliu.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23 - është propozim i deputetit Liburn Aliu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Aliu, e dëshironi fjalën?

LIBURN ALIU: Njëjtë është edhe tek amendamenti 23. Pra, në diskutim gjatë punës në komision, këtë amendament e kemi trajtuar dhe është ndryshuar në bazë të diskutimeve të përbashkëta që i kemi pasur, kështu që unë e tërheq amendamentin 23.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu e tërheq amendamentin.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30, dy propozime janë. Propozimi i Komisionit Funkcional dhe propozimi i deputetit Liburn Aliu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Amendamenti që unë e kam propozuar është që të fshihet paragrafi 1 tek neni 20, që ka të bëjë me kujdesin shëndetësor nëpër komuna.

Duhet ta kemi të qartë, që meqenëse me ligj lejohet kujdesi primar të jetë nën kompetencën e komunave, që është si rezultat i Pakos së Ahtisaarit, tash një e drejtë e tillë po bëhet për këto komuna edhe për kujdesin sekondar.

Duke pasur parasysh që funksionon një universitet në veri të Mitrovicës dhe kjo i bie, që të ketë edhe sistem të tretë, që i bie që komuniteti, në këtë rast komuniteti serb, të ketë të ndërtojë një sistem unik, gjë që Kosova nuk mund ta ketë, pikërisht për shkak të Pakos së Ahtisarit.

Pra, ne në përgjithësi në Kosovë, nuk mund ta kemi sistemin unik, për shkak të Pakos së Ahtisarit. Dhe, nëse duam të ndërtojmë sistem unik, ne nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë, pa i pasur votat e shumicës së dyfishtë. Pra, neve na cenohet një e drejtë e tillë, pikërisht nga Pakoja e Ahtisarit, ndërsa në anën tjetër, pikërisht ata që e kanë të drejtën të na e cenojnë neve këtë të drejtë, ata për vete mund ta ndërtojnë sistemin unik, gjë që është një padrejtësi dhe një asimetri parimore dhe ne jemi kundër paragrafit 1 të nenit 20. Dhe, ta hedhim në votim.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Muja.

SHAIP MUJA: Sa për sqarim lidhur me këtë propozim, që bën zoti Liburn është e caktuar qartë me vendim të ministrit të Shëndetësisë dhe ministri i Shëndetësisë kur aprovon licencimin e një shërbimi sekondar, ka disa standarde, të cilat janë të bazuara në



standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të cilat i lejon mbi kapacitetin e nevojave të shërbimeve që krijon ai komunitet.

Prandaj, unë nuk e shoh si problematikë, ndërsa shërbimi primar është i garantuar dhe në strukturat me pakicë, por nëse paraqitet si nevojë dhe mundësi që të mbahet një shërbim i tillë, janë mekanizmat monitorues të Inspektoratit Shëndetësor që edhe nëse ia lëshon një ministër, ministri tjetër mund t'ia mbyllë, sepse nuk i plotëson kushtet. Nuk ka as nevojë të shërbimeve, po nuk ka as kapacitete të plotësimit për shërbime të tilla, mbi bazën e statistikave që ofron ai komunitet.

Prandaj, unë nuk e kisha pa si të nevojshme që të politizohet dhe mendoj që ligji nuk e ka të nevojshme të plotësohet me këtë amendament. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Aliu, dëshiron të sqarojë më tutje?

**LIBURN ALIU:** Kjo pjesë e ligjit, tanimë është politike. Ne do të dëshironim ta kishim një sistem unik dhe sistemin unik nuk po mund ta kemi, pikërisht për shkak të Pakos së Ahtisarit, në nivelin primar, madje edhe atë do të donim ta kishim nën kontroll të Ministrisë, sikur që është kudo në botë, ta zëmë në Turqi apo kudo.

Po tash po kërkohet madje edhe niveli sekondar të shpëputet nga Ministria. Kjo është një dekompozim i sistemit, nuk është më çështje e decentralizimit. Pra, po dekompozohet plotësisht, kur ne e kemi shumë të qartë, që madje edhe sistemin terciar ne nuk do ta kemi nën kontroll pjesën e Universitetit, sepse do të ketë shumë shpejtë edhe në atë aspekt ndonjë lëshim së shpejti, me këtë trend si është duke shkuar.

Prandaj, këtu nuk është çështje politizimi. Këtu është çështje pikërisht e luftimit të politizimit, sepse politizimi e ka prurë deri në këtë gjendje.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Besoj, Shqipëria të njëjtën gjë do ta thuash prapë. Kështu që nëse do, merre fjalën.

**SHAIP MUJA:** Unë mendoj që nuk është politike, por është e bazuar dhe nuk ka nevojë që ta përziejmë politikën shumë në shëndetësi. Mirëpo, nëse analizojmë, për shembull, realisht në regjionin e Mitrovicës, asnjëri spital nuk është duke bërë shërbime të nevojshme, të mjaftueshme për komunitetin. Janë dy spitale regjionale atje dhe të dyja janë duke e penguar njëra tjetrën. Dhe, nesër në organizimin shëndetësor, kur të funksionalizohet edhe Agjencia e shërbimeve i sigurimeve shëndetësore, do të jetë niveli i blerjes së shërbimeve. Prandaj, nuk ka nevojë të politizohet si problem.

Unë kisha thënë, që kryetarët e komunave që janë në shërbime të shërbimit sekondar, të kenë prezencën për emërimin e menaxhmentit, sepse drejtorët e spitaleve nuk përcaktohen nga kryetari i komunës, por përcaktohen nga Ministria. Dhe, në opinion publik, mendohet që kryetari i një komune e ka caktuar një drejtor të spitalit, e de fakto nuk e cakton dhe atributet e keqmenaxhimit të atij spitali i dërgohen në faturë të kryetarit të komunës. Prandaj, mendoj që në sistemin menaxherial është problemi më shumë për

emërimin e menaxhimit, ndërsa monitorimi edhe i kualitetit të shërbimeve shëndetësore edhe i kuantitetit të shërbimeve shëndetësore është mënyrë unike. Duhet të jetë në nivel edhe me Pakon e Ahtisarit, është në nivel të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Aliu, prapë s'po pajtohet.

LIBURN ALIU: Me këtë ligj, komplet sistemi shëndetësor në pjesët e banuara me komunitetin serb, do të shkëputet nga kontrolli i Ministrisë. Do t'i mbeten eventualisht, disa fije të lehta, të cilat kanë të bëjnë me pagesat shtesë, që kanë të bëjnë lidhur me pagesën për performansë.

Pra, në mënyrë graduale shkëputet plotësisht. E vetmja linjë dhe nyjë e kontrollit në atë pikë ka qenë sistemi sekondar. Nëse kjo hiqet, atëherë do të ketë totalisht humbje të kontrollit në sistemin shëndetësor në këto pjesë.

KRYESUESI: S'ka diskutime tjera. E hedh në votim amendamentin 30, propozimin e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Miratohet amendamenti i Komisionit FunkSIONAL. Nuk miratohet, nuk kalon amendamenti i zotit Aliu.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37 - A ka vota kundër amendamentit 37. Votojmë me elektronikë pra, pasi që ka vota kundër. Votojmë tani (*Dëgjohen debate nga salla.*) A dëshironi të diskutoni ? Zoti Beqiri, e drejta për të diskutuar në çdo amendament është e çdo deputeti. Nuk mund t'ia ndaloj diskutimin askujt.

Për diskutim është lajmëruar, lidhur me amendamentin 37, zoti Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Lidhur me amendamentin 37, është një amendament që ka të bëjë me ligj me nenin 41 dhe shumica e punëtorëve shëndetësorë, po edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, janë të interesuar rreth kësaj çështjeje, për arsye se është konsideruar si njëri prej amendamenteve i cili konsiderohet si bazë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për reformën në sistemin shëndetësor.

Mirëpo, gjithashtu është konsideruar dhe diskutuar shumë në qarqet e punëtorëve shëndetësorë dhe e drejta e zbatimit dhe e luftimit të konfliktit të interesit në këtë formë.

Prandaj, unë konsideroj që fillimisht Ministria e Shëndetësisë ka bërë një punë të mirë dhe voluminoze bashkë me Komisionin në shqyrtimin dhe amendamentimin dhe punën në këtë ligj, sigurisht, duke pasur vërejtjet tona rreth disa çështjeve, të cilat mendoj se kanë mundur të punohen edhe më mirë.

Mirëpo, edhe unë jam munduar që bashkërisht me Komisionin të jap kontributin tim në kuadër të këtij ligji dhe që ky ligj të jetë vërtet sa më i mirë dhe në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kam konsideruar dhe kam diskutuar edhe në Komision, po edhe bashkërisht me shkrim kam dorëzuar amendamentin, sa i përket nenit 41.

E kemi diskutuar në Komision dhe unë kam kërkuar që ky ligj për konfliktin e interesit të hyjë në fuqi apo të fillojë të respektohet bashkë me ligjin, posa të hyjë në fuqi Ligji mbi sigurimet shëndetësore.

Konsideroj që është një e metë e Ligjit për shëndetësi moszbatimi apo mos fuqizimi i Ligjit për sigurime shëndetësore apo trajtimi i këtij ligji bashkërisht me Ligjin mbi sigurimet shëndetësore, e cila është një mangësi edhe në shumë çështje tjera do të paraqesë probleme, ne veçanti te aplikimi i bashkë pagesave dhe zbatimi i formës apo amendamentit 41, i cili ka të bëjë me konfliktin e interesit.

Për këtë qëllim, kam propozuar që zbatimi i këtij neni të hyjë në fuqi pas miratimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore, gjegjësisht të jepet një kohë prej 3 vjetësh, që ky ligj apo ky amendament i këtij ligji, të hyjë në fuqi pas miratimit të këtij ligji.

E kam dorëzuar edhe me shkrim në Komision dhe mendoj që kjo do të ishte një zgjidhje ideale, sa i përket punëtorëve shëndetësorë, derisa të miratohet ky ligj, gjegjësisht të jetë në fuqi ky amendament 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij neni.

Dhe, posa të vijmë te amendamenti 60, i cili e rregullon këtë çështje dhe i jep një koherencë prej një viti, mendoj se do ta kërkoj fjalën edhe njëherë kur të arrijmë tek amendamenti 60, për arsye se aty është paraparë që hyrja në fuqi apo zbatimi në fuqi i këtij amendamenti të këtij neni të jetë kryesisht një vit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit. Ismet, do ta kesh fjalën, po mendoj që amendamenti 37, po kuptohet për çka është. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar,

Unë ju kisha lutur, që të procedoni sipas Rregullores. Nëse këtu është një amendament dhe ai i Komisionit funksional dhe nuk ka propozime tjera, pse hapet debati? Nëse ka në Komision, ajo është tjetër çështje. Edhe anëtarët tonë kanë qenë në Komision. Çka kanë dhënë ide në Komision e s'ju ka kaluar, këtu e kemi një propozim, prandaj mos hapni debatin përsëri në seancë, nëse s'ka. Zoti Aliu kishte amendamente dhe pati të drejtë për ta sqaruar dhe arsyetuar, por jo tash në të tjerët, na bie ndërmend diçka edhe të themi, për çdo amendament tash mund të flasim.

Prandaj, unë ju kisha lutur, procedoni sipas Rregullores. Rregullorja thotë të flitet për amendamentet, që janë këtu dhe jo ato që i ka dikush në imagjinatë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pikërisht për amendamentin 37, unë nuk mund t'ia marr fjalën askujt! Fjalën e ka zonja Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Edhe unë u befasoja që për amendamentet u lejua që të zhvillohet debati, sepse ka pasur kohë, gati një gjysmë viti është zhvilluar debati në kuadër të komisionit.

*(Dëgjohen zëra nga salla)*

Po, konkretisht kam dhe tash mos u nervozoni, se ju lejuat debatin nga një gjysmë ore. Dhe, e shfrytëzoj të drejtën time.

Duke qenë se në disa grupe parlamentare pati vërejtje edhe Komisioni për Buxhetin pati vërejtje në amendamentin 37, ne u mbledhëm si Komision dhe e reduktuam këtë amendament dhe përfundojmë me këtë konkluzion.

Fshihen pika 5 dhe 6 dhe mbetet vetëm një pikë, pra pas nenit 41, paragrafi 4, shtohet një paragraf. Në institucionet publike shëndetësore lejohet veprimtaria private shëndetësore, për profesionistët shëndetësorë të punësuar në to, me kushte dhe në rrethana të caktuara dhe kjo çështje rregullohet me akte nënligjore, të nxjerra nga Ministria. Që do të thotë, se këtyre nuk iu shkelet e drejta, për të cilën foli kolegu im Shaip Muja, por në afat të caktuar do të nxirren aktet nënligjore dhe t'iu mundësohet kjo e drejtë kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë diçka dua të sqaroj. Në bazë të Rregullores, ju afatin kohor të dorëzimit të amendamentit ndryshe e keni pasur me Rregulloren, megjithatë e drejta e juaj sot është të votoni për ose kundër, por e keni të drejtën e fjalës. Zoti Muja, urdhëro!

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

Lidhur me nenin 41, komuniteti shumicë shëndetësor është kundër. Dhe, unë e përkrah qëndrimin e tyre, janë sindikatat e shëndetësisë, që kanë marrë vërejtje çdo deputet këtu. Dhe, nëse mendojnë se pa punonjësit shëndetësorë ta zhvillojnë shëndetësinë, ju mund të vazhdoni të aprovoni ligje, ndërsa Ligji i punës së Republikës së Kosovës nuk e lejon restriktionin për asnjë lëmi, sepse nuk bie ndesh.

Pas tetë orë pune, që punon një punonjës në një institucion publik, nuk mund ta kufizosh se çfarë detyre ka me legjislacion, bile së paku plus 4 orë punë.

Qëllimi që të futet në institucionet publike, të bëhen, janë këto eksperimente të dështuara. Janë në shtetet ku funksionon sistemi i informimit shëndetësor...

*(Ndërhyrje Flora Brovina: Ju lutem, ky është debat!)*

Nuk është debat, por kjo është, po më vjen keq, por Komisioni për Shëndetësi nuk ka absorbuar mjaftë informacione për strukturën, çka ka ndodhur nëpër shtete ku iu kanë dështuar. Ne s'kemi nevojë të bëjmë eksperimente me vetveten.

Unë kërkoj që të tërhiqet komplet neni 41 dhe të mos figurojë fare, as propozimi i juaj si Komision, nuk është valid, do të gjenerojë probleme dhe as propozimi, i cili është në kufizimin e të drejtave pas 8 orë punë. Faleminderit!

*(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)*

KRYESUESI: Zoti Hasani edhe ti je lajmëruar për amendamentin 37.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Ne duam sqarime të mjaftueshme në institucionin publik, lejohet apo nuk lejohet veprimtaria private? Nëse, në bazë të këtij neni, nëse ky amendament miratohet, atje lejohet në një institucion publik edhe institucionet private. Prandaj, kjo është konflikti i interesit dhe kërkojmë që të hiqet dhe të mos kemi konflikt të interesit në bazë të ligjit.

KRYESUESI: Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Secili grup parlamentar sot që është këtu i ka përfaqësuesit e vet në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Mua po më vjen keq, që s'ka pasur harmonizim të qëndrimeve të përfaqësuesve në Komision dhe të përfaqësuesve të subjektit politik, të cilin ata e përfaqësojnë dhe sot na keni lëshuar në një debat të tillë.

Unë edhe në Komisionin Parlamentar, normalisht me harmonizimin e qëndrimeve me grupin parlamentar kam votuar kundër, mirëpo sot s'po e shoh të arsyeshme të kalojmë në debate të tilla. Vota le ta përcaktojë kush si do të shkojë. Cilat amendamente do të shkojnë? Ato të Komisionit Funkcional, apo do të shkojnë amendamentet, që janë propozuar nga kolegët tanë deputetë dhe të mos lëshohemi në debat të panevojshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryesues,

Pikësëpari kemi vërejtje parimore, sepse sa i përket këtij projektligji dhe këtyre neneve, nuk je kah e trajton ashtu siç duhet dhe siç e thotë Rregullorja e punës e Kuvendit.

Pavarësisht që po ua lejon deputetëve sipas Rregullores që të diskutojnë për amendamentin në fjalë.

Por, esenca është se këtu kemi një amendament, i cili është plotësuar nga Komisioni funksional dhe kemi dy mendime, një alternativë për reformën në shëndetësi, e paraqitur nga ministri dhe Qeveria dhe një alternativë tjetër nga pozita, deputetë të opozitës, të cilët e kundërshtojnë këtë reformë.

Dhe, ju deri më tani nuk kërkuat nga ministri shpjegim, çka do të parashehë ky me këtë akt nënligjor dhe plotësimin e këtij neni konkret. Dhe, unë kërkoj ta hidhni në votim. Ata që janë për këtë reformë dhe ata që e kundërshtojnë këtë reformë dhe nuk kemi nevojë ta zgjasim tërë ditën, çka kanë diskutuar qe gjashtë muaj. Faleminderit, shumë!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Po, unë duhet ta procedoj sipas radhës dhe renditjes që janë amendamentet. Unë as nuk i kam bërë amendamentet dhe nuk e kam shumë me qejf të dëgjoj diskutime për këtë çështje, por e drejta e diskutimeve është. Qe, tani po paraqiten prapë.

Zoti ministër e ka të drejtën sa herë të dëshirosh të diskutosh dhe të sqarosh. Nuk e ka kërkuar fjalën akoma. Gëzim Kelmendi është paraqitur.

**GËZIM KELMENDI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Padyshim që shumica nga ne, ndoshta nuk ishim të pajtimit për një hapje të debatit të tillë, për faktin, siç e përmendi edhe shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri, që ky amendament 37, ka mbështetjen e Komisionit Funksional. Në përgjithësi projektligji në komision ka kaluar me 5 vota për, 3 abstenime dhe 1 kundër, edhe u cek ashtu.

Por, do të isha ndjerë keq, sikur të mos kisha dhënë një informatë për sqarim të opinionit. Është e vërtetë, sa i përket këtij projektligji për shëndetësi, është dezinformuar opinionin, se gjoja në emër të nenit 41, u ndalohet veprimtaria private profesionistëve shëndetësorë.

Amendamenti 37, i cili ka pasur mbështetjen e Komisionit Funksional shumë mirë e sqaron, se profesionistit shëndetësorë nuk i ndalohet veprimtaria private. Përkundrazi, atij i lejohet në institucionin ku punon. Dhe, kjo padyshim që është shumë e mirë edhe për vetë profesionistin, për pacientin dhe për vetë spitalin ku punon, konkretisht institucionin ku punon. Prandaj, çdo debat i tepërt do të na drejtojë në drejtim të kundërt.

Amendamenti në fjalë, konkretisht 37, ka pasur mbështetjen e Komisionit Funksional dhe shumë mirë e sqaron veprimtarinë e profesionistit shëndetësor.

**KRYESUESI:** Dy herë s'ia jap kurrkujt fjalën! Zonja Mustafa e ka fjalën.

**SALIHE MUSTAFA:** Faleminderit, kryesues!

Ne në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, vërtet kemi punuar gjatë dhe çdo nen, çdo amendament e kemi analizuar mirë e mirë, andaj unë sot do të kisha kërkuar prej jush – ka qenë kohë e mjaftueshme e deputetëve edhe për amendamente edhe për të ardhur për të punuar në komision. Sot, kisha kërkuar që të kërkonte prej deputetëve që të deklarohen me votë, e jo me fjalë.

**KRYESUESI:** Zoti Thaçi e ka fjalën. Bahri Thaçi.

**BAHRI THAÇI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Përafërsisht, atë që desha ta them e tha Gëzimi. Ne, polemikat më të mëdha i kemi pasur rreth nenit 41, kryesisht punëtorët shëndetësorë e kanë kundërshtuar atë. Dhe, kjo ka ardhur më shumë edhe si një kompromis, që të mos dëmtohen punëtorët shëndetësorë, se ata janë thirrur që kanë shumë punë, kanë shumë operacione, nuk mund t'i kryejnë brenda një orari të punës. Dhe, atëherë nuk është e obligueshme, por drejtori i Klinikës, po e precizoj, ka të drejtë që një ekipi t'ia japë të drejtën nesër, pasnesër, kur të bëhen sigurimet shëndetësore, që operacionin ta kryejë në Klinikë. Dhe, aty fiton pacienti, fiton personeli dhe fiton Klinika.

Unë jam i sigurt, që këtu secili prej nesh përfaqëson dikë, dhe dikush përfaqëson njërin grupacion, interesin e njërit grupacion më shumë, dikush të tjetrit. Unë mendoj, se ky ligj në fokus kryesor ka qytetarin, gjegjësisht pacientin.

Por, jemi munduar që në asnjë mënyrë të mos e cenojmë të drejtën e profesionistit shëndetësor. Kështu që unë mendoj që kjo po debatohet pak tepër, nuk ndodhi kështu me ligjet tjera. Unë mendoj se këtu është një amendament, të cilin Komisioni Funkcional e ka aprovuar dhe mendoj që duhet të procedohet dhe të shkohet më tej.

Në qoftë se lëshohemi kështu, unë besoj se për këtë ligj do të diskutojmë edhe sot, edhe nesër, dhe përsëri do të vijmë në pikën e njëjtë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë besoj se të gjithë po e kuptoni se çka domethënë ky nen, por megjithatë unë e hedh në votim elektronik. Kush është për dhe kush është kundër miratimit të këtij neni? Votojmë tash! E votojmë me elektronikë amendamentin 37. Kush është për dhe kush është kundër?

Edhe një herë e përsëritim votimin se nuk kanë mundur të votojnë. Votojmë tani, edhe një herë e përsëritim. Ju lutem, ju lutem! Po ke bërë sqarim, Shaip. Është kryer diskutimi!

Tani meqenëse deputetët u vonuan, po dihet kjo punë - për ta dhënë spitalin publik me qira është, nuk është për ta futur në sallë, a çka janë ato.

E votojmë tani amendamentin e Komisionit, kush është për e kush kundër?

Miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Me 2 vota kundër, miratohet

Amendamenti 42

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Janë dy propozime, është propozimi i Komisionit FunkSIONAL dhe propozimi i deputetit LibURN Aliu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zoti Aliu, e keni fjalën.

**LIBURN ALIU: Faleminderit!**

Edhe te ky amendament, unë do ta tërheq propozimin tim për shkak se ndërmjet variantit origjinal të Projektligjit dhe variantit të ndryshuar, edhe pse nuk pajtohem 100% me variantin e ri, sidoqoftë është variant i përparuar në krahasim me Projektligjin dhe unë e tërheq, sepse propozimi im në këtë rast është fshirje e amendamentit, fshirje komplet e



paragrafit dhe më mirë është që të qëndrojë paragrafi siç është propozuar nga Komisioni, se sa të fshihet krejt.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Konstatoj që zoti Aliu e ka tërhequr propozimin për amendamentin e tij.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 53

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 54

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 55

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 56

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 57

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 58

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 59

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 60 - diskutim apo kundër? Diskutim, zoti Haxhiu për amendamentin 60.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës! Unë e thash edhe në diskutimin tim të mëhershëm se ky amendament ka të bëjë prapë me amendamentin 41 dhe ka të bëjë me fillimin e zbatimit të nenit 41 të këtij ligji, ku pashijet se zbatimi i atij neni të fillojë një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Unë e kam dorëzuar edhe me shkrim në Komision, pse Komisioni nuk e ka proceduar në seancë, është çështje e tyre, mirëpo kam kërkuar që zbatimi i këtij neni të fillojë pas zbatimit të Ligjit për sigurime shëndetësore, përkatësisht të fillojë së paku 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Kjo periudha që parashihet prej një viti, të jetë periudhë e fillimit të zbatimit pas tre vjetëve,

prandaj do të kërkoja nga ju që kjo çështje të hedhet në votim në seancë. Pse Komisioni nuk e ka proceduar me shkrim, nuk e di, mirëpo ka qenë e shqyrtuar edhe në Komision për arsye se kam marrë pjesë në shumicën e mbledhjeve të Komisionit gjatë shqyrtimit të këtij ligji. Prandaj kërkoj që çështja e hyrjes në fuqi dhe zbatimit të nenit 41 të hedhet në votim, për arsye se ky amendament ka të bëjë me kohën e fillimit të zbatimit të nenit 41. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! E vetmja mundësi është që ta hedh në votim amendamentin 60, meqenëse nuk keni proceduar asgjë dhe mundësia juaj është që të kërkonit procedurë të re për ta shtuar amendamentin tuaj lidhur me amendamentin 60. Zoti Muja dëshiron të flasë.

**SHAIP MUJA:** Zoti kryesues!

Me keqardhje dua të përgjigjem se më vjen keq nëse më thotë një profesionalist shëndetësor që i vjen keq çka po flas unë. Për ju, nuk ua shoh për të madhe, edhe për disa të tjerë, që po i dëgjoj duke folur. Ajo çka po veprojmë sot ne, jemi duke e shkaktuar një problem social, i cili nuk është ashtu siç pasqyrohet këtu në ligj. Unë kam kërkuar, jo për një vit e dy vjet, tre vjet. Kosova nuk ka ende kapacitete që ta monitorojë sasinë dhe cilësinë e punës te punonjësit shëndetësorë. Janë disa probleme, është sistemi shëndetësor i pastabilizuar, është Agjencia e Sigurimeve Shëndetësore që nuk funksionon dhe e cila i gjen punë mjekut që të punojë edhe deri në orën 17 a 18 në institucionin publik ose privat, e ai nuk mund të punojë ai pas 12 orësh punë.

Ky ligj nuk do ta rregullojë laboratorin. Ky ligj nuk do ta rregullojë as Onkologjinë. Ky ligj nuk do t'i hapë departamentet. Ky ligj nuk do ta funksionalizojë sistemin primar dhe sekondar, prandaj kërkoj edhe një herë që neni 41 jo të afatizohet, por të fshihet komplet dhe ka mundësi që ministri ta amendamentojë vetëm si ligj, prandaj edhe Komisioni Funkcional ka paraqitur ngatërresë. Tash thotë brenda institucionit mund të punojë, drejtori i thotë një ekipi ju mund të punoni, ky ekipi tjetër mund të rrijë. Kjo në shumë shtete ka dështuar, ka dështuar në Kroaci, është duke dështuar dhe ka dështuar në Maqedoni, në Shqipëri, ndërsa në Evropë funksionon, sepse është çmimorja e caktuar për shërbime të tilla, caktohet çmimi i shërbimeve. Brenda sistemit shëndetësor, ne nuk kemi edhe çmimore dhe sikur sot ne ta fillojmë çmimoren e shërbimeve shëndetësore nuk kemi mundësi para dy vjetësh ta bëjmë. Nëse dikush mund ta bëjë, unë i uroj sukses se i di shumë figurat makro dhe mikroekonomike të zhvillimit të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti ministër, e keni fjalën! Ministri Agani dëshiron të sqarojë më tutje.

**MINISTRI FERID AGANI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç e dini, jemi në fund të një procesi të gjatë disamujor të konsultimeve, debateve publike rreth këtij projektligji, i cili është projektligj esencial, projektligj shtyllë e reformës të sistemit shëndetësor, projektligj i cili paraqet zgjidhje gjithëpërfshirëse për qasjen e duhur ndaj problemeve të shumta në sektorin e shëndetësisë, është projektligj i cili ka zgjidhje të tilla reformuese, të cilat janë koherente njëra me tjetrën dhe, në përgjithësi, e shtojnë përpara sistemin shëndetësor. Unë ju falënderoj shumë për

mbështetje gjatë këtyre muajve të debateve publike, në veçanti Komisionin Funkcional të Kuvendit të Kosovës. Te të gjitha subjektet politike kam hasur një konstruktivitet maksimal dhe një bashkëpunim të fuqishëm.

Vetëm një reflektim të shkurtër në fjalën e deputetit Muja së fundi. Nuk kam dashur të diskutoj as sot. Kam dashur që Kuvendi i Kosovës vetë të flasë lidhur me Projektligjin. Se fundi, ky do të jetë produkt i punës suaj, por megjithatë m'u desh që të ngrihem dhe të them se çmimorja e shërbimeve shëndetësore në vend është gati, është i pilotuar, është e dizajnuar me ekspertë ndërkombëtarë, me ekspertë vendorë, me drejtorët e spitaleve, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Pakoja themelore e kujdesit shëndetësor është e dizajnuar plotësisht, kontrata me institucionet publike dhe private shëndetësore është e dizajnuar në tërësi, e pilotuar dhe e debatuar në shumë punëtori. Agjencia e financimit të shëndetësisë është në proces të themelimit, si transformim i Agjencisë komisionare të kujdesit shëndetësor që ka ekzistuar në Ministrinë e Shëndetësisë prej vitit 2000.

Prandaj, nuk ka kurrfarë dileme se në momentin kur të miratohet Ligi i shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë do të jetë e gatshme plotësisht që të fillojë me zbatimin tij që nga dita e parë e hyrjes në fuqi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Muja, replikë.

**SHAIP MUJA:** I nderuari kryesues,

I nderuar ministër,

Unë mendoj se deklarimi se është stabilizuar çmimorja nuk është i qëndrueshëm. Është duke u punuar, por nuk është stabilizuar dhe nuk është aprovuar dhe nuk do të ketë jetëgjatësi. Ndërsa, sa u përket çështjeve, një mik imi, ekspert i menaxhimit shëndetësor, më pati thënë një herë që nëse do nga ndërkombëtarët dhe ta fascionosh popullin, duhesh të thuash gjithmonë jemi duke bërë reforma. Unë kam jetuar në Shqipëri nja 10 vjet dhe tash pasi jam kthyer këtu, jam duke dëgjuar se Shqipërinë tash e 22 vjet është në reforma dhe është shteti i cili ka mundur të hyjë në Bashkimin Evropian, e nuk ka hyrë ende. Pse? Duke u thirrur në reforma.

Ne me këtë ligj, të cilin po duam ta aprovojmë, bëjmë shkelje të të drejtave të njeriut. Është shkelje e Ligjit të punës të Republikës së Kosovës. Nëse bazohet ligjërisht, ju e keni edhe legjislacionin afër, edhe personat të cilët janë përgjegjës për interpretim të ligjeve në mënyrë të shpejtë, sekretari dhe të tjerët. Ky ligj e shkel edhe Ligjin e punës, i shkel edhe të drejtat e njeriut dhe gjeneron konflikte sociale. Prandaj, unë nuk kam interes absolut personal në këtë ligj. Unë kam interes që shëndetësia mos të jetë me probleme në listat e para të gazetave. Ne duhet t'i rritim kapacitetet furnizuese, planifikuese, organizuese të punës brenda për punonjësit shëndetësorë, e jo t'i kufizojmë me ligje, me format të cilat mund t'i penalizojnë për shkak të gabimeve tona. Ne po e përziejmë problemin e keqmenaxhimit me mosekzistimin e ligjit. Ka ekzistuar edhe më parë një ligj, i cili ka mundur ta kufizojë shumë mirë edhe lëvizjen privato-publike.

Prandaj, ne nuk kemi nevojë të hyjmë në këto probleme. Unë mendoj dhe i ftoj deputetët e Parlamentit që të mos e përkrahin këtë ligj dhe nenin 41 ta anulojnë në tërësi. Vetë

Komisioni është i ngatërruar, sot del e thotë: Ne jemi mbledhur sot, edhe kemi punuar kohë të gjatë. Meqenëse po dihet që do të refuzohet, edhe po themi brenda institucionit, do të punojnë në sistem privat, i cili mandej do të dizajnohet me format të cilat kurrë nuk do të funksionojnë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Aliu e ka fjalën.

**LIBURN ALIU:** Unë nuk e kam të qartë se për çka po debatohet. Nuk e kemi të qartë për çka po diskutohet. Kur ka ardhur Projektligji, kemi mbajtur edhe debate publike, në të cilat kemi bërë ftesë që të gjithë të dërgojnë amendamente. Për nenin 41, nuk ka amendament konkret...

*(Reagime nga salla)*

...Sindikata nuk ka të drejtë të bëjë amendamente. Unë i kam bërë 4 amendamente. Pse ju zoti Muja nuk keni sjellë amendament kundër nenit 41? Sot do të ishte votuar. Po nuk ka të drejtë të sjellë Sindikata, se unë jam takuar me sindikatën. Me Rregulloren e Kuvendit, të drejtë për amendamente kanë vetëm deputetët dhe Qeveria, përkatësisht Ministria. Pra, ju është dashur ta sillni një propozim konkret, një amendament konkret kundër këtij nenit 41, e nuk kemi. Po të kishim pasur, do ta kishim votuar atë amendament, i cili ndoshta do ta kishte hedhur nenin 41 poshtë.

I kanë sjellë propozimet e veta sindikata, kanë shkuar te secili deputet, kanë synuar të llojnë që të gjejnë ndonjë deputet që ua përkrah amendamentet. Janë disa amendamente që dikush ua ka përkrahur, disa të tjera i kemi përkrahur, e kështu me radhë. Prandaj, nuk kemi për çka të diskutojmë. Unë nuk po e di për çka! Po të kishte pasur amendament konkret kundër nenit 41, e kishim votuar, por nuk ka.

**KRYESUESI:** Nuk ka më replika për këtë, ja edhe Myzejene Selmani, kryetare e Grupit Parlamentar, dhe menjëherë do ta fus në votim elektronik, kush do e voton për e kush do kundër. Realisht, ne kemi problem me miratimin e ligjeve, se janë 60 amendamente, edhe deputetët janë të “shashtritur” për t’i miratuar. Asnjëri nuk e di çka po voton, veç qysh na... Edhe ty ta jap fjalën, Bekim, por njësoj është ajo punë.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke marrë parasysh se është leximi i dytë i Projektligjit dhe duke marrë parasysh njerëzit apo deputetët të cilët kanë bërë amendamente të posaçme jashtë Komisionit, mund ta marrin fjalën, unë kisha sugjeruar që të shkohet me votim. Voton kush voton!

**KRYESUESI:** Edhe një replikë e ka zoti Haxhiu dhe e mbyllim. Ju lus, mos u paraqitni më se nuk ia jap fjalën askujt.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Të gjitha debatet publike, të cilat kanë qenë për Ligjin mbi shëndetësinë, në veçanti me shoqatat e mjekëve dhe profesionistëve shëndetësorë, janë bërë me qëllim që ato ta japin versionin e tyre dhe Komisioni është dashur t’i marrë në shqyrtim dhe është dashur t’i

marrë parasysh kërkesat e Shoqatës të Profesionistëve Shëndetësorë. Për fat të keq, anëtarët e Komisionit deklarohen që nuk po dihet për çka po diskutojmë, për cilat amendamente dhe çka janë duke bërë.

Do të thotë, ne kemi anëtarë të Komisionit, të cilët janë në komision dhe të cilët nuk e dinë për çka kanë votuar dhe çka kanë amendamentuar. Kjo është domethënë një e metë gjatë hartimit të këtij ligji. Unë e kam dorëzuar me shkrim amendament sa i përket nenit 41. E kemi diskutuar në Komision edhe anëtarët e Komisionit e dinë që bashkërisht me mua kanë diskutuar këtë çështjen e nenit 41 dhe unë nuk dua të jem në kuadër asaj që ne deputetët nuk jemi për reformë shëndetësore. Ne jemi për reformë shëndetësore. Kosova ka nevojë për reformë shëndetësore. Ka nevojë për një reformë të mirëfilltë shëndetësore dhe reforma shëndetësore nuk duhet të jetë veç legjislative. Reforma shëndetësore duhet të jetë edhe menaxheriale.

Ne e kemi edhe një ligj në fuqi për shëndetësinë, mirëpo as ai ligj nuk është i keq sikur të zbatohet nga menaxherët dhe nga punëtorët shëndetësorë dhe të gjithë ata që kanë të bëjnë me Ligjin për shëndetësi. Prandaj, mendoj që ne duhet t'i japim shans edhe rast si Kuvendi i Kosovës Ligjit për shëndetësi në tërësi, mirëpo me përmirësimet të cilat janë kërkuar nga profesionistët shëndetësorë dhe në veçanti nga shoqatat. Frika ime është se me miratimin e këtij neni 41, shoqatat e mjekëve do ta kontestojnë këtë nen dhe zbatimi i kësaj reforme do të shtyhet për shkak të kërkesë së tyre në Gjykatën Kushtetuese dhe pastaj do të futemi në një radhë vicioz dhe zbatimi i kësaj reforme do të ngecë. Ky ishte shqetësimi im dhe kërkesa ka qenë që kjo të fillojë të zbatohet më vonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka diskutime tjera. Ju kisha lutur ta hedhim në votim elektronik amendamentin 60, meqenëse u diskutua mjaft. Tjetër propozim të shkruar nuk kam. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 73 deputetë.

Me 41 vota për, 20 kundër dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 60.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 43 vota për, 18 kundër dhe 8 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për shëndetësinë.

Tani dua ta diskutoj nëse do të vazhdojmë? Nëse vazhdojmë, ju lus të qëndroni në sallë, sepse e kemi një ligj që i ka 256 amendamente. Pra, lus të gjithë deputetët të jenë në sallë, që të kemi kuorum deri në fund, e nëse jo nuk është mirë të futemi në miratimin e këtij ligji, e pastaj të mos kemi kuorum gjatë miratimit të amendamenteve. Tre veta që kanë punë, le të shkojnë, kurse të tjerët të qëndrojnë në sallë. Unë shpresoj që nëse jemi në rregull me amendamentet, do ta kryejmë për 20 minuta.

Atëherë, kalojmë në pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

## **17. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit të procedurës penale**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projekt-kodin e procedurës penale dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

*(Ndërhyrje, sqarim)*

I autorizuar qenka zoti Selimi, nënkryetar i Komisionit.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Si zakonisht, i kam dy alternativa, të shkurtër dhe të gjatë, por po i bie shkurt.

Është fjala për një projektligj shumë të rëndësishëm për të cilin është punuar 6 muaj dhe në të cilin kanë marrë pjesë i madh e i vogël, kushdo që ka pasur interesim, dhe ne i kemi përfshirë të gjitha këtu. Është e vërtetë se ka shumë amendamente, 256 sosh, por kryesisht janë të karakterit teknik, sepse në procedurë, nëse e prek një çështje, ndikohet edhe në çështjet tjera.

Prandaj, Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 10 dhjetor 2012 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë për shqyrtim dhe miratim amendamentet e propozuara.

Dëshiroj me këtë rast t'i falënderoj të gjithë ata që kanë punuar në grupin punues, e posaçërisht pjesën profesionale të Kuvendit të Kosovës dhe e kisha lutur me këtë rast sekretarin që mirënjohjen e Komisionit për Legjislacion t'ua përcjellë të gjithë atyre ekspertëve të Kuvendit, pjesa administrative që e ka mbështetur punën për 6 muaj me radhë. Faleminderit!

KRYESUESI: Projektligji i ka 256 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funkcional.

Unë ju thashë, a doni të votojmë dhe ta miratojmë ligjin. Me 54 deputetë në sallë, nuk mund të procedoj. Ose të kemi kuorum, ose ta ndërpresim punën.

*(Ndërhyrje - sugjerime)*

Është përgjegjësi e secilit deputet. Unë i luta të jenë të gjithë në sallë. 3 veta u liruan, se kanë takim me ndërkombëtarët.

*(Ndërhyrje dhe ndërprerje e incizimit)*

Tani në sallë janë të pranishëm 64 deputetë.













Amendamenti 227, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 228, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 229, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 230, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 231, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 232, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 233, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 234, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 235, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 236, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 237, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 238, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 239, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 240, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 241, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 242, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 243, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 244, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 245, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 246, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 247, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 248, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 249, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 250, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 251, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 252, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 253, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 254, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 255, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.  
Amendamenti 256, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Tani e votojmë tekstin e Projekt-kodit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 59 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Kodin e Procedurës Penale. Faleminderit!

E kemi edhe pikën e fundit të rendit të ditës:

## **18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës**

Komisioni për Punë të Jashtme e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit numër 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme, zotin Albin Kurti për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Zoti Kurti, e keni fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit kryesues!

Komisioni për Punë të Jashtme, duke u mbështetur në Rregulloren e Kuvendit dhe në Planin e programin e punës së tij, ka vendosur që ta mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës numër 03/L-122.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, Komisioni e ka formuar grupin punues, i cili i ka zhvilluar aktivitetet e nevojshme me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave mbi nivelin e zbatimit të ligjit.

Në këtë grup punues, përveç meje, kanë qenë edhe nënkryetari i Komisionit, Hydajet Hyseni, dhe anëtarja deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji ishte vlerësimi i zbatueshmërisë në praktikë të tij dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga ligji.

Grupi ynë punues, fillimisht e ka bërë një analizë të ligjit dhe ka përcaktuar ndërmarrjen e veprimeve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Ka mbajtur takime të grupit me qëllim të koordinimit dhe planifikimit të aktiviteteve të tij.

Në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, grupi punues e ka vizituar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe është takuar me udhëheqësit e departamenteve përgjegjëse për implementimin e ligjit në fjalë, e po ashtu është takuar edhe me disa ambasadorë të Republikës së Kosovës në detyrë.

Grupi punues, pas përmbushjes së aktiviteteve të tij për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit e ka vlerësuar zbatueshmërinë në praktikë të këtij ligji dhe e ka hartuar raportin nga mbikëqyrja.

Kemi arritur të vlerësojmë se Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës është duke u zbatuar, megjithatë gjatë analizave të bëra kemi identifikuar edhe disa mangësi dhe ngecje në zbatim, të cilat Komisioni për Punë të Jashtme, në mbledhjen e mbajtur më 26 nëntor 2012, i ka miratuar dhe i ka propozuar në formë të rekomandimeve, me synim që shqyrtimi dhe miratimi i tyre nga mbledhja plenare do ta avanconte zbatimin e ligjit në fjalë.

Në veçanti, e kemi bërë edhe analizën e përputhshmërisë së këtij ligji dhe të disa ligjeve të tjera nga fusha e politikës së jashtme dhe akteve të tjera nënligjore, për çfarë, në kuadër të rekomandimeve, kemi përfshirë që Ministria ta trajtojë harmonizimin e të gjitha mospërputhjeve, të cilat i kemi konstatuar. Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët që ta miratojnë këtë raport të Komisionit për Punë të Jashtme.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radha është e përfaqësuesit të Qeverisë. Ministër Hoxhaj, e keni fjalën.

**MINISTRI ENVER HOXHAJ:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme, zoti Kurti.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Unë me vëmendje të madhe e kam lexuar Raportin dhe rekomandimet dhe mund të them paraprakisht se e ndaj një pjesë të madhe të shqetësimeve të cilat ngrihen nga Komisioni për Politikë të Jashtme dhe nga grupi punues.

Dua të them se ky vlerësim vjen në një kohë shumë të domosdoshme edhe për Ministrinë e Punëve të Jashtme, mirëpo para se të kaloj në disa propozime konkrete, më lejoni të marr qëndrim për disa pika, të cilat janë pjesë e këtyre rekomandimeve.

Së pari, më lejoni të them se Shërbimi i Jashtëm i Republikë së Kosovës funksionon në përputhje me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme, me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për shërbimet konsullore.

Të gjitha këto ligje derivojnë nga Konventa e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike, e vitit 1961, dhe nga Konventa e Vjenës për Shërbime Konsullore, e vitit 1963.

Dhe, dilema e parë që ngre rekomandimi i parë ka të bëjë me vijën ndarëse ndërmjet asaj se çfarë është Shërbimi i Jashtëm, apo çfarë është Shërbimi Diplomatik dhe stafi civil. Në çfarë forme do të duhej të rregullohet një çështje e tillë?

Unë mund të them se në bazë të ligjeve në fuqi, kjo çështje është rregulluar edhe në përputhje me normat tona ligjore, mirëpo edhe me normat ligjore ndërkombëtare, në bazë të këtyre konventave, të cilat unë i citova.

Sa i takon rekomandimit të parë, po ashtu përmendet çështja e Akademisë Diplomatike, mënyra se si është themeluar ajo. Më lejoni të ju informoj se ne e kemi themeluar Akademinë Diplomatike në përputhje të plotë me ligjin dhe është miratuar ky vendim në Qeverinë e Kosovës, pas propozimit që e kam bërë unë si ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës.

Deri më tash kemi arritur që ta hartojmë edhe Rregulloren për funksionimin e Akademisë Diplomatike, ndërsa emërimi i drejtorit, që është në kuadër të pikës 1 rekomanduese, është bërë po ashtu në përputhje të plotë me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm, pasi është

bërë tërheqja e ambasadorit në fjalë dhe pasi ky është emëruar nga sekretari i përgjithshëm në pozitën e drejtorit.

Dua të them se ne jemi shumë të interesuar që kjo akademi ta ketë autonominë e saj të plotë në veprimin e saj dhe mendojmë se duhet të ketë edhe një ligj i veçantë, i cili ndoshta do të duhej ta rregullojë çështjen e funksionimit të Akademisë Diplomatike.

Sa i takon rekomandimit të dytë apo pikës së dytë, që ngre shqetësimin dhe domosdoshmërinë e një sistemi efikas të planifikimit të shpenzimeve për Shërbimin e Jashtëm, dhe si ky buxhet t'i garantojë kapacitetet e mjaftueshme, edhe humane, edhe profesionale, për t'i bartur objektivat shtetërore, më lejoni të ju them se unë jam shumë mirënjohës ndaj Kuvendit të Kosovës dhe ndaj juve, të nderuar deputetë, për miratimin e Buxhetit sot dhe për faktin që Ministria e Punëve të Jashtme do ta ketë një buxhet më të madh sesa në vitin paraprak.

Po ashtu, dua të ju siguroj se ky buxhet parasheh që ne të kemi personel më shumë. Deri më tash i kemi 232 pjesëtarë të Shërbimit të Jashtëm, ndërkaq vitin e ardhshëm planifikojmë t'i kemi 262, do të thotë për 30 pjesëtarë në personel më shumë dhe do të bëjmë përpjekje maksimale që në përzgjedhjen e këtij personeli të kemi, mbi të gjitha, njerëz të cilët do të kenë kapacitete, jo vetëm të domosdoshme profesionale, por edhe aftësi për disa hapësira gjuhësore, të cilat deri më tash nuk kanë qenë të pranishme në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Dua të ju informoj se sa i takon zgjerimit, aktualisht e kam emëruar një të ngarkuar me punë, i cili është duke bërë përpjekjet e fundit për funksionalizimin e Ambasadës sonë në Australi; e kemi themeluar Konsullatën e Përgjithshme në Stamboll; jemi në fazën e fundit që ta funksionalizojmë Konsullatën tonë në Strasburg, e kemi marrë pëlqimin nga autoritetet franceze për të hapur Konsullatë të Përgjithshme atje, ndërsa jemi në fazën e fundit për shndërrimin e Konsullatës sonë në Gjenevë në një Konsullatë të Përgjithshme.

Po ashtu duhet të ju informoj që për vitin e ardhshëm planifikojmë të hapim edhe tri misione të tjera diplomatike, në përputhje me këtë buxhet.

Sa i takon menaxhimit financiar, jemi në fazën e vendosjes së një programi softuerik për menaxhimin e financave, i cili do ta ndihmojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe misionet tona diplomatike konsullore dhe ky sistem i teknologjisë informative, që është jashtëzakonisht i avancuar, do të na ndihmojë në planifikimin, monitorimin, kontrollimin, si dhe raportimin e rregullt në baza ditore për atë se si qëndrojmë në përdorimin e Buxhetit dhe si ta kemi një shpenzim sa më efikas të tij.

Po ashtu, dua ta përmendi një sqarim, sa i përket rekomandimit të pestë, ku kërkohet që të sqarohet qartë çështja e emërimit të konsullit të përgjithshëm dhe të konsujve. Me ligjet tona në fuqi, kjo çështje është rregulluar në mënyrë jashtëzakonisht të mirë, meqë konsujt e përgjithshëm dekretohen nga Presidentja e vendit, pas propozimit tim, përderisa konsujt janë pjesë e Shërbimit Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe për këtë ka kritere tjera krejt të veçanta.

Më lejoni që pa ju marrë shumë kohë, të them se sa u përket rekomandimeve 3, 4, 6, 7, 8, 9 dhe 10, mendoj që është më se e domosdoshme ta kemi një amendamentim të plotë të ligjeve bazike, në bazë të të cilave funksionon Ministria e Punëve të Jashtme. Do të thotë, së pari ta kemi një amendamentim të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, të Ligjit për Shërbim të Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Shërbimin Konsullor.

Në Strategjinë e Qeverisë për vitin 2013, ne kemi propozuar që këto ligje duhet të plotësohen, të ndryshohen dhe të amendamentohen, prandaj ky raport dhe kjo analizë vjen në një kohë të duhur dhe mendoj se shumë nga këto rekomandime që janë dhënë nga Komisioni për Politikë të Jashtme do të mund të inkuadrohen në kuadër të plotësimit të ligjeve, që duhet të ndodhin gjatë vitit 2013.

Po ashtu, më lejoni të ju them se Kosova në fund të vitit 2012 është në një pozitë jashtëzakonisht të favorshme ndërkombëtare, meqë po ofrohemi rreth numrit 100 të njohjeve jashtëzakonisht të rëndësishme të Republikës së Kosovës dhe ne jemi shumë të interesuar që këtë numër, këtë arritje ta shfrytëzojmë si një momentum të ri për politikën e jashtme.

Po ashtu, i kemi hartuar parimet e politikës së jashtme, të cilat në fillim të janarit do t'i ndajmë me Komisionin për Politikë të Jashtme, por do t'i ndajmë edhe me të gjitha institucionet tjera relevante.

Dua po ashtu të ju informoj se e kemi hartuar një organogram të ri për Ministrinë e Punëve të Jashtme, në të cilin është punuar në mënyrë intensive gjatë vitit 2011 dhe i cili sot e ka marrë miratimin edhe nga Ministria e Administratës Publike dhe në përputhje me këto prioritete, mendoj se të gjitha rekomandimet, të cilat janë përmendur në këtë Komision, do të mund të harmonizohen në kuadër të ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve bazike, të cilat mendojmë se duhet t'i ndryshojmë në vitin 2013.

Mendoj se ky raport na ndihmon edhe ne, mirëpo në të njëjtën kohë paralelisht me ndryshimin dhe plotësimin e këtyre ligjeve, ne do ta iniciojmë për vitin e ardhshëm një studim të detajuar që të shohim se si rregullohet çështja e shërbyesve civilë dhe e Shërbimit Diplomatik në vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian.

Edhe një herë dua ta falënderoj kryetarin e Komisionit dhe grupin punues për këto rekomandime dhe propozimi im si ministër i Punëve të Jashtme është që të gjitha këto rekomandime, të cilat janë bërë, do të duhej të implementohen në kuadër të plotësimit dhe ndryshimit të tri ligjeve bazike, në bazë të të cilave ne funksionojmë si Ministri e Punëve të Jashtme. Me atë do ta kishim pasur një brumë dhe një bazë të mirëfilltë se si këto ligje në një rrafsh afatgjatë t'i zgjidhin disa nga dilemat që janë ngrehur edhe nga Komisioni për Politikë të Jashtme.

**KRYESUESI:** Faleminderit! A ke replikë, apo t'ua lëmë radhën grupeve parlamentare? Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, nuk është paraqitur askush.



Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Hyseni e ka fjalën.

**SKENDER HYSENI:** Faleminderit zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka trajtuar Raportin e Komisionit për Punë të Jashtme rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe ka konstatuar se raporti është gjithëpërfshirës dhe rekomandojmë që të votohet, së bashku me rekomandimet e propozuara.

Natyrisht, një shqetësim i veçantë i Grupit Parlamentar të LDK-së është jo aq shumë zbatimi i vetë Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës, por shqetësim paraqet zbatimi i disa ligjeve tjera pozitive të Republikës së Kosovës dhe sidomos paraqet shqetësim ekzekutimi i vendimeve të instancave të caktuara gjyqësore rreth disa lëndëve në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Prandaj, unë e shoh të udhës që ta theksoj këtë moment si një nevojë urgjente që ministri i Punëve të Jashtme dhe stafi në Ministrinë e Punëve të Jashtme të jenë konsekuentë në ekzekutimin me kohë të vendimeve të instancave të ndryshme gjyqësore, sepse në bazë të informacioneve që ka Grupi Parlamentar i LDK-së, vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës mbeten të paekzekutuara në këtë ministri. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Kurti, apo dikush tjetër? E ke të drejtën edhe në fund, mos harro!

**ALBIN KURTI:** Atëherë Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës, meqë grupi punues e ka kryer punën ashtu si duhet gjatë monitorimit të këtij ligji, ne besojmë se është kryer puna ashtu si duhet dhe monitorimi i këtij ligji është bërë ekzakt normave. Prandaj, ne e përkrahim raportin dhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni përkatës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zonja Rexhepi!

**EMILJA REĐEPI:** Zahvaljujem, predsedavajući!

Kao član Komisije za spoljašnje poslove, ispred Koalicije za Novo Kosovo, podržavamo funkcionalnu komisiju, kao i sve preporuke koje su donete na Komisiji, a u skladu su sa Zakonom o spoljašnjoj službi, kao i angažovanost ministra za spoljašnje poslove da se to implementira u praksi. Zahvaljujem!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. Në emër të propozuesit, do të thotë të Komisionit, e doni fjalën zoti ministër edhe një herë. Urdhëroni, ministër!

**MINISTRI ENVER HOXHAI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Besoj se unë isha mjaft i qartë, që do të thotë se të gjitha rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioni për Politikë të Jashtme, i mirëpresim ne si Ministri e Punëve të Jashtme. Mirëpo, ajo ku kam dëshirë ta bëj një vijë të qartë dalluese është që nga rekomandimi 3 e

deri te rekomandimi i fundit, ne mendojmë se të gjitha dilemat, të cilat i ngrenë këto rekomandime do të mund t'i zgjidhim në një mënyrë më të mirë, duke e filluar procesin e plotësimit dhe të ndryshimit të tri ligjeve bazike.

Nëse Kuvendi i Kosovës do ta përkrahte një kërkesë tonën si Ministri, që në kuadër të këtyre rekomandimeve të jetë edhe një rekomandim, i 11-të, që të ndryshohen këto tri ligje bazike, në të cilat ne do të punojmë gjatë vitit të ardhshëm, besoj se të gjitha dilemat që ju i keni ngrehur do të ishin dilema që do t'i zgjidhnim në mënyrën më të mirë të mundshme, meqë, po ju them me sinqeritetin më të madh, unë e kam lexuar Raportin me vëmendje, kam lexuar edhe për modelet e vendeve të tjera të rajonit dhe ka goxha paqartësi se si funksionojnë shërbimet diplomatike në kuadër të një administrate, apo të një shërbimi civil. Dhe, nëse ne dëshirojmë që këto rekomandime të zbatohen, do të duhej ta ndryshojmë komplet kornizën ligjore.

Prandaj, ne do kishim qenë të gatshëm që në vitin e ardhshëm ta bëjmë një analizë të detajuar sa i përket asaj se si në vendet e ndryshme të rajonit funksionon shërbimi i jashtëm, në kuadër të shërbimit civil të ndonjë vendi, i cili do të mund të shërbente si model. Përndryshe, prej vendeve të rajonit nuk ka ndonjë përgjigje të prerë se cila do të ishte përvoja më e mirë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radha është e propozuesit. Zoti Kurti, e keni fjalën.

**ALBIN KURTI:** Faleminderit, kryesues!

Së pari, në bazë të ligjit, Akademinë Diplomatike duhet ta themelojë Ministria e Punëve të Jashtme, e jo Qeveria. Besoj se vlen të theksohet, sepse është rekomandimi ynë i parë që ka të bëjë me Akademinë.

Së dyti, është që dallimi ndërmjet Shërbimit Civil dhe të Jashtëm e bën Ligji për shërbimin civil. Pra, ky e përcakton se cila pjesë e stafit është e Shërbimit Civil, e cila jo. Në këtë aspekt, Ligji për shërbimin civil i konsideron konsujt si shërbyes civilë.

Neni 3.4 i këtij ligji thotë që personeli diplomatik dhe konsullor, përveç shefave të misioneve diplomatike, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit, ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

Dhe, natyrisht, se të gjitha këto rekomandime do të duhej të përktheheshin në ndryshime të këtyre tri ligjeve bazike, që janë në fushën e politikës së jashtme dhe ne kemi pasur qëndrim unanim në Komisionin tonë për Punë të Jashtme për këtë raport. Prandaj, edhe një herë u bëj thirrje të gjithë deputetëve që ta votoni atë dhe mandej sigurisht se Ministria këto 10 rekomandime mund t'i përmbledhë në ndryshimet e nevojshme të këtyre tri ligjeve bazike, për çfarë natyrisht se kjo do të mund të bëhet gjatë vitit të ardhshëm, kur edhe ne si Komision për Punë të Jashtme do ta jepnim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A kemi kuorum? Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë dhe vazhdojmë me votimin e raportit me rekomandimet e Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatoj se me 58 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:*

*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*